



Republika e Kosovës

Reoublika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Brendshme - Ministrastvo Unutrašnjih Poslova -

Ministry of Internal Affairs

Policia e Kosovës / Policija Kosova / Kosovo Police



VLERËSIMI I KËRCËNIMIT NGA KRIMI I ORGANIZUAR DHE KRIMET E RËNDA



SOCTA
2025



Mesazhi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës z. Gazmend Hoxha

Krimi i organizuar mbetet një nga kërcënimet më serioze me të cilat përballet Republika e Kosovës, sikurse edhe vendet tjera të rajonit dhe më gjerë. Ky fenomen i ndërlikuar, me shtrirje gjithnjë më të madhe ndërkombëtare, minon sundimin e ligjit, cenon sigurinë publike dhe pengon zhvillimin demokratik dhe ekonomik të shteteve.

Në këtë kontekst, kam nderin dhe kënaqësinë të prezantoj dokumentin strategjik SOCTA 2025, i cili është i treti me radhë, i hartuar nga Policia e Kosovës në bashkëpunim të ngushtë me partnerët tanë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, që kontribuojnë në ruajtjen e rendit dhe sigurisë në vendin tonë.



Dokumenti “SOCTA” (Strategic Analysis on Serious and Organized Crime Threat Assessment) ofron një pasqyrë të thelluar të kërcënimeve kryesore nga krimet e rënda dhe të organizuara, me të cilat është përballur dhe pritet të përballet Republika e Kosovës. Ky dokument është hartuar mbi bazën e të dhënave zyrtare nga Policia e Kosovës, Dogana, institucione të tjera të zbatimit të ligjit, burime të hapura, organizata joqeveritare dhe agjenci inteligjente.

Ky vlerësim strategjik vjen në një kohë kur krimi i organizuar në Evropë dhe rajon ka evoluar ndjeshëm, siç tregohet edhe nga Raporti më i fundit SOCTA 2025 i EUROPOL-it, i cili thekson rritjen e sofistikimit dhe shtrirjes ndërkombëtare të rrjeteve kriminale. Sipas SOCTA 2025, grupet kriminale në Evropë janë gjithnjë e më të strukturuar, teknologjikisht të avancuara dhe të përfshira në aktivitete të ndërlidhura, si: trafikimi i narkotikëve, trafikimi i qenieve njerëzore, pastrimi i parave dhe krimi kibernetik. Po këto trende janë identifikuar edhe në vlerësimin tonë kombëtar.

Raporti ynë “SOCTA 2025” tregon qartë se krimi i organizuar në Kosovë është pjesë e këtij zinxhiri më të gjerë kriminal dhe përballet me të njëjtat sfida komplekse si në nivel rajonal, ashtu edhe global. Në këtë drejtim, ndërlidhja me raportin e EUROPOL-it na ndihmon të vendosim prioritetet tona strategjike në përputhje me standardet dhe përvojën e vendeve të BE-së. Dokumenti jonë i SOCTA-s shërben si një bazë e fortë për vendimmarrje strategjike, duke i mundësuar Policisë së Kosovës dhe institucioneve të tjera të hartojnë plane konkrete për parandalimin dhe luftimin e krimeve të rënda dhe të organizuara.

Rekomandimet që dalin nga ky raport kërkojnë veprim të koordinuar, burime të mirëmenaxhuara dhe përkushtim të lartë profesional nga menaxhmenti i lartë policor. Lufta kundër krimit të organizuar kërkon përpjekje të përbashkëta në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar

Në fund falënderojmë të gjitha agjencitë kombëtare të zbatimit të ligjit, të gjitha institucionet tjera shtetërore, organizatat joqeveritare - OJQ-të, EU4FAST, për kontributin e tyre të vlefshëm në hartimin e këtij dokumenti strategjik.

Në këtë vlerësim shoqëria ka një rol shumë të rëndësishëm në luftën kundër krimit të organizuar, pasi ajo është baza ku ky fenomen zhvillohet dhe ndikon në mënyrë direkte apo indirekte. Lufta kundër krimit të organizuar, por jo vetëm, nuk është detyrë vetëm e Policisë apo e institucioneve të drejtësisë, por kërkon angazhimin dhe bashkëpunimin e të gjithë qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile.

Shoqëria duhet të jetë e informuar dhe e vetëdijshme për pasojat negative që sjell krimi i organizuar, siç janë: korrupsioni, dhuna, shkatërrimi i ekonomisë dhe humbja e besimit në institucionet shtetërore. Përmes një vlerësimi strategjik të analizuar, edukimit, sensibilizimit dhe pjesëmarrjes aktive, qytetarët mund të ndihmojnë në denoncimin e aktiviteteve kriminale dhe të mbështesin masat e sigurisë.

Prandaj, forcimi i bashkëpunimit ndërinstitutional dhe ndërkombëtar është thelbësor për suksesin në këtë sfidë të përbashkët. Kosova, me këtë dokument dhe me përafrimin e praktikave të saj me ato të BE-së dhe EUROPOL-it, dëshmon gatishmërinë për të qenë pjesë aktive në këtë përpjekje globale.

Kolonel Gazmend HOXHA
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës

TABELA E PËRMBAJTJES

MESAZHI I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM	2
TABELA E PËRMBAJTJES	4
HYRJE	6
METODOLIGJIA	7
PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	8
Grupet e Krimit të Organizuar	8
Trafikimi me Narkotikë	8
Krimet Kibernetike	9
Trafikimi me Qenie Njerëzore	10
Shfrytëzimi i Fëmijëve në Pornografi	10
Kontrabandimi me Migrant	10
Korrupsioni	10
Shpëlarja e Parasë	11
Kontrabandimi me Mallra	11
Trafikimi me Armë	11
Kërcënimet Hibrde	11
Krimet Mjedisore	11
TRAFIKIMI ME NARKOTIKË	12
Marihuana	22
Kokaina	25
Heroina	28
Drogat Sintetike	31
KRIMET KIBERNETIKE	34
TRAFIKIMI ME QENIE NJERËZORE	43
Trafikimi Për Shfrytëzim Seksual	44
Trafikimi Për Kërkim Lëmoshë	45
Trafikimi Për Punë Të Detyruar	46
KEQPËRDORIMI I FËMIJËVE NË PORNOGRAFI	50
KONTRABANDIMI ME MIGRANT	51
KORRUPSIONI	54

SHPËLARJA E PARASË	59
TRAFIKIMI ME ARMË	63
KONTRABANDIMI ME MALLRA	70
Kontrabanda e Produkteve Ushqimore Dhe Mishit Në Kosovë	74
Kontrabandimi i Produkteve Të Duhanit	75
Kontrabandimi i Derivateve Të Naftës Dhe Vajrave	76
Kontrabandimi i Barnat Farmaceutike	77
Kontrabandimi i Tekstilit	78
Kontrabandimi i Pjeve Alkoolike Dhe Jo-Alkoolike	78
Fenomeni I Veprave Penale Kundër Autorësisë Dhe Mallrave Të Falsifikuara	79
KËRCËNIMET HIBRIDE	83
KRIMET MJEDISORE	85
Prerja Ilegale e Pyjeve	88
Ndotja, degradimi, shkatërimi i mjedisit	89
KRIMINALITETI I PËRGJITHSHËM	95
Fajdet	95
Vrasjet	100
Grabitjet	104

Krimi i organizuar mbetet kërcënim serioz ndaj sigurisë dhe pasojat nga ky krim në Kosovë janë të mëdha, të shumanshme dhe prekin të gjitha aspektet e shoqërisë, nga siguria, drejtësia dhe ekonomia, deri te besimi i qytetarëve në institucione.

Krimi i organizuar përfshin grupe të strukturuar, të cilat kryejnë veprimtari kriminale të përsëritura, me qëllim përfitimi financiar. Këto grupe veprojnë në mënyrë të fshehtë, përdorin korrupsionin, dhunën dhe ndikimin politik për të mbrojtur interesat e tyre.

Krimi i organizuar në Kosovë përbën një kërcënim serioz për rendin kushtetues, zhvillimin ekonomik, sigurinë e brendshme dhe imazhin ndërkombëtar të vendit. Ai shfaqet përmes rrjeteve të strukturuar të përfshira në trafikim droge, qenie njerëzore, kontrabandë, krim financiar dhe pastrim parash. Shumë nga grupet e krimit të organizuar në Kosovë kanë lidhje të fuqishme rajonale dhe ndërkombëtare, si dhe ndikim të mundshëm në jetën politike dhe në ekonomi.

Krimi i organizuar në Kosovë nuk është vetëm një sfidë penale, por është një kërcënim strategjik për të ardhmen demokratike dhe ekonomike të vendit.

Luftimi i tij kërkon strategji gjithëpërfshirëse, që shkojnë përtej kapjes së individëve dhe që prekin strukturat, rrënjët dhe ndikimin e tij shoqëror e institucional.

Vetëm përmes bashkërendimit të akterëve vendorë dhe ndërkombëtarë, si dhe vullnetit politik real, mund të arrihet kontroll i qëndrueshëm mbi këtë fenomen.

Krimi i organizuar në Kosovë por edhe kudo tjetër, çdo herë e më shumë është duke u bërë më i fuqishëm dhe dinamik, ku grupet kriminale arrijnë shpejt të adaptohen në situata dhe me sukses t'ju shmangen përpjekjeve të organeve për zbatim të ligjit.

Kosova, përveç kërcënimeve të brendshme nga veprat e krimit të organizuar, vazhdon të jetë edhe vend tranzit i disa llojeve të veprave të kësaj natyre siç janë drogat, kontrabandat etj., prandaj lufta kundër krimit të organizuar kërkon ngritje të kapaciteteve në vazhdimësi si dhe bashkërendim të brendshëm institucional dhe bashkëpunim rajonal dhe ndërkombëtar.

Duke parë të gjitha këto zhvillime kërcënuese, institucionet e Republikës së Kosovës kanë identifikuar nevojën për hartimin e dokumentit strategjik SOCTA 2025, me qëllim të vlerësimit të nivelit të trendëve aktualë të krimit dhe parashikimin e kërcënimeve për të ardhmen.

Qëllimi i këtij dokumenti strategjik është të shikohet niveli i kërcënimeve, me qëllim të caktimit të prioriteteve dhe veprimet që duhet të ndërmerren në të ardhmen për përballje me kërcënimet që vijnë nga krimi i organizuar.

Të dhënat e siguruara për hartimin e këtij dokumenti janë gjithëpërfshirëse, duke filluar nga të dhënat zyrtare të Policisë së Kosovës, të dhënat nga institucionet tjera relevante, agjencive të pavarura dhe atyre të specializuara, OJQ të ndryshme, por edhe të dhëna nga burimet e hapura, duke përfshirë edhe hulumtime të ndryshme nga organizata vendore dhe ndërkombëtare. Dokumenti i SOCTA 2025 është i hartuar në dy versione:

në versionin e mbyllur që do të jetë në dispozicion të institucioneve të vendit, veçmas atyre të sigurisë dhe në versionin e hapur që do të jetë i publikuar në ueb faqen e Policisë së Kosovës dhe do të jetë në dispozicion për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Rekomandimet nga të gjeturat në këtë dokument duhet të pasohen me plane të veprimit dhe zbatimit, të cilat do të hartohen pas finalizimit të këtij dokumenti.

METODOLOGJIA

Me vendim të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës është themeluar grupi punues për hartimin e raportit “Vlerësimi i kërcënimeve nga krimi i organizuar dhe krimet e rënda (SOCTA 2025) në të cilin trajtohet periudha 2021 – 2024 dhe jepen parashikime për të ardhmen.

Grupi punues ka përgatitur pyetësorët për hartimin e këtij dokumenti, që janë të përafërt me pyetësorët e EUROPOL-it, të cilët i kanë në dispozicion akterët relevantë për plotësimin e tyre.

Identifikimi i fushave prioritare që janë trajtuar në kuadër të këtij dokumenti, është i bazuar sipas prioriteteve të përcaktuara paraprakisht nga Policia e Kosovës dhe mekanizmave tjerë të sigurisë, duke i përshtatur edhe sipas prioriteteve të SOCTA-s së EUROPOL-it.

Gjatë hartimit të SOCTA-s janë shfaqur edhe disa sfida dhe vështirësi, kryesisht në kualitetin e të dhënave që ishin në dispozicion të partnerëve tjerë, por edhe të dhënave policore. Shumë të dhëna të nevojshme nuk është arritur të sigurohen të plota, si pasojë e mosdisponueshmërisë së tyre apo mosruajtjes së tyre sipas kërkesave që nevojiten për hartimin e këtij dokumenti.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kosova ka kapacitete operacionale dhe rezultate konkrete në luftimin e grupeve kriminale, por për të goditur rrjetet kriminale dhe për të eliminuar fitimet e këtyre grupeve nevojitet një qasje më strategjike, si: zbatimi i plotë i strategjisë, policia e drejtuar nga inteligjenca, hetime të mirëfillta financiare, bashkëpunim rajonal dhe adresim i dobësive institucionale/korruptive.

GRUPET E KRIMIT TË ORGANIZUAR

Grupet e krimit të organizuar në Kosovë janë kryesisht rrjete të vogla dhe të mesme, shpesh me lidhje rajonale dhe lidhje nga diaspora kosovare në perëndim. Veprimtaria kryesore përfshin trafikimin e drogës, pastrimin e parave, trafikimin e njerëzve, kontrabandën dhe në raste të kufizuara krime kibernetike dhe dhunë të organizuar.

Ka pasur arritje të mira në luftimin e krimit të organizuar si në operacione ashtu edhe në arrestime, por sfidat mbeten, sidomos mungesa e rezultateve të thella financiare mbetet pengesa kryesore dhe vonesat procedurale në gjykata.

Për realizimin e qëllimit përdorin automjete private dhe kamionë me ngarkesa tregtare, kanë aftësi për komunikim të koduar përmes aplikacioneve të ndryshme dhe shfrytëzojnë rrjete transnacionale për furnizim dhe shpërndarje si dhe aftësi për të korruptuar zyrtarët.

Do të kenë prirje në të ardhmen që të shfrytëzojnë edhe më shumë teknologjinë për komunikim të koduar dhe gjetjen e taktikave të reja të krimit, por edhe metoda më të sofistikuar transporti.

TRAFIKIMI ME NARKOTIKË

Kosova është në një pikë ku tregu i brendshëm i drogës po zgjerohet paralelisht me rolin e saj si vend transit. Kanabisi mbetet droga kryesore e konsumit, por kokaina dhe substancat sintetike po fitojnë terren, duke ndryshuar strukturën e kërkesës.

Strukturat kriminale janë të vogla, por shumë të lidhura me rrjete ndërkombëtare, duke shfrytëzuar kufijtë tokësorë dhe mjetet digjitale. Sfida kryesore është forcimi i kontrollit kufitar, rritja e bashkëpunimit rajonal dhe investimi në programe parandaluese e rehabilituese.

Pa ndërhyrje të koordinuar, rreziku i rritjes së konsumit dhe përfshirjes së të rinjve në tregun e drogës është i lartë.

Marihuana - është droga më e përdorur në vend, kryesisht e prodhuar në Shqipëri dhe pjesërisht në Maqedoninë e Veriut dhe raste të kultivimit lokal në sasi të vogla. Konsumi është i përhapur kryesisht tek të rinjtë.

Kokaina nga Amerika Latine vjen në Ballkan përmes rrugëve detare, kryesisht në portet detare të Bullgarisë, Malit të Zi, Kroacisë dhe Shqipërisë dhe depërton në Kosovë dhe në rajon për konsum lokal dhe ri-eksport drejt vendeve evropiane.

Heroina – kalon nëpërmjet “rrugës së Ballkanit” nga Turqia përmes Maqedonisë së Veriut/Serbisë. Konsumi lokal është më i ulët, por trafiku mbetet aktiv.

Drogat sintetike (MDMA, amfetamina, “ecstasy”) – konsum gjithnjë e në rritje, sidomos në jetën e natës dhe eventet muzikore. Shumica importohet nga Holanda, Belgjika dhe vende të tjera të BE-së.

Grupet kriminale të trafikimit të narkotikëve janë të vogla dhe të mesme, shpesh të lidhura me grupe nga rajoni, të cilët përdorin metoda të sofistikuar të komunikimit dhe transportin e bëjnë përmes transportit rrugor të fshehur në ngarkesa të mallrave tregtare.

Numri i përdoruesve të drogës në Kosovë vlerësohet më shumë se 30 000, prej të cilëve 12 000 – 13 000 janë përdorues problematik, ndërsa moshë kur fillohet për herë të parë konsumimi i narkotikëve vlerësohet të jetë 16.5 vjet.

Parashikohet të kemi rritje të konsumit të moshat e reja deri te moshë e mesme sidomos e kanabisit dhe kokainës.

KRIMET KIBERNETIKE

Krimet kibernetike në Kosovë janë duke u rritur dhe duke u sofistikuar gjithnjë. Janë të shprehura që nga mashtrimet online dhe vjedhja e të dhënave, deri te sulmet e tipit ransomware dhe ndërhyrjet në sisteme institucionale. Kosova, me digjitalizimin në rritje të shërbimeve publike dhe private, përballet me sfida edhe më të mëdha në fushën e sigurisë kibernetike, për shkak të mungesës së burimeve teknike, ndërgjegjësimit publik dhe koordinimit institucional.

Format kryesore të krimit kibernetik na paraqiten përmes mashtrimeve financiare online ndaj qytetarëve dhe bizneseve, përmes sulmeve ransomware kundër institucioneve publike dhe kompanive private, përmes vjedhjes së identitetit dhe abuzimit me të dhëna personale, keqpërdorimit të rrjeteve sociale për shpifje, kërcënime dhe manipulim politik etj.

Këto krime do të shkojnë duke u intensifikuar në përdorimin të maluerëve të sofistikuar, shfrytëzimin e platformave të komunikimit të koduar, rritjen e mashtrimeve të lidhura me kriptovalutat dhe pagesat elektronike, rritjen e intensitetit dhe sofistikimit të sulmeve, sidomos ndaj sektorit bankar dhe qeveritar etj.

TRAFIKIMI ME QENIE NJERËZORE

Trafikimi me qenie njerëzore në Kosovë mbetet një problem i vazhdueshëm kriminal, i lidhur ngushtë me faktorët socio-ekonomikë, migracionin e parregullt dhe rrjetet kriminale rajonale. Viktimat janë kryesisht gra, vajza të mitura të cilat shfrytëzohen për qëllime seksuale, punë të detyruar dhe aktivitete të tjera të paligjshme.

Kosova ka arritur rezultate të mira në luftimin e këtij krimi, ka bërë përpjekje për forcimin e legjislacionit dhe bashkëpunimin ndërinstytucional, por sfidat në identifikimin e hershëm të viktimave, ndjekjen penale të autorëve dhe rehabilitimin e viktimave mbeten të theksuara.

SHFRYTËZIMI I FËMIJËVE NË PORNOGRAFI

Shfrytëzimi i fëmijëve në pornografi në Kosovë është një formë e rëndë e krimit kibernetik dhe abuzimit seksual, me pasoja të thella psikologjike, sociale dhe ligjore. Përhapja e teknologjisë, qasja e lehtë në internet dhe përdorimi i rrjeteve sociale kanë krijuar hapësira të reja për autorët që të rekrutojnë, manipulojnë ose shfrytëzojnë të miturit. Rreziku rritet nga mungesa e vetëdijes së prindërve, dobësitë në monitorimin e platformave online dhe mungesa e koordinimit të mjaftueshëm ndërinstytucional.

KONTRABANDIMI ME MIGRANT

Kosova shfrytëzohet nga grupet e kontrabandimit të migrantëve dhe nga migrantët kryesisht si vend transit, por edhe destinacion i përkohshëm për pritje dhe riorganizim të rrugës drejt Bashkimit Evropian.

Shumica e migrantëve janë nga Lindja e Mesme, Afrika Veriore, Azia Qendrore dhe shtete të tjera në krizë, të cilët përdorin rrugë tokësore përmes Turqisë, Greqisë, Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës, për të vazhduar drejt Malit të Zi, Serbisë dhe vendeve të Bashkimit Evropian - BE-së. Fitimet kriminale janë të larta, ndërsa kapacitetet e zbulimit dhe ndalimit mbeten të kufizuara.

KORRUPSIONI

Korrupsioni mbetet një nga sfidat strukturore më të mëdha për zhvillimin demokratik, sundimin e ligjit dhe integrimin evropian të Kosovës. Lufta kundër korrupsionit ka shënuar rritje dhe perceptimi qytetar është se janë shënuar përmirësime të lehta vitet e fundit, por ende larg standardeve të BE-së.

SHPËLARJA E PARASË

Shpëlarja e parasë në Kosovë përbën një sfidë serioze për sigurinë ekonomike dhe integritetin e sistemit financiar. Aktiviteti kryhet kryesisht nga rrjete të krimit të organizuar që veprojnë në sektorët e ekonomisë formale dhe informale, duke përdorur bizneset si fasadë. Në bazë të të dhënave paratë e paligjshme vijnë kryesisht nga: trafikimi i drogës dhe armëve, kontrabanda me mallra, korrupsioni dhe keqpërdorimi i fondeve publike, krimet kibernetike dhe mashtrimet financiare.

KONTRABANDIMI ME MALLRA

Kontrabandimi me mallra mbetet një prej fenomeneve më të mëdha të ekonomisë ilegale në Kosovë, duke shkaktuar humbje të mëdha fiskale dhe duke deformuar konkurrencën në treg. Aktivitetet kontrabanduese shfrytëzojnë boshllëqet ligjore, korrupsionin, ekonominë informale dhe rrugët ilegale kufitare. Mallrat kryesore të kontrabanduara janë: mallra ushqimore, duhan, pije alkoolike, medikamente mjekësore, veshmbathje dhe pajisje teknike. Korridorët kryesore të kontrabandës kalojnë përmes kufirit me Serbinë në zonat në lindje dhe në veri, Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë.

TRAFIKIMI ME ARMË

Kosova përballet me një nivel të lartë të qarkullimit të armëve ilegale, ku vlerësohet se në duart e popullsisë ende gjendet një numër i madh i armëve të llojeve të ndryshme. Vitet e fundit, numri i konfiskimeve është rritur ndjeshëm dhe janë zhvilluar operacione të përbashkëta me partnerë rajonalë dhe ndërkombëtarë të cilat kanë rezultuar me

zbulimin e rrjeteve të strukturuar kriminale në Kosovë dhe përtej Kosovës, duke përdorur korridore rajonale që lidhen me Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe vendet e BE-së.

KËRCËNIMET HIBRIDE

Kërcënimet hibride ndaj Kosovës janë të fokusuar në gjetjen dhe shfrytëzimin e dobësive të shoqërisë dhe shtetit tonë, për të minuar demokracinë, të arriturat, për të penguar fuqizimin e shtetit, shtrirjen e funksionalitetit të plotë në tërë territorin, me qëllim që vendi ynë të bëhet jofunksional si shtet dhe i dështuar.

KRIMET MJEDISORE

Krimet e ambientit në Kosovë janë në rritje dhe lidhen kryesisht me shfrytëzimin e pakontrolluar të resurseve natyrore, ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës, si dhe me menaxhimin e dobët të mbetjeve. Ndër aktorët kryesorë përfshihen kompani private, individë të papërgjegjshëm dhe në disa raste rrjete të organizuara që operojnë në nxjerrjen e zhavorrit nga lumenjtë, në pylltari etj.

TRAFIKIMI ME NARKOTIKË

Nga format e krimit të organizuar, Republika e Kosovës sfidën më të madhe e ka nga trafikimi me narkotikë, prodhimi dhe përdorimi i paligjshëm i narkotikëve.

Situata lidhur me trafikimin me narkotikë në Kosovë vazhdon të jetë mjaft shqetësuese dhe komplekse, për shkak të trendit gjithnjë e në rritje, kudo, e jo vetëm në Kosovë, por edhe për shkak të faktorëve tjerë favorizues siç janë pozita gjeografike ku kryqëzohen rrugë ndërkombëtare të trafikimit, pamjaftueshmëria e mbikëqyrjes së plotë e kufijve, kur dihet se gati të gjithë kufijtë me vendet fqinje janë territor malor, por edhe faktorë tjerë, siç është bashkëpunimi i grupeve të krimit të organizuar nga të gjitha vendet e rajonit.

Në Kosovë, sikurse edhe në vendet tjera, prodhimi dhe trafiku i drogës nga viti në vit kanë shkuar duke u rritur, për shkak të faktorëve të ndryshëm, përfshirë zhvillimet socio-ekonomike, rrethanat e sigurisë në përgjithësi, ndikimet e grupeve kriminale në disa pjesë të vendit, por edhe grupeve kriminale ndërkombëtare, për shkak të rritjes së kërkesës por edhe faktorë tjerë.

Referuar të dhënave zyrtare, në Kosovë janë të pranishme llojet e narkotikëve, marihuana, kokaina, heroina dhe drogat sintetike, LSD, GHB, ekstazi, metadoni, amfetamina, metamfetamina.

Rruga e përdorur nga trafikantët e drogës e cila njihet si “Rruga e Ballkanit” (të tjerat janë Deti i Zi verior dhe rrugët detare mesdhetare lindore).

Kjo rrugë fillon me kultivimin e lulëkuqes së opiumit në Azinë jugperëndimore dhe vazhdon përgjatë Iranit dhe Turqisë.

Pastaj në Gadishullin Ballkanik ndahet në dy degë: një degë në Evropën Perëndimore përmes Bullgarisë, Rumanisë, Hungarisë dhe Austrisë si dhe tjetra në të shumtën e rasteve përmes detit përgjatë Turqisë dhe Greqisë ose përgjatë Maqedonisë së Veriut, Shqipërisë, Kosovës, Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës.

Kosova bashkë me fqinjët, Malin e Zi, Serbinë, Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut kanë pozitë gjeografike kritike për trafikun e drogës, për shkak se gjenden në udhëkryqin e rrugëve të njohura të trafikimit për kalimin e drogave si marihuana, heroina dhe kokaina, të cilat rrugë grupet e trafikimit i përdorin për shitjen e drogës në Kosovë, në vendet fqinje dhe për transit drejt destinacioneve tjera.

Kosova si pjesë e “rrugës ballkanike” të trafikimit të drogës, preket nga transporti i heroinës afgane që vjen nga vendet e Lindjes (në veçanti nga Turqia, Irani dhe vendet e tjera të Lindjes së Mesme) dhe e cila shkon në drejtim të vendeve të tjera të Evropës, veçanërisht të Evropës Perëndimore si dhe për transportimin e kokainës nga vendet Evropiane drejt vendeve të lindjes dhe Azisë së afërt.

Trafikimi i marihuanës e cila origjinën kryesore e ka nga Shqipëria, përshton transit Kosovën dhe vendet e rajonit në dy drejtime, i pari në drejtim të vendeve evropiane dhe drejtimi tjetër drejt vendeve të Lindjes së Mesme dhe Azisë së afërt.

Drogat e rrezikshme, duke filluar nga kokaina, LSD, GHB etj., janë në trend nëpër ndejat që organizohen nëpër diskoteka dhe lokale të ndryshme me muzikë elektronike, të cilat zhvillohen në orët e vona të natës e deri në orët e hershme të mëngjesit, ku zakonisht frekuentohen nga numër i madh i personave. Sipas inteligjencës, droga në lokale të natës shiten duke filluar nga stafi i diskotekës apo lokalit, kamarierëve si dhe nga shpërndarës të thjeshtë të cilët futen brenda për fitime të tyre.



Foto më lart e realizuar në një operacion policor në vitin 2024 ku janë konfiskuar lloje të ndryshme të substancave narkotike si ekstazi, kokaina, crak, LSD, canabis-cokolate, para dhe dëshmi tjera.

Droga në Kosovë futet nga trafikantët nga këto tre drejtime kryesore:

- 📍 Maqedonia e Veriut - Kosovë (heroína, kokaina si dhe raste të rralla të kanabisit)
- 📍 Shqipëri - Kosovë (marihuana, kokaina, heroína)
- 📍 Serbi - Kosovë (droga sintetike, ekstazi dhe prekursorë të ndryshëm)

Droga nga Kosova për në destinacione tjera bëhet në këto katër drejtime kryesore:

- 📍 Kosovë - Maqedoni e Veriut (marihuana, heroína)
- 📍 Kosovë - Shqipëri (heroína)
- 📍 Kosovë - Serbi (marihuana, heroína, kokaina)
- 📍 Kosovë - Mal i Zi (marihuana, heroína, kokaina)



Harta e lëvizjes së drogave në shtetet e Ballkanit (marrë nga Qendra Evropiane e Monitorimit të Drogës)

Pikat kyçe të hyrjes dhe daljes së drogave në Kosovë mbeten: me Shqipërinë pika kufitare Vërmicë, Qafë Prush, Qafë Morinë; me Maqedoninë e veriut pika kufitare Hani i Elezit, Debëllde; me Serbinë pika kufitare Merdare, Bërnjak, Jarinje, Muqibabë, Dheu i Bardhë; si dhe me Malin e Zi pika kufitare Kulla.

Në nivelin e brendshëm kombëtar, janë identifikuar grupe të reja kriminale të cilat janë duke u marrë me blerje dhe shpërndarje të narkotikëve sidomos në zona urbane.

Ka rritje të numrit të përdoruesve të narkotikëve në përgjithësi e sidomos rritje të numrit të përdoruesve të kokainës.

Trafikimi me narkotikë mbetet një nga aktivitetet më fitimprurëse të krimit të organizuar në mbarë botën e po ashtu edhe në vendin tonë. Përfitimet financiare që rrjedhin nga ky aktivitet janë të mëdha dhe përfshijnë disa nivele të zinxhirit të trafikimit, nga prodhimi deri te shitja me pakicë.

Fitimi nga ky krim është i lartë dhe i shpejtë, për faktin se çmimi i prodhimit të drogës është shumë i ulët krahasuar me çmimin e shitjes në tregun përfundimtar. Shembull kokaina prodhohet për disa qindra dollarë për kilogram, por shitet për disa mijëra euro në Kosovë, rajon por edhe kudo tjetër.

Përparësi tjetër për trafikantët është kërkesa e madhe por edhe gjithnjë në rritje në treg, pra narkotikët janë produkte që shiten shpejt dhe kanë kërkesë të qëndrueshme në treg.

Kur jemi te fitimet, zinxhiri i përfitimeve për trafikantët është i gjatë, për dallim prej prodhuesve dhe dilerëve të cilët fitojnë më pak. Trafikantët fitimin më të madh e realizojnë me pagesat e blerjes dhe me transportin e narkotikëve nga prodhuesi, deri në tregun përfundimtar.

Edhe pse nuk e kemi ndonjë hetim të mirëfilltë financiar, grupet kriminale të trafikimit me narkotikë, fitimet e mëdha të realizuara janë duke i kamufluar në zhvillimin e bizneseve të ligjshme, me qëllim të fshehjes së burimit të paligjshëm të ardhurave dhe pastrimit të parave, duke investuar në blerje të pronave, banesa, vetura luksoze, dyqane tekstili etj.

Edhe pse nuk kemi të dhëna zyrtare sa i përket rivalitetit, grupet kriminale me narkotikë nuk janë të njohura për përdorimin e dhunës, por ka indikacione se në disa raste është përdoruar dhuna si mjet për qërim hesapesh në mes të anëtarëve të grupeve apo ndaj klientëve që nuk kanë kryer obligimet financiare.

Korrupsioni, mos hetimi financiar dhe mos konfiskimi i pasurisë së grupeve kriminale, është një nga pikat më të forta të cilat i shfrytëzojnë këto grupe.

Një problem tjetër po ashtu mjaft serioz mbetet edhe dyshimi mbi bashkëpunimin e avokatëve, me prokuror dhe gjykatës.

Edhe pse është shënuar progres i dukshëm në konfiskimin e narkotikëve në përgjithësi, si dhe në shkatërrimin e disa grupeve kriminale, prapëseprapë vërehet një tendencë në rritje në përdorimin dhe trafikimin e narkotikëve në vendin tonë gjatë viteve 2021-2024 dhe numri i përdoruesve të narkotikëve është rritur, e sidomos i atyre që përdorin kokainën.

Përveç luftimit të trafikimit, Policia së bashku edhe me akterë tjerë punon edhe në fushata parandaluese, edukim dhe bashkëpunim me komunitetin, për të reduktuar konsumimin e drogës.

Po ashtu, Policia dhe autoritetet tjera përgjegjëse në vend gjatë kësaj periudhe kanë qenë të mobilizuara edhe në zhvillimin e metodave më të avancuara të hetimit.

Në kuadër të parandalimit, përmes planeve operative të përbashkëta, me përfshirjen edhe të subjekteve tjera shtetërore dhe OJQ-ve, gjatë kësaj periudhe janë ndërmarrë shumë veprime parandaluese si: ligjërata në shkolla, fushata të ndryshme informuese dhe edukative për ngritjen e nivelit të vetëdijes së qytetarëve lidhur me dëmet që shkaktohen nga përdorimi i drogave dhe janë bërë përpjekje të vazhdueshme të rritet besimi për të raportuar lidhur me këtë dukuri. Po ashtu edhe në nivelin lokal është rritur bashkëpunimi me qytetarët dhe janë shtuar kontrollet dhe patrullimet në afërsi të shkollave.

Edhe pse nuk kemi të dhëna të sakta statistikore, vdekjet si pasojë e keqpërdorimit të drogës vazhdojnë të jenë një shqetësim real.

Defekti kryesor që nuk kemi të dhëna të sakta të numrit të personave të vdekur nga mbidoza është tek kërkesa e hetuesve policorë drejtuar prokurorisë dhe gjykatës. Mangësia është se për personin e vdekur, dyshimet e Policisë fillimisht janë të ndryshme, si: dyshimet për vrasje, vdekje natyrore, si dhe rrethana tjera, e më së paku ka dyshime për vdekje nga mbidoza, prandaj edhe hetuesit kur e bëjnë kërkesën për autopsi në mjekësinë ligjore, rrallëherë e përfshijnë në kërkesë edhe analizën për praninë e narkotikëve në organizmin e të vdekurit.

Është provuar shpeshherë se përdoruesit e drogave janë shkaktarë direktë ose indirektë të shumë veprave tjera penale, si: dhuna në familje, vjedhjet, grabitjet, mashtrimet, fajdet, vrasjet etj. Gjithashtu personat që kanë krijuar varshmëri nga drogat janë duke shkaktuar probleme edhe në vendet e tyre të punës.

Sa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar, janë zhvilluar disa operacione të përbashkëta me disa shtete të cilat kanë rezultuar me konfiskime të drogave dhe arrestime të të dyshuarve nga Kosova, rajoni dhe nga vende tjera.

Gjatë kësaj periudhe, Policia e Kosovës përmes zyrës ndërlidhëse me vendet tjera ILECU, pastaj si pjesë e EMPACT dhe JAD, ka shkëmbyer informacione të rëndësishme që kanë të bëjnë me trafikimin e drogave si dhe ka bërë hetime të përbashkëta.

Kosova po ashtu ka rritur përpjekjet për të luftuar prodhimin dhe trafikun e drogës edhe përmes bashkëpunimit me organizata ndërkombëtare si EUROPOL dhe agjencitë e tjera të sigurisë, duke përfshirë edhe bashkëpunimin me autoritetet e vendeve të rajonit, BE, DEA.

Duke iu referuar të dhënave statistikore dhe informatave të inteligjencës, trafikimi i drogës dhe prodhimi/kultivimi i drogës kryesisht i kanabisit, janë në tendencë të rritjes në këto vitet e fundit në vendin tonë.

Transportimi i narkotikëve drejt shteteve perëndimore, bëhet përmes autobusëve të agjencive të ndryshme që kanë linja ndërkombëtare të rregullta udhëtimi në relacionin Kosovë – shtete të Evropës Perëndimore, ku droga fshihet në vende të caktuara në autobus si dhe në valixhe të udhëtarëve.

Pastaj një mënyrë tjetër e transportit të narkotikëve drejt Evropës perëndimore bëhet edhe përmes bizneseve që merren me industrinë e drurit, duke i kamufluar nëpër mobile të ndryshme, kuzhina, dyer e dritare etj.

Ka pasur raste të transportimit të narkotikëve të llojit kokaina dhe heroina, konkretisht në Zvicër, ku narkotikët janë fshehur brenda kornizave të dyerve dhe dritareve të plastikës.

Për shpërndarje të brendshme të narkotikëve, dilerët përdorin veturat personale, vetura të marra me qira, motoçikletat, biçikletat, automjetet e llojit të "postave të shpejta", taksitë e ndryshme etj.

Sipas informatave të inteligjencës është identifikuar dukuria e dyshuar kriminale e shitjes dhe shpërndarjes së narkotikëve përmes disa taksive në Kosovë, shoferët e të cilave përveç punës si taksist dyshohet se kryejnë edhe aktivitete tjera kriminale gjatë punës së tyre.

Ata kontaktojnë privatisht me klientët përmes telefonit dhe merren vesh për çmimin dhe vendin. Dyshohet se këta shoferë pasi punësohen në këto kompani taksie kërkojnë që të punojnë veç në ndërrimin e natës, sepse shumica e këtyre aktiviteteve të jashtëligjshme kryhen gjatë natës.

Një mënyrë tjetër e shitjes është në lokacione të caktuara ku dilerët i shesin narkotikët në lokacione të caktuara e që janë objektet e braktisura, shtëpitë e papërfunduara, diskoteka, kafiteri, lokale bixhozi, autolarje, parqe, përreth shkollave, lokale ku luhen lojërat kompjuterike, bilardo, stacione të autobusëve etj., pra konsumuesit e dinë lokacionin ku mund të furnizohen.

Si rezultat i zhvillimit të teknologjisë, grupet kriminale kanë arritur të kenë komunikim modern dhe të fshehtë ndërmjet vete dhe kjo paraqet problem për Policinë në identifikimin apo përcjelljen e tyre, për shkak të mungesës së pajisjeve teknike të mjaftueshme e të sofistikuar, të cilat mundësojnë përgjimin e rrjeteve të ndryshme sociale dhe linjave ilegale të komunikimit.

Trafikantët e drogës, lidhur me aktivitetin e tyre kriminal, komunikojnë ndërmjet vete përmes rrjeteve sociale dhe aplikacioneve të ndryshme.

Sipas inteligjencës dyshohet se disa grupe të trafikantëve janë duke shfrytëzuar aplikacionin 'Telegram', ku janë duke komunikuar ndërmjet vete përmes aplikacionit të mesazheve 'Nicegram', ku komunikimet e tyre kodohen dhe ruhen në serverët e Telegramit.

Në këtë grup bëhet shitblerja e narkotikëve, armëve, kartelave bankare, veturave, maskave, parave të falsifikuara, jelekëve antiplumb etj.

Bazuar në të dhënat policore lidhur me konfiskimin e narkotikëve (drogave kryesore), krahasimi në mes të dy periudhave 2017-2020 dhe 2021-2024 është si vijon:

Heroina - në periudhën e fundit ka rritje të konfiskimit të heroinës krahasuar me periudhën paraprake;


Kokaina - në periudhën e fundit ka rritje të madhe të konfiskimit të kokainës krahasuar me periudhën paraprake. Kjo rritje kaq e madhe i dedikohet një rasti të vetëm në vitin 2021 ku janë konfiskuar 414.9 kg kokainë përnjëherësh;

Marihuana - në periudhën e fundit ka rënie të konfiskimit të marihuanës edhe pse ky lloj narkotiku është më i përhapuri në Kosovë.

Periudha	Heroina	Kokaina	Marihuana
2017-2020	136 kg	6.5 kg	3968 kg
2021-2024	281 kg	438 kg	3034 kg


Tabela më lartë paraqet konfiskimet e tri drogave kryesore në dy periudhat kohore 2017-2020 dhe 2021-2024.

Sasia e drogave të konfiskuara gjatë periudhës 2017-2020



Grafikoni më lart paraqet konfiskimet e tri drogave më të përhapura gjatë viteve 2017 – 2020.

Sasia e drogave të konfiskuara gjatë periudhës 2021-2024



Grafikoni më lart paraqet konfiskimet e tri drogave më të përhapura gjatë viteve 2021 – 2024.

Referuar të dhënave statistikore dhe të dhënave të inteligjencës, kemi të bëjmë me rritje të prodhimit/kultivimit të kanabisit gjatë viteve të fundit. Në disa pjesë të caktuara të territorit, veçanërisht në zona më të izoluara dhe të thella, janë hasur plantacione të kultivuara me kanabis, kryesisht në rajonin e Pejës dhe Gjakovës, zona këto që kanë një klimë më të favorshme, breza kufitarë malorë dhe kushte të tjera të përshtatshme për kultivimin e kanabisit.

Po ashtu, një tendencë në rritje është edhe kultivimi "indoor" i kanabisit, kryesisht në zonën e Mitrovicës Veriore. Grupet kriminale, kanë arritur të krijojnë plantacione të brendshme dhe kushte solide për kultivimin e kanabisit, por me shtrirjen e autoritetit të kontrollit në territor, këto grupe kriminale dhe plantacionet e tyre janë shkatërruar.

Megjithatë, ende mbeten sfida të mëdha për të kontrolluar në tërësi këtë aktivitet, veçanërisht në zona malore të brezit kufitar ose zona më të vështira për t'u monitoruar.

Për të realizuar rendimente më të larta dhe cilësi sa më të madhe nga kultivimi i kanabisit, grupet kriminale kanë angazhuar punëtorë me përvojë nga Shqipëria, të cilët kanë njohuri të mëhershme në kultivimin dhe përpunimin e kanabisit.

Gjatë viteve 2021-2024, janë zbuluar 16 laboratorë të kultivimit të kanabisit nëpër rajone të ndryshme të Kosovës, prej tyre 8 laboratorë janë në veri të Kosovës. Lidhur me këto raste të kultivimit të kanabisit janë arrestuar 33 persona të nacionaliteteve të ndryshme.



Laborator për kultivimin e kanabisit me pajisje ventilimi, dritë, ngrohje etj.

Disa nga laboratorët "indoor" të kanabisit të gjetur në rajonin e Mitrovicës Veriore dhe të Prishtinës, për të arritur rendimente dhe cilësi optimale, kanë qenë të pajisur me të gjitha pajisjet e nevojshme për kultivim, kanë qenë me sistem ventilimi, me dritë elektrike, me sistem të ngrohjes, matës të temperaturës dhe matës të lagështisë etj.

Duke u bazuar në të dhënat policore lidhur me konfiskimin e bimëve të kanabisit dhe duke bërë krahasimin e periudhës 2017-2020 me periudhën 2021-2024, vërehet se në periudhën e katër viteve të fundit ka konfiskim gati trefish më shumë sesa në periudhën paraprake.

Viti	Bimë Kanabisi	Viti	Bimë Kanabisi
2017	5898	2021	2380
2018	259	2022	24502
2019	7060	2023	21991
2020	5622	2024	7126
Totali	18839 bimë		55999 bimë

Konfiskimi i bimëve të kanabisit 2017-2020 dhe 2021-2024

Faktorët kontribuues

Dëshira për të arritur përfitime financiare të mëdha dhe të lehta, veçanërisht tek disa të rinj, është një faktor i rëndësishëm që nxit përfshirjen e tyre në aktivitetet e paligjshme si shpërndarja e drogave. Ata llogarisin mungesë të perspektivës për të ardhmen dhe mundohen që ta shfrytëzojnë brishtësinë e mjedisit ekonomik për të krijuar një klimë të favorshme për kriminalitet.

Faktor tjetër kontribuues është edukimi jo i mjaftueshëm për pasojat nga përdorimi nga ana e abuzuesve, pastaj ofrimi i programeve jo të mjaftueshme edukative në shkolla për rreziqet e drogave.

Aktualisht në disa nga lëndët mësimore në shkolla, trajtohet çështja e drogave dhe substancave të tjera të dëmshme, por duke u bazuar në rritjen e numrit të përdoruesve gjithnjë e më tepër mund të konkludohet se vetëm këto programe nuk janë të mjaftueshme për të zvogëluar rrezikun por ka nevojë të ndërmerren edhe veprime tjera.

Edhe pamjaftueshmëria e institucioneve rehabilituese është një faktor tjetër kontribuues kur dihet se Kosova ka kapacitete të kufizuara për rehabilitimin e të varurve nga droga. Aktualisht Kosova ka reparte të psikiatrisë në Qendrën Klinike dhe Universitare dhe nëpër spitalet rajonale, në të cilat kërkojnë trajtim numër i caktuar i abuzuesve si dhe furnizim me metadon, por trajtimi i pacientëve që kanë varësi nga substancat narkotike, është afatgjatë dhe i vështirë. Prandaj, ndërtimi i ndonjë qendre rehabilituese për trajtime më afatgjate, që do të ishte nën ombrellën e institucioneve shëndetësore të shtetit do të ishte mëse i nevojshëm për personat të cilët duan të dalin nga varësia.

Sipas informacioneve të inteligjencës thuhet se përdoruesit e metadonit në rajonin e Pejës, sipas listës së mjekut, furnizohen vetëm një herë në javë dhe se ky furnizim nuk i plotëson mjaftueshëm nevojat e pacientëve, prandaj pacientët detyrohen të gjejnë alternativa tjera, ku sipas informacioneve thuhet se për furnizim plotësues me metadon ata kanë gjetur një laborator ilegal në një lokacion të panjohur diku në Prishtinë.

Edhe pse nuk posedojmë informacione për rajonet tjera, ka mundësi që edhe në këto rajone furnizimi me metadon nuk është i mjaftueshëm, dhe nëse është kështu, atëherë ekziston mundësia që edhe laboratorë tjerë mund të jenë duke operuar ilegalisht.

Në shumë raste, të varurit nga droga orientohen për rehabilitim afatgjatë në qendra jashtë Kosovës dhe se ky rehabilitim është barrë e rëndë financiare për familjen e përdoruesit pasi që kushton shtrenjtë.

Mungesa e anëtarësimit të Kosovës në INTERPOL, mekanizmat tjerë dhe mungesa e bashkëpunimit më shtetet jonjohëse shfrytëzohet nga kriminelët, personat në kërkim dhe terroristët.

Rrethanë tjetër që favorizon grupet e krimit të organizuar është mosanëtarësimi i Policisë së Kosovës në organizatën ndërkombëtare të sigurisë INTERPOL. Për pasojë, Policia e Kosovës ka mungesë të bashkëpunimit me shtetet jonjohëse dhe mungesa e qasjes së drejtpërdrejtë të të dhënave në lidhje me personat në kërkim, ata mund të hyjnë dhe dalin nga Kosova pa u zbuluar nga policia kufitare.

Lidhur me këtë, në një analizë të publikuar në vitin 2022 nga “Global Initiative”, thuhet se rezultati paradoksal është se Kosova kritikohet se nuk ka bërë përpjekje të mjaftueshme për të luftuar krimin e organizuar ndërkombëtar, edhe pse, pjesërisht, pengohet nga mungesa e qasjes në informacione dhe nga operacionet e përbashkëta që realizohen nëpërmjet punës së këtyre organizatave.

Qendra për trajtimin e personave me varësi nga drogat OJQ “Labyrinth”

Përveç qendrave spitalore, me trajtimin e të varurve nga droga merret edhe OJQ “Labyrinth”, e cila përbëhet nga profesionistë të fushës së mjekësisë dhe psikologjisë, që merren me trajtimin e varësisë nga drogat dhe alkooli, duke përfshirë këshillim, psikoterapi, farmakoterapi, terapi mbajtëse me metadon, detoksikim ambulant për drogat opiate, si dhe teste të shpejta të detektimit të drogës në organizëm 1 .

Sa iu përket numrit të përdoruesve të drogave në Kosovë, OJQ Labyrinth sipas matjeve të tyre kohë pas kohe ka dalë me disa shifra. Në SOCTA 2022 i kemi referuar publikimeve të kësaj OJQ e cila jepte shifrën për rreth 40 000 përdorues, ndërsa sipas të dhënave të fundit të publikuara në media, zyrtarë të kësaj qendre japin shifrën për 35 000 përdorues, pra 5 000 përdorues më pak.

Kjo nuk do të thotë se ka rënë numri i përdoruesve mirëpo besohet se kohëve të fundit kanë arritur të bëjnë një hulumtim më kredibil. Po ashtu sipas Labyrinth mosha mesatare e fillimit të përdorimit të narkotikëve ka qenë diku 17.8 vjeç tash ka rënë në 16 vjeç, ndërsa përqindja sipas gjinisë është rreth 35% gra dhe vajza dhe 65% janë meshkuj 2.

Sipas të dhënave nga kjo qendër, numri i personave të trajtuar nga drogat në këtë institucion gjatë viteve 2021-2024, arrin deri në 1250 persona, ku prej tyre 556 persona janë përdorues të heroinës, 404 të marihuanës etj. (Shih tabelën më poshtë).

NUMRI I PERSONAVE TË TRAJTUAR NGA DROGAT NË OJQ "LABYRINTH"




Tabela më lart paraqet numrin e personave të trajtuar për pasojat nga drogat në OJQ Labyrinth – periudha 2021 - 2024

1 <https://riskbulletins.globalinitiative.net/see-obs-017/01-how-criminals-exploit-kosovos-political-challenges.html>

2 <https://gazetablic.com/35-mije-perdorues-aktiv-te-droges-ne-kosove-flasin-nga-qendra-labyrinth-kjo-eshte-mosha-me-e-re-e-perdoruesve/>

Vitet	2021		2022		2023		2024		Totali sipas gjinisë	
	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F
Nën 14 vjeç	4	6	2	3	2	3	3	5	11	17
14-18 vjeç	10	13	12	8	13	6	9	6	44	33
30-45 vjeç	211	7	288	9	210	8	181	9	890	33
Mbi 45 vjeç	54	3	48	2	51	4	55	5	208	14

Tabela më lart paraqet të dhënat e OJQ "Labyrinth", ku 923 persona të trajtuar në këtë qendër janë të grup moshës 30-45 vjeç. Shqetësues është fakti se 28 persona janë nga grupmosha nën 14 vjeç.

Sipas të dhënave, vetëm gjatë viteve 2021-2024, nga lista e personave që janë trajtuar me programe të metadonit, janë identifikuar gjithsej 30 raste të vdekjeve të dyshimta nga mbidoza, apo edhe si rezultat i përdorimit të përzierjeve të drogave të rrezikshme. Prej tyre më i riu në moshë ka qenë 18 vjeç, ndërsa shumica e viktimave kanë qenë mbi moshën 45 vjeçe³.

MARIHUANA

Kosova vazhdon të mbetet një vend i rëndësishëm për grupet e trafikimit me marihuanë, edhe si vend destinacion, por edhe si vend transit për trafikimin e saj.

Kjo situatë është ndikuar nga disa faktorë, përfshirë rritjen e kërkesave për përdorimin e saj, afërsia gjeografike me

vendin e origjinës së kësaj substance që është Shqipëria, përfitimet financiare të konsiderueshme si dhe bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet grupeve kriminale vendore me ato rajonale dhe më gjerë.

Sipas të dhënave zyrtare, marihuana vazhdon të jetë droga më e përhapur në Kosovë, me shtrirje në të gjitha qendrat urbane dhe në zonat rurale. Zbulimi i disa plantacioneve si dhe laboratorëve për kultivimin e marihuanës në disa lokacione, jep indikacione të qarta se përveç importit nga Shqipëria, marihuana është duke u kultivuar edhe brenda vendit me një dinamikë të shtuar e cila në të ardhmen do të paraqet problem serioz dhe sfidë në luftimin dhe parandalimin e kësaj dukurie.



Foto më lart e vitit 2021 - marihuana duke u tharë në nënkulmin e një shtëpie

Sasia më e madhe e marihuanës së konfiskuar në Kosovë ose rreth 95% e marihuanës ka rezultuar se është nga Shqipëria. Po ashtu sasia më e madhe e marihuanës nga Shqipëria, kalon transit nëpër Kosovë dhe vazhdon në Serbi dhe në vendet tjera. Si ilustrim të kësaj rruge të trafikimit, kemi raste kur policia nga shtetet fqinje ka konfiskuar me dhjetëra kilogramë marihuanë me origjinë nga Shqipëria e cila kishte kaluar transit nëpër Kosovë.

Marihuana futet në Kosovë edhe nga Maqedonia e Veriut, ku atje kultivimi i kanabisit për qëllime mjekësore është i

lejuar dhe shumë kompani kanë licenca për kultivimin e tij dhe ka dyshime se një sasi kalon në tregun e zi dhe përfundon në Kosovë.

Grupet e krimit të organizuar nga rajoni, transportimin e marihuanës nga Shqipëria drejt vendeve të Evropës Perëndimore e bëjnë me anë të veturave brenda të cilave janë modifikuar bunkerë enkas për fshehjen e narkotikëve.

Punimet e këtyre bunkerëve kryhen në një lokacion të panjohur në Shqipëri ku edhe mbushen me lëndë narkotike dhe pastaj përmes Kosovës transportohen në drejtim të Evropës.




Foto më lart tregon marihuanën e gjetur nga policia të fshehur në gomën e veturës

Një trend gjithnjë e në rritje me një fitim shumë të lartë, është trafikimi i marihuanës edhe për në Turqi, ku grupe kriminale nga Kosova dhe Turqia në bashkëpunim dërgojnë marihuanë në Turqi dhe në kompensim marrin heroinë të pastër të cilës i shtojnë përbërës tjerë dhe e transportojnë në Evropën Perëndimore.

Marihuana, me destinacion Kosovën, bartet në sasi më të vogla, përmes pikëkalimeve kufitare, e fshehur në vetura, në autobus të udhëtarëve, si dhe në kamionë me mallra komerciale.

Përdoruesit e marihuanës në vendin tonë, janë nga të gjitha kategoritë shoqërore duke filluar nga ajo më e varfër, e mesme e deri te shtresat më të pasura. Sa i përket moshës, përdorimi i marihuanës nuk kufizohet vetëm tek të rinjtë, por shtrihet edhe deri te moshat e vjetra deri në 60 vjeç.

Çmimi i marihuanës në tregun kosovar, sillet në shifrat rreth 5-7 € për një gram, ndërsa varësisht nga lloji dhe kualiteti, një kilogram marihuanë arrin shumën 1000-1600€. Marihuana e kultivuar në

laboratorët “indoor” shitet deri në 20 € për një gram, ndërsa çmimi për një kg varion 1500-2500€.

Në bazë të të dhënave, marihuana që përdoret për konsum të brendshëm rezulton se është e një cilësie më të ultë krahasuar me marihuanën e cila është e destinuar për në vendet evropiane e cila ka cilësi dhe kualitet më të lartë.

Gjatë viteve 2021-2024 janë raportuar 2231 raste të trafikimit dhe posedimit të marihuanës, me ç’rast janë arrestuar 2776 persona të dyshuar.




Tabela e rasteve me marihuanë dhe numri i të arrestuarve 2021-2024

Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, del se në periudhën 2021-2024 kemi mbi 900 kg marihuanë më pak të konfiskuar sesa në periudhën e njëjtë 2017-2020. Bazuar në informacione të cilat flasin për rritjen e numrit të konsumuesve atëherë mund të konkludohet se kemi edhe rritje të sasisë së trafikuar të marihuanës, por arsyeja e konfiskimit më pak të kësaj substance gjatë periudhës së fundit mund të ndërlidhet edhe me fokusin e madh të të gjitha institucioneve, veçmas atyre të sigurisë në qetësimin e situatës së sigurisë në rajonin e Mitrovicës veriore.

Viti	Marihuana/kg	Viti	Marihuana/kg
2017	1908.1	2021	499.5
2018	978.8	2022	662.6
2019	824.2	2023	601.1
2020	256.7	2024	1279.8
Totali	3968.8		3043

Grupet kriminale që merren me trafikim të marihuanës, ekspozohen shumë, bëjnë jetë luksoze dhe kanë shpenzime të pakontrolluara. Dysohet se paratë e fituara nga krimi, këto grupe i investojnë në restorante, banesa, vetura, dyqane tekstili etj.

Tabela e konfiskimeve të marihuanës – 2017-2020 dhe 2021-2024

Këto grupe kriminale kanë krijuar lidhje të qëndrueshme me furnizues nga Shqipëria, të cilët në shumicën e rasteve arrijnë ta transportojnë narkotikun përmes pikave kufitare, duke i kamufluar me mallra ose duke e shmangur kontrollin zyrtar, ata shfrytëzojnë rrugë malore dhe shtigje të pashkelura, duke e bërë trafikimin më të vështirë për t'u luftuar nga Policia.

Në trafikimin e marihuanës, grupet kriminale kosovare bashkëpunojnë ngushtë me grupe të ngjashme nga vende të tjera. Ky bashkëpunim veçanërisht është i theksuar me grupet kriminale nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Serbia, Turqia, si dhe nga disa vende të Bashkimit Evropian.

Grupet kriminale që merren me trafikim të marihuanës zakonisht janë divergjente me nga 4 - 5 persona dhe nuk kanë ndonjë organizim strukturor ashtu si grupet tjera të njohura në nivel ndërkombëtar.

KOKAINA

Grupet e trafikimit të kokainës nga Kosova, Shqipëria, Serbia dhe Mali i Zi, e kanë kthyer në një nyje të rëndësishme trafikimin e kokainës në rajon për shkak të pozicionit gjeografik dhe po luajnë rol gjithnjë e më të madh në këtë zinxhir, por edhe për shkak të kufijve lehtë të depërtueshëm, infrastrukturës rrugore gjithnjë e më të mirë por edhe faktorë tjerë po aq të rëndësishëm.

Kosova në këtë trafikim është duke u përdorur nga këto grupe si pikë kalimi transit drejt vendeve si Serbia ose Maqedonia e Veriut dhe më tej drejt vendeve tjera evropiane, pastaj është duke u përdorur edhe si vend deponimi i përkohshëm, si dhe pikë për shpërndarje për konsum të brendshëm.

Grupet kriminale nga Kosova shpeshherë operojnë së bashku me grupet kriminale nga rajoni ose paralelisht, për transportimin e kokainës por edhe për gjetjen e formave për pastrimin e parave përdorin njerëz nga diaspora e cila gjendet në shtetet kryesore të Evropës.

Kosova vazhdon të mbetet në nivel të ulët të pranimit të kokainës, krahasuar me vendet tjera me popullsi të madhe për shkak të numrit të vogël të popullsisë, por ka tendencë në rritje gjithnjë e më shumë në përdorim, ndërsa si vend transit

- Në sasi të vogla prej 200 gr deri në 2 kg të cilën e fshehin nëpër pjesë të trupit apo në ndonjë vend të posaçëm në automjete, dhe pastaj përmes dilerëve e shesin në sasi të vogla.
- Të kamufluar në kamionë me mallra.

Konsumues të kokainës në Kosovë janë kryesisht shtresa e mesme e shoqërisë, e që besohet se numri i tyre është 3000, të moshës 25-50 vjeç, ku shumica e tyre janë të gjinisë mashkullore. Shqetëson fakti se përdorues të kokainës janë personat edhe nën moshën 30 vjeç, përderisa në të kaluarën përdoruesit e kësaj substance narkotike kanë qenë kryesisht të moshës 35-45 vjeç.

Sipas të dhënave nga hetimet si dhe të dhënave të inteligjencës, kokaina me pakicë në Kosovë shitet 50 - 80 € për gramë, ndërsa 35 000-50 000 € për kilogramë, varësisht nga kualiteti.

mbetet gati me nivele të njëjta me të kaluarën por me një tendencë të lehtë të rritjes për shkak të rritjes së kërkesës kudo në treg.

Siç është e ditur, furnizimi me kokainë vjen nga shtete të Amerikës latine, e cila si pikë transiti ka portet detare të Shqipërisë, ku më pas, varësisht nga kërkesat dhe bashkëpunimi i grupeve kriminale trafikohet në Kosovë dhe rajon, për konsum të brendshëm dhe destinim për vendet tjera evropiane.

Sasia më e madhe e kokainës futet në Kosovë nga Shqipëria kryesisht përmes pikëkalimeve kufitare apo rrugëve malore, në disa raste edhe nga Serbia, si dhe në ndonjë rast të rrallë edhe nga Maqedonia Veriore.

Sipas informacioneve, trafikantët kokainën nga Shqipëria në Kosovë e sjellin në dy mënyra:

Kokaina e konfiskuar në Kosovë gjatë viteve 2021-2024 është gjetur në formë të pluhurit dhe në formë të ngurtë të llojit "crack".


Grupet kriminale që merren me trafikim të kokainës janë grupe shumë të sofistikuara dhe janë shumë pak të ekspozuara në publik. Ato janë grupe të ndryshme, nuk kanë ndonjë organizim strukturor si grupet tjera në nivel ndërkombëtar.

Kryesisht kemi të bëjmë me grupe nga 4 deri 5 anëtarë.

Ka indikacione se shtetas kosovarë janë të involvuar në trafikun ndërkombëtar të kokainës, mirëpo këta individë veprimtarinë kriminale besohet se e zhvillojnë nga vendet e zhvilluara si: Holanda, Anglia, Gjermania, Spanja, Franca, Zvicra etj. dhe besohet se në të shumtën e rasteve janë nën hijen e grupeve kriminale nga Shqipëria, Serbia, Mali i Zi etj.

Numri i përgjithshëm i konfiskimeve të kokainës u rrit gjatë vitit 2021 me një konfiskim rekord prej 400 kg kokainë të pastër nga vendet e Amerikës Latine, ndërsa është futur në Kosovë nga Republika e Shqipërisë (porti detar i Durrësit) me kamion, e fshehur në kontejner në pako të mishit të pulës dhe dyshohet se kishte për qëllim tregun e jashtëm.

Numri i rasteve me Kokainë gjatë periudhës 2021-2024



Grafikoni më lart - Gjatë periudhës 2021-2024 janë raportuar 239 raste të trafikimit dhe posedimit të kokainës, me ç'rast janë arrestuar 337 persona të dyshuar lidhur me këtë aktivitet.

Viti	Kokaina/kg	Viti	Kokaina/kg
2017	0.7	2021	414.9
2018	1.5	2022	4.4
2019	1.6	2023	5.4
2020	2.7	2024	14.1
Totali	6.5	Totali	438.8

Tabela më lart - Konfiskimet e narkotikut kokaina në periudhat 2017-2020 dhe 2021-2024.

Rrezik aktual për shëndetin e të rinjve paraqet përdorimi i një lloji të kokainës që quhet me emrin “crack cocaine”, që nxirret nga kokaina e cila shkakton varshmëri të shpejtë, dhe përveç efekteve kryesore negative të kokainës, kjo e rrit agresivitetin dhe shpeshësinë e përdorimit si dhe shkakton edhe probleme të tjera anësore sikur çrregullimet psikologjike ⁴.

Heroina

Në nivelin lokal, viteve të fundit heroina ka një rënie si në trafikim dhe në konsumim dhe se numri i konsumuesve të rinj nuk vërehet se ka ndonjë rritje të madhe e që ky numër në Kosovë konsiderohet të jetë rreth 2000 konsumues, mirëpo kohëve të fundit mund të konstatohet se ka rritje të konfiskimit dhe efikasitet më të madh të policisë dhe doganës në luftimin e këtij trafikimi.

Vlerësohet se heroina është ndër shkaktarët më të mëdhenj për vdekjet e përdoruesve të drogave edhe pse nuk posedojmë të dhëna të sakta për numrin e këtyre vdekjeve.

Grupet kriminale kosovare furnizohen në Turqi me heroinën e Afganistanit si vend burimor i kësaj substance, të cilën më pastaj e sjellin në Kosovë përmes Bullgarisë, Maqedonisë së Veriut, kryesisht në sasi nga 15kg deri në 200kg për një transport.

Në Kosovë, në shumicën e rasteve, heroina përzihet me sasi të caktuara të prekursorëve, me qëllim të rritjes së sasisë dhe përfitimeve financiare, të cilën pastaj e transportojnë përmes Serbisë, në Austri, Gjermani etj.

Po ashtu ka informacione se ekziston një

rrjet tjetër i trafikimit të heroinës nga një grup kriminal nga Mali i Zi në bashkëpunim me një grup nga Serbia dhe një grup nga Turqia të cilët e transportojnë heroinën nëpër Kosovë, nëpër Serbi dhe më tej me destinacion Zvicrën. Ata e transportojnë drogën nga Turqia në Kosovë përmes autobusëve dhe kompanive të ndryshme që transportojnë produkte të elementeve shtëpiake ku përfshihen pllakat, mobilet etj, ndërsa nga Kosova deri në Zvicër përmes mjeteve tjera të transportit të udhëtarëve dhe të mallrave.


Një ndër faktorët favorizues të trafikut të heroinës janë lidhjet e mira ekonomike dhe tregtare të Kosovës dhe të vendeve të rajonit me Turqinë, pastaj afërsitë familjare të personave nga Kosova dhe rajoni me persona nga Turqia.

Për dërgesa jashtë vendit në sasi nga 1kg deri 10kg, trafikantët e heroinës, angazhojnë persona të sigurtë, me shtetësi kosovare, me të cilët janë në lidhje familjare apo janë në shoqëri dhe të cilët kanë leje qëndrimi në ndonjë shtet evropian, duke ua rregulluar bunkerët special për fshehje të narkotikëve në vetura, si dhe pastaj përmes agjencive të ndryshme të udhëtimit autobusëve, kamionëve që transportojnë mallra për në vendet perëndimore etj.

⁴ PK-Drejtorja e Hetimit të Trafikimit me Narkotikë - DHTN, <https://indeksonline.net/rritet-perdorimi-i-kokaines-ne-kosove-blakaj-gjithnje-e-me-shume-te-rinj-po-e-perdorin-ate-ne-baza-ditore/>

Edhe sasitë e vogla të heroinës, trafikantët i fusin dhe i nxjerrin nga Kosova, përmes pikëkalimeve kufitare, duke i fshehur në bunkerë të posaçëm të ndërtuar brenda veturave, si dhe autobusëve të udhëtarëve etj.

Numri i rasteve me Heroinë dhe personave të arrestuar gjate periudhes 2021-2024



Grafikoni më lart - Në periudhën 2021-2024 kemi 72 raste të trafikimit dhe posedimit të heroinës, me ç'rast janë arrestuar 141 persona të dyshuar.

Gjatë periudhës 2021-2024, veç tjerash, janë zbuluar edhe dy laboratorë të përpunimit të heroinës dhe pajisje për përzierje e paketim.

Viti	Heroina/kg	Viti	Heroina/kg
2017	0.4	2021	3.6
2018	119	2022	246.6
2019	7.7	2023	2.9
2020	8.9	2024	27.9
Totali	136	Totali	281

Konfiskimi i heroinës - krahasimi në mes dy periudhave kohore 2017-2020 dhe 2021-2024 ku shihet se në periudhën e fundit janë konfiskuar më shumë se dyfish heroinë sesa në periudhën e mëhershme.

Porositë dhe komunikimin për heroinën, trafikantët e bëjnë në të shumtën e rasteve edhe në gjuhën turke, përmes aplikacionit "SKY" (i cili njihet si një mjet komunikimi i përdorur gjerësisht nga grupe kriminale ndërkombëtare) dhe telefonave të veçantë të blerë në Serbi, të cilët përpunohen në atë mënyrë që të mos e kenë funksional GPS-in, sistemin audio dhe të kamerave, në mënyrë që të mos gjurmohen nga policia.

Sa i përket profilit të konsumuesve, ata janë nga të gjitha shtresat shoqërore, duke filluar nga ajo më e varfër e deri te shtresat e larta. Përdorimi i heroinës nuk kufizohet vetëm tek të rinjtë, por shtrihet deri në moshën 50 vjeç dhe se është më i përhapur tek gjinia mashkullore.

Sipas disa të dhënave jozyrtare, vlerësohet se numri i përdoruesve aktivë të heroinës në Kosovë arrin shifrën rreth 2000 persona.

Çmimi i heroinës në tregun kosovar, sillet në shifrat rreth 50-70€ për një gram, ndërsa varësisht nga kualiteti, një kilogram arrin shumën 15 000-20 000€.

Për sa i përket cilësisë, bazuar në konfiskimet dhe të dhënat tjera, arrihet në përfundim se heroina që shitet me pakicë është e cilësisë së mirë, ndërsa heroina që vjen direkt nga Turqia me shumicë është e cilësisë shumë të mirë.

Një trend në rritje me një fitim shumë të lartë financiar, është trafikimi i marihuanës në Turqi, i cili bëhet nga trafikantë kosovarë në bashkëpunim me grupe kriminale nga Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria.

Këta trafikantë e dërgojnë marihuanën deri në 1 ton në Turqi dhe e shkëmbejnë me heroinë. Në këtë aktivitet trafikantët kosovarë bashkëpunojnë edhe me grupe nga Serbia dhe Turqia. Në territorin e Kosovës, trafikantët e shpërndajnë heroinën varësisht prej kërkesave nëpër rajone të ndryshme. Ata e shpërndajnë tek nëngrupet kriminale, të cilat më pas i furnizojnë përdoruesit përmes dilerëve.

Këto nëngrupe nuk janë të profilizuara vetëm për shitjen e një lloji të veçantë të drogës por të gjitha drogave në përgjithësi.

Grupet kriminale që merren me trafikimin e heroinës janë shumë të sofistikuara dhe nuk kanë një hierarki të rreptë organizative; ato më tepër funksionojnë me një strukturë të lirshme. Kryesisht kemi të bëjmë me grupe nga 4 deri 5 anëtarë.

Sa i përket përdorimit të dhunës nga grupet kriminale, ka indikacione që ndonjëherë është përdorur si mjet për zgjidhjen e konflikteve në mes të grupeve, ose ndaj ndonjë klienti që nuk i ka përmbushur detyrimet financiare.

Veçanërisht në të kaluarën, dyshohet se janë shënuar edhe raste vrasjesh si pasojë e këtyre përplasjeve në mes të grupeve kriminale.

Duke pasur parasysh përfitimet e larta materiale si dhe kërkesat për këtë lloj narkotiku në tregun e brendshëm dhe evropian, vlerësohet se ka tendencë që grupet kriminale në Kosovë të cilat merren me trafikim ndërkombëtar të heroinës, të jenë edhe më aktive. Po ashtu vërehet një bashkëpunim i shtuar i grupeve kriminale nga Kosova me grupet kriminale nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, bashkëpunim ky që mund të qojë edhe në rritjen e tregut të këtij narkotiku.

Drogat sintetike

Drogat sintetike janë të përhapura në Kosovë, por jo në masë të madhe, por tendencat janë se do të kemi shtim të numrit të përdoruesve sidomos tek të rinjtë, kryesisht në qendrat e mëdha por edhe në qytetet e vogla. Deri tani kemi të dhëna se disa nga të rinjtë janë duke përdorur droga sintetike të llojeve LSD, ekstazi dhe amfetaminë.

Drogat kryesore sintetike të pranishme në territorin e Kosovës janë: LSD, ekstazi, amfetamina, metamfetamina etj. Këto substanca narkotike kryesisht vijnë nga Holanda, Gjermania, Serbia etj. Transportimi i tyre bëhet kryesisht duke i fshehur në vende të posaçme brenda veturave, por ka raste edhe përmes dërgesave postare brenda në zarfe.

Një sasi relativisht e vogël e këtyre drogave sintetike të trafikuar, ndalet për konsum të brendshëm në vendin tonë, ndërsa pjesa tjetër dërgohet në Shqipëri sidomos gjatë sezonit veror turistik kur numri i të rinjve përdorues është i madh.

Përdoruesit e drogave sintetike në vendin tonë janë nga shtresa e varfër e deri te shtresat e pasura. Mosha e përdoruesve është përafërsisht nga 17 deri në 40 vjeç, me numrin më të madh të gjinisë mashkullore.

Nuk kemi statistika zyrtare për numrin e përdoruesve të drogave sintetike, por përdoruesit e këtyre drogave janë edhe përdorues të llojeve tjera të drogave, si heroina, kokaina dhe marihuana.

Sipas inteligjencës, furnizimin kryesor me substancën narkotike të quajtur ekstazi trafikantët në Kosovë e bëjnë në rajonin e Mitrovicës veriore.


Çmimi i drogës ekstazi në tregun kosovar, sillet në shifrat 5-7 € për një tabletë varësisht nga prodhuesi dhe nga cilësia.

Sa i përket cilësisë së drogave sintetike dhe duke u bazuar në konfiskimet dhe intervistimet e përdoruesve, rezulton se këto droga janë kryesisht të një cilësie mesatare.

Drogat sintetike të konfiskuara në Kosovë janë gjetur në formë të pilulave (formë e ngurtë), kristaleve të sintetizuara kimikisht, në formë të lëngët por edhe në formë të bonboneve.

Gjatë kësaj periudhe, në Prishtinë është zbuluar një laborator për përpunim të drogave sintetike, ku janë arrestuar dy persona të dyshuar dhe janë konfiskuar përbërës të ndryshëm që shërbejnë për përfitimin e drogave sintetike.

Rastet me droga Sintetike për r periudhën 2021-2024



Grafikoni më lart – Tregon se në periudhën 2021-2024 kemi 55 raste me droga sintetike, me ç'rast janë arrestuar 72 persona të dyshuar.

Të dyshuarit që merren me trafikimin e drogave sintetike nuk operojnë si grupe tipike të organizuara kriminale por janë të angazhuar si individë ose si grupe të vogla dhe përbëhen kryesisht prej 1-4 pjesëtarë.

Kosova, ndonëse nuk është vend prodhues i substancave narkotike (përveç kultivues i kufizuar i kanabisit), është gjithnjë e më shumë e përfshirë në zinxhirët e trafikut ndërkombëtar, kjo për shkak të pozitës gjeografike, dobësive në kontrollin kufitar dhe rritjes së kërkesës lokale dhe ndërkombëtare për droga, sidomos për drogat kryesore si kokaina, marihuana, heroina dhe drogat sintetike.

Duke u bazuar në rrjedhën e përhapjes së trafikimit me narkotikë dhe rritjen gjithnjë e më shumë të numrit të abuzuesve, parashikimet për të ardhmen janë se rrjetet kriminale do të bëhen gjithnjë e më të forta ekonomikisht dhe të sofistikuara teknologjikisht dhe do përdorin më shumë rrugë digjitale (kripto valuta, dark web, komunikime të enkriptuara) për të arritur qëllimet.

Kosova edhe më tej do të mbetet nyje kalimi dhe transiti përmes rrugëve tashmë të njohura si “rrugët ballkanike”, por edhe me rritje të ndjeshme të trafikut për konsum të brendshëm.

Do të mund të ketë ndryshim në profilin e trafikantëve dhe përdoruesve ku pritet shtim i përfshirjes së grupeve lokale më të vogla, që operojnë si nënkontraktorë të rrjeteve më të mëdha.

Të rinjtë dhe të papunët do të jenë edhe më të ndjeshëm ndaj përfshirjes në shpërndarje për përfitime financiare.

Përdorimi i drogës sintetike (si ekstazi, amfetamina, crack kokaina) do të rritet sidomos në qytete dhe rreth zonave universitare. Duke u bazuar në përhapjen e drogës së rrezikshme “fentanil” në SHBA dhe paralajmërimeve që kjo drogë sintetike së shpejti mund të gjendet në Evropë, ekziston mundësia që edhe vendi ynë dhe rajoni, në të ardhmen të përballen me rreziqet dhe pasojat që shkakton ky narkotik.

Duke pasur parasysh të gjitha këto më lart, por edhe indikatorë tjerë, parashikohet që nga trafikimi me narkotikë edhe në të ardhmen do të përballemi me pasoja më të mëdha në shëndetin e abuzuesve por edhe me pasoja në rendin publik. Pra, nga kjo del se do të ketë rritje të çrregullimeve mendore të lidhura me varësinë dhe substancat psikoaktive, do të shtohen incidentet e dhunshme dhe kriminaliteti në komunitet, institucionet e shëndetit publik do të përballen me mungesë të kapaciteteve për trajtim por edhe pasoja tjera.



CYBER CRIME

KRIMET KIBERNETIKE

Rritja e konsiderueshme e numrit të shfrytëzuesve të internetit por edhe digjitalizimi i shërbimeve gjithnjë e më shumë në vitet e fundit e ka sjellë me vete rrezikun e rritur të krimit dhe të sulmeve kibernetike.

Trendi i rritjes me shpejtësi dhe përmasa të mëdha të teknologjisë vazhdon të përparojë andaj shfrytëzuesit e teknologjisë po keqpërdorin duke shfrytëzuar njohuritë e fushës profesionale për të sulmuar individë, biznese, organizata qeveritare dhe joqeveritare, me qëllim për të përvetësuar para në formë të kundërligjshme dhe për t'iu shkaktuar dëme materiale.

Kosova është nën presion të vazhdueshëm nga këto kërcënime që synojnë infrastrukturën publike dhe financiare. Edhe pse niveli i kërcënimeve është i njëjtë në të gjithë rajonin, në aspektin e përgatitjes për mbrojtje nga këto kërcënime Kosova qëndron më mbrapa në krahasim me këto vende, sidomos kur bëhet fjalë për reagimin dhe parandalimin e sulmeve me mjetet strukturore dhe ligjore dhe disa veprimtari kriminale që kanë ndodhur janë të mjaftueshme për të theksuar dobësinë e rrjeteve kompjuterike që konsiderohen që janë në fazën e zhvillimit.




Pas analizave të ekspertëve të kësaj fushe nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) tregojnë se sulmet e sigurisë kibernetike në Kosovë janë të drejtuara ndaj sistemit shtetëror të rrjetit kompjuterik, llogarive të përdoruesve, sistemit financiar, faqeve të internetit dhe sektorit privat.

Institucionet e disa vendeve të Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën, kanë qenë po ashtu caqe nga sulmet kibernetike, ndërsa hakerët e lidhur me shërbimet ruse dhe me ato iraniane, janë fajësuar për disa prej sulmeve.

Pas shtrimit të nevojës që Kosova të ketë një kornizë ligjore për mbrojtjen më efikase dhe efektive nga sulmet

kibernetike e cila temë ka ngjallur edhe në raportin e Komisionit Evropian të vitit 2022, ku bazuar në këtë raport Kosova vlerësohet se ka zhvilluar kapacitetet bazë të sigurisë kibernetike, mirëpo i mungon një kornizë gjithëpërfshirëse ligjore me mekanizma operativë dhe kapacitete teknike dhe njerëzore për veprime efektive në këtë fushë.

Bazuar në këtë Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për sigurinë kibernetike të vitit 2023 i cili rregullon çështjet e parimeve të sigurisë kibernetike, parasheh institucionet relevante përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e politikave të sigurisë kibernetike të cilat janë:

-  Agjencia për Siguri Kibernetike (ACS) për zbatimin e masave të sigurisë kibernetike,
-  Ekipi kombëtar i reagimit ndaj emergjencave kompjuterike (CERT),
-  Këshilli Shtetëror për Sigurinë Kibernetike (SCCS), Qendra Shtetërore e Trajnimit për Siguri Kibernetike.

Sipas të dhënave në dispozicion, shënjestra kryesore e sulmeve kibernetike në Republikën e Kosovës ka qenë sistemi i rrjetit kompjuterik shtetëror, llogaritë e shfrytëzuesve, sistemi bankar, ueb faqet në internet dhe sektori privat.

Në fillim të vitit 2022, sulmet kibernetike sërish kishin në shënjestër sistemet kompjuterike të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës.

Këto sulme ishin një arsye shtesë për Këshillin Kombëtar të Sigurisë Kibernetike të Kosovës (NCSC) për të kryer një analizë gjithëpërfshirëse të gjendjes së sigurisë kibernetike dhe shkallës së rrezikut të institucioneve shtetërore, duke arritur në përfundimin se për shkak se ato operojnë në të njëjtën hapësirë kibernetike si pjesët e tjera të botës, pritet që ata të përballen me të njëjtat rreziqe.

Këshilli Kombëtar i Sigurisë Kibernetike të Kosovës pretendon se hakerët rusë nga grupi "KILLNET" po synojnë vazhdimisht institucionet shtetërore. Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës ka qenë në shënjestër të sulmeve kibernetike 'Phishing' edhe në prill të vitit 2022, por nuk kemi pasur sulme kibernetike që kanë komprometuar infrastrukturën dhe nuk kemi pësuar asnjë dëm nga ato sulme, megjithëse sulmet 'Phishing' janë të shpeshta.

Gjatë muajit prill 2023, faqet e internetit të tri institucioneve më të rëndësishme, përfshirë Presidencën, Kryeministrinë

dhe Prokurorinë e Kosovës, kanë qenë cak i një sulmi kibernetik. Lloji i sulmit kibernetik i përdorur ishte Mohimi i Shërbimit i Shpërndarë (DDoS). Si rezultat i këtij sulmi kibernetik, faqet e internetit të Kryeministrisë, Presidencës dhe Prokurorisë së Shtetit kanë qenë herë pas here jashtë funksionit gjatë sulmit. Përgjegjësini për këto sulme e ka marrë një grup online i quajtur "Anonymous Albania" me gjoja pretekstin e një demonstrimi kundër mungesës së respektimit të të drejtave të punëtorëve dhe reagimit joadekuat ndaj përdhunimit të vajzës 11 vjeçare në Kosovë, ndërsa ekspertët e fushës janë të bindur se këto sulme kanë ardhur nga adresa tjera.



Në vitet e fundit, krimi kibernetik është shfaqur në Kosovë edhe si kërcënim për institucionet me shpërthime bombash, siç ishin rastet me Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës disa herë gjatë muajve qershor 2022, shkurt 2023, prill 2023 etj., pastaj me Universitetin e Prishtinës gjatë muajit korrik 2022, gjimnazin "Xhevdet Doda" në Prishtinë gjatë muajit maj 2022, në diskoteka në Prishtinë me 28 nëntor 2023 etj. por fatmirësisht këto kërcënime kanë rezultuar të rrejshme.

FORMA TË IDENTIFIKUARA SI FENOMENE

Policia e Kosovës gjatë kësaj periudhe, si fenomene ka identifikuar disa forma që bien në fushën e krimit kibernetik dhe të veprave penale që mundësohen të kryhen përmes internetit dhe sistemeve kompjuterike.

“QENDRAT E THIRRJES”

Janë evidentuar raste mashtrimi të shtetasve të huaj (me theks të veçantë gjermanfolës) të cilat janë bërë përmes thirrjeve telefonike. Si mënyrë e kryerjes së veprës është gjetur se fillimisht keqbërësit kanë siguruar të dhëna personale të të dëmtuarve (emra dhe mbiemra, numra telefoni, e-mail adresa etj.) përmes rrugëve të ndryshme. Pastaj i kanë thirrur dhe kanë komunikuar me të dëmtuarit përmes telefonit, duke iu bërë ofertë dhe duke joshur për investime nga të cilat do të kenë përfitime materiale. Komunikimi është zhvilluar për një kohë derisa i dëmtuari është bindur “të investojë” në platformat mashtruese online që menaxhohen nga keqbërësit.

Pagesat ose “investimet” që janë bërë nga të dëmtuarit janë shuma të ndryshme të parave dhe për këto “investime” ata nuk kanë pranuar ose nuk kanë fituar asgjë, ashtu siç iu është premtuar nga keqbërësit. Gjatë komunikimit keqbërësit kanë përdorur emra apo pseudonime të ndryshme nga emrat e vërtetë.

Gjithashtu, janë identifikuar metoda të reja që janë përdorur nga keqbërësit: prezantimi si nëpunës i rremë policor; premtime fitimi; ndërmarrje për mbledhje borxhesh; mashtrim me kartela parapagese (prepaid); mashtrim me e-banking përmes internetit; mashtrime me rigjetjen e parave të humbura (recovery scam);

Në vijim janë të paraqitura më në detaje disa prej mënyrave më të shpeshta që përdoren nga “qendrat e thirrjes apo call centers”.

MARRJA E SHPËRBLIMEVE

Të dyshuarit fillimisht kanë siguruar të dhënat e personave kryesisht të shtetasve të huaj, pastaj kanë kontaktuar përmes e-maileve dhe telefonave duke u prezantuar se gjoja janë prej Lotarisë së Evropës (EuroLoto). Në këtë rast, viktimat kanë qenë kryesisht në moshë të shtyrë. Pasi kanë arritur t'i bindin se gjoja kanë fituar lotarinë, më pas i kanë shtyrë që përmes unioneve financiare të cilat operojnë në Kosovë si: Moneygram, Western Union, Capital-Ria, Vllesa-Ria etj., t'iu dërgojnë mjete (para) në vlera të ndryshme. Këto para janë dërguar tek personat të njohur si "money mule" (persona të profileve të ndryshme që paguhen me një përqindje të caktuar për secilin transaksion që pranojnë), pastaj të dhënat e këtyre personave u janë përcjellë të dëmtuarve për dërgimin e parave. Paratë janë dërguar për gjoja pagesat e taksave për marrjen e shpërblimit të lotarisë.

Gjithashtu, personat e njohur si "money mule" shkojnë edhe fizikisht tek shtëpitë dhe banesat e të dëmtuarve për marrjen e parave në mënyrë fizike, gjoja për fillimin e procedurave (pagesat e taksave) për marrjen e shpërblimit (fitimin e lotarisë).

Po ashtu, duke përdorur këtë lloj mashtrimi, të dyshuarit i kanë shtyrë të dëmtuarit për blerjen e kuponëve (kuponë të Amazon apo edhe kompanive tjera), pastaj të njëjtit i kanë kërkuar që t'ua përcjellin të dyshuarve numrat e po këtyre kuponëve, ku më pas këta numra të kuponëve i kanë përdorur për blerje online të sendeve të ndryshme, e këto sende përmes personave të cilët i kanë angazhuar i kanë sjellë në Kosovë.

Po ashtu, duke përdorur këtë lloj mashtrimi, të dyshuarit i kanë shtyrë të dëmtuarit për blerjen e kuponëve (kuponë të Amazon apo edhe kompanive tjera), pastaj të njëjtit i kanë kërkuar që t'ua përcjellin të dyshuarve numrat e po këtyre kuponëve, ku më pas këta numra të kuponëve i kanë përdorur për blerje online të

sendeve të ndryshme, e këto sende përmes personave të cilët i kanë angazhuar i kanë sjellë në Kosovë.

“MASHTRIMET PËR INVESTIME”

Kjo mënyrë e mashtrimit kryhet ku të dyshuarit fillimisht kanë siguruar të dhënat e personave kryesisht të shtetasve të huaj, pastaj duke i kontaktuar përmes telefonit iu prezantohen si kompani për investime me emra fiktivë të kompanive, viktimat janë joshur dhe janë shtyrë që të investojnë paratë e tyre përmes llogarive bankare në para digjitale, kinse në platforma online për kriptovaluta. Këto platforma online për kriptovaluta kanë qenë fiktive, të njëjtat i kanë hapur vetë të dyshuarit apo persona tjerë, e pastaj janë shfrytëzuar nga të dyshuarit. Investimi ka qenë me qëllim të investimit në kriptovaluta si Bitcoin dhe të tjera, me ç’rast do të fitojnë shuma të ndryshme të parave. Pas investimit të parave, të dëmtuarve iu është ndaluar qasja në këto platforma dhe nuk i është kthyer investimi. Të dëmtuarit në këto raste kanë qenë qytetarë të moshave të ndryshme.

MASHTRIMET LIDHUR ME KTHIMIN E PARAVE TË HUMBURA (RECOVERY SCAM)

Kjo mënyrë e mashtrimit është bërë pasi që fillimisht janë mashtruar personat të cilët kanë investuar në kompani për investime, këta persona janë paraqitur si kompani e cila do të ju kthejnë investimet e humbura. Pasi kanë filluar bisedimet, të dyshuarit i kanë shtyrë të dëmtuarit që fillimisht të dërgojnë kriptovaluta apo edhe fizike me qëllim që pastaj t’i kthehen mjetet e investuara. Personat të cilët janë kontaktuar kanë qenë të njohur për të dyshuarit apo persona tjerë, të cilët kanë pasur njohuri se këta persona (viktima) më herët kanë investuar në platformat online fiktive.

MASHTRIM ME E-BANKING (ONLINE BANKING) PËRMES INTERNETI

Kjo mënyrë e mashtrimit kryhet ku të dyshuarit fillimisht kanë siguruar të dhënat e personave kryesisht të shtetasve të huaj, pastaj i kontaktojnë dhe i paraqiten si ekspert sigurie të bankës (njësia kundër mashtrimeve) duke i deklaruar se gjoja dikush i ka hyrë në llogari bankare dhe ka tentuar të bëjnë transaksione, por këto transaksione janë ndaluar nga sistemi bankar. Pas kësaj, të dyshuarit i shpjegojnë se për ta bllokuar llogarinë dhe për t’i ndaluar transaksionet ju duhet të na i ofroni të dhënat bankare, të dëmtuarit ua ofrojnë të gjitha të dhënat e kërkuara nga të dyshuarit, duke përfshirë edhe kodet të cilat rritin limitet e transaksioneve.

Pasi t'i sigurojnë këto të dhëna, të dyshuarit kanë qasje të plotë në llogaritë e të dëmtuarve, si dhe qasje të plotë në rritjen e limitit ditor, pastaj transferojnë paratë nga këto llogari tek llogaritë e ndryshme bankare të personave tjerë. Pasi të kryhen transaksionet, të dyshuarit ia bllokojnë për një kohë llogarinë të dëmtuarve, me qëllim që të mos mund të kenë qasje për ndonjë raportim të menjëhershëm.

RASTET	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
Raste aktive – totali	63	62	58	43
Raste të reja të hapura	18	20	27	27
Raste të pranuar nga njësitë tjera	18	34	11	8
Raste të bartura	27	8	20	8
RASTET SIPAS				
Krimet kibernetike (rastet e reja)	36	54	38	35
Grupe kriminale të goditura	2	2	4	5

Gjatë kësaj periudhe ka pasur raste të ndërhyrjeve në sistemet kompjuterike ku janë vjedhur platforma online të videolojrave dhe llogari të kartelave personale të qytetarëve.

Edhe në aspektin humanitar ka pasur ndërhyrje nga hakerët, ku individë duke u kamufluar nëpërmjet shoqatave humanitare kanë arritur të ndërhyjnë në xhirollogari të personave fizikë dhe të realizojnë transaksione bankare, me qëllim të përfitimit personal.

Një metodë tjetër që kanë përdorur hakerët është edhe thyerja e llogarive personale të qytetarëve në rrjetin social Facebook.

Ka grupe kriminale të cilët kanë krijuar programe të ndryshme si skripte (virus) të cilët i shpërndajnë në rrjetet sociale

në Facebook dhe Instagram, ku marrin qasje në këto rrjete dhe kërkojnë para për rikthimin e llogarive personale në rrjetet sociale Facebook dhe Instagram.

Format e shfaqjes së krimit kibernetik në Kosovë

Është evidente se rastet që bien në fushën e krimeve kibernetike janë në rritje e gjithashtu edhe numri i rasteve që mundësohen të kryhen përmes kompjuterit apo internetit (kanosjet, mashtrimet, shantazhet, ngacmimet, keqpërdorimet e të dhënave personale, etj.) është në rritje.

Gjatë kësaj periudhe janë identifikuar forma të ndryshme të krimit kibernetik dhe veprave që mundësohen të kryhen përmes internetit dhe sistemeve kompjuterike, por që këto forma janë të njëjta me vitet e kaluara.

Në vijim me nga një elaborim të shkurtër janë të paraqitura këto forma:

» Blllokimi (kriptimi) i të dhënave kompjuterike përmes metodës RANSOMWARE, cak janë kryesisht bizneset duke mos anashkaluar individët por edhe institucionet e ndryshme;

» Kampanjat PHISHING – krijimi i ueb-faqeve të rrejshme dhe linçeve mashtruese me qëllim vjedhjen e të dhënave, “lojërat shpërblyese” kanë qenë karremi kryesor;

» Mashtrimi përmes falsifikimit të e-mail-ave – cak kryesor janë kompanitë e biznesit në Kosovë që bashkëpunojnë me kompanitë e biznesit në shtete të ndryshme. Keqbërësit përmes veprimeve të ndryshme arrijnë të kenë qasje në transaksionet financiare të bizneseve dhe në këtë mënyrë bëjnë modifikimin e faturave dhe ndryshimin e xhirologarive bankare;

» Materialet me përmbajtje të abuzimit seksual të fëmijëve - raste ku persona të dyshuar shkarkojnë, posedojnë, shikojnë dhe shpërndajnë përmes internetit materiale (video dhe foto) ku janë të përfshirë fëmijë duke u abuzuar seksualisht;

» Vjedhja e të dhënave personale bankare përmes mashtrimeve me e-mail por edhe thirrje telefonike, dërgimi i e-mail-ave mashtrues kinse viktimat janë fitues të ndonjë loje shpërblyese apo lotarie;

» Vjedhja e kriptovalutave, përdorimi i kriptovalutave për pastrim të parave;

» Blerjet online dhe blerja nëpër markete përmes pajisjeve POS me kartela të klonuara e gjësendeve të ndryshme, më pas shitja e këtyre gjësendeve tek personat e tjerë;

» Mashtrime në internet përmes ofrimit të shërbimeve të ndryshme, shitjeve të produkteve të ndryshme, donacioneve për bamirësi, etj.

Përveç këtyre formave të shfaqjes, në Kosovë ka shumë raste që mundësohen të kryhen përmes internetit, siç janë: kanosjet, ngacmimet, ngacmimet seksuale, shantazhet, etj.

Pastaj, përdorimi i internetit për qëllime të ndryshme qëllimkëqija siç janë: krijimi i llogarive duke keqpërdorur identitetin e tjetrit pa autorizim, postime me përmbajtje të ndryshme: gjuhë e urrejtjes, fyerje, promovim të ekstremizmit, shitje e medikamenteve, etj.

Vlen të theksohet se mund të shfaqen edhe forma tjera të krimit kibernetik, siç janë:

» Sulmet kibernetike të cilat janë trajtuar si forma të ndërhyrjes në sistemet kompjuterike në vendin tonë kanë qenë të ndryshme. Duke përdorur forma me dërgimin e viruseve të ndryshme dhe duke marrë kontrollin e serverëve të ndryshëm në kompani, agjenci dhe institucione shtetërore. Nga këto sulme përveç demit material, është edhe ekspozimi i të dhënave të qytetarëve të vendit tonë.

» Sulmet të natyrës DDoS, që për qëllim kanë paralizimin e infrastrukturës qoftë në nivel Shtetëror apo edhe të kompanive private të cilat kanë të ekspozuara shërbimet e tyre online.

» Komprometimi i të dhënave nga mos dija – vetëdijesimi i qytetarëve dhe ekspozimi i të dhënave në rrjete të ndryshme sociale, edhe kartela të ndryshme të lojalitetit pa pasur njohuri se ku do të përfundojnë të dhënat e tyre.

» Sulmet të ndryshme kibernetike në banka vendore dhe komprometimi i të dhënave si kredencialet ashtu edhe ato personale të qytetarëve. Në këto mund të përfshihen klonime të kartelave, sulme kibernetike përmes platformave të ndryshme dhe pranimi i SMS-ve në emër të bankave apo edhe kompanive tjera të vendit.



HUMAN TRAFFICKING

TRAFIKIMI ME QENIE NJERËZORE

Trafikimi me qenie njerëzore është një krim i rëndë dhe pavarësisht përpjekjeve të institucioneve për ta luftuar këtë dukuri kriminale, Kosova vazhdon të mbetet një vend i origjinës, i transitit dhe i destinacionit për viktimat e trafikimit.

Bazuar në statistika zyrtare të rasteve, trendi i trafikimit me qenie njerëzore në Kosovë, në katër vitet e fundit ka rënie të vazhdueshme, mirëpo shqetësuese vazhdon të mbetet trafikimi i viktimave të moshave të reja, moshë këto të brishta të cilat lehtë manipulohen nga personat e dyshuar apo grupet e ndryshme kriminale.

Identifikimin e femrave për trafikim, të dyshuarit zakonisht e bëjnë përmes përdorimit të rrjeteve sociale (Instagram, Facebook, TikTok). Këta trafikantë shfrytëzojnë gjendjen e dobët ekonomike ose problemet familjare të viktimave dhe viktimat zakonisht janë nga familje të brishta ose nga institucionet sociale.

Shkaqet kryesore që i paraprijnë prezencës së kësaj dukurie në Kosovë, janë të njëjta sikur edhe në të kaluarën e që janë: faktorët socio-ekonomikë, varfëria, papunësia, mungesa e edukimit, konfliktet dhe krizat familjare, abuzimi me narkotikë, korrupsioni etj.

Format kryesore të trafikimit me qenie njerëzore, në këtë periudhë kohore në Kosovë janë:

- ☑ Trafikimi për shfrytëzim seksual (posaçërisht vajza të mitura dhe gra),
- ☑ Trafikimi për kërkim lëmoshë,
- ☑ Trafikimi për punë të detyruar.

TRAFIKIMI PËR SHFRYTËZIM SEKSUAL

Është një nga format më të përhapura dhe më të rënda të trafikimit me qenie njerëzore në Kosovë dhe më gjerë. Ai ka karakteristika të veçanta që e dallojnë nga format e tjera të trafikimit dhe zhvillohet përmes metodave gjithnjë e më të sofistikuara.

Trafikimi zakonisht fillon me rekrutimin e vajzave dhe grave përmes mashtrimeve me premtime për punë, por edhe premtime për martesë.

Trafikimi i femrave me anë të mashtrimit për punë është një nga metodat, ku viktimat rekrutohen nga trafikanti me premtimin e rrejshëm për mundësi punësimi, brenda ose jashtë vendit, por përfundojnë në prostitucion të detyruar apo forma të tjera të shfrytëzimit seksual.

Trafikimi i femrave përmes mashtrimit për martesë është një nga metodat, ku femrat mashtrohen nga trafikanti me premtimin për martesë, por përfundojnë në kushte, kontroll, abuzim dhe shfrytëzim për ushtrim të prostitucionit. Te kjo kategori trafikanti fillimisht krijon marrëdhënie dashurie me viktimën.

Pasi viktimat i pranojnë kushtet e kërkuara, trafikanti e vendos viktimën në banesë të izoluar, motel apo shtëpi private, ua marrin dokumentet personale, i kushtëzojnë për të paguar borxhin sepse kanë bërë shpenzime, i drogojnë dhe me anë të frikësimit, dhunës fizike dhe psikologjike i detyrojnë të ushtrojnë prostitucion dhe punë tjera kundër vullnetit të tyre.

Një nga mënyrat e këtij trafikimi bëhet nëpër sallonet e masazheve, ku fillimisht viktimat rekrutohen për t'u punësuar si masazhere, por më pas ato përmes mënyrave të ndryshme të mashtrimit, joshjes dhe shantazhit, detyrohen të ofrojnë shërbime seksuale me pagesë për klientët e lokaleve të masazhit.

Mënyrë tjetër e trafikimit për prostitucion bëhet edhe në lokalet e natës me muzikë që gjenden në periferi të qyteteve ose në zona rurale. Në këto lokale vajza të reja punësohen si valltare, me qëllim të argëtimit të klientëve të këtyre lokaleve dhe gradualisht këto femra detyrohen të ushtrojnë prostitucion me klientët që i frekuentojnë këto bare.

Eskorta, trend i ri ndërkombëtar ku atakohet edhe Kosova, është ofrimi i shërbimeve seksuale përmes faqeve online të eskortave "Euro Girl Escort", në të cilin gjenden profile të femrave nga qytete të ndryshme të Kosovës dhe nga Amerika Latine dhe Ukraina.

Sipas informacioneve të cilat vijnë nga patrullimet në internet, rrjeti "Euro Girl Escort", përveç në Kosovë, është i pranishëm edhe në vendet e rajonit, si në: Shqipëri, Maqedoni, Kroaci dhe vende të tjera. Nga këto hulumtime që janë bërë në internet është identifikuar Webfaqja "www.Eurogirlsescort.com" përmes të cilës janë regjistruar disa agjencione me seli (sipas tyre) në Shqipëri, Kroaci etj.

Këto femra janë të moshave nga 18 vjeç e deri në 30 vjeç, vijnë në mënyrë të organizuar nga Brazili, Venezuela, Kolumbia, Peruja, Tajlanda etj., vendosen nëpër banesa private ku edhe fillojnë të krijojnë lidhjet përmes rrjeteve sociale me persona të ndryshëm, me qëllim të ofrimit të shërbimeve seksuale me pagesë dhe kontaktet i bëjnë në banesat ku jetojnë ose në hotele.

Lidhur me këtë, ka pasur veprime policore dhe është arrestuar një femër e dyshuar, shtetase e Perusë e cila dyshohet se ka qenë njëra nga organizatorët e këtij rrjeti të trafikantëve.

E njëjta i ka joshur femrat nga Amerika Latine për të ardhur në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni dhe Kroaci, duke iu premtuar punë si shoqëruese (eskortë) dhe me të arritur në Kosovë e dyshuara në fjalë, në bashkëpunim edhe me persona tjerë, pjesë e këtij rrjeti të krimit të organizuar, i kanë detyruar viktimat të kryejnë shërbime seksuale me klientë, duke ua marrë një përqindje të madhe të parave të fituara.

TRAFIKIMI PËR KËRKIM LËMOSHË

Në këtë lloj forme viktimat zakonisht janë fëmijë dhe gra që vijnë nga komunitetet romë, ashkalinj dhe egjiptianë, e që detyrohen të lypin në rrugë dhe në shumë raste viktimat nuk e kuptojnë që janë duke u trafikuar. Në këtë lloj trafikimi në shumë raste janë të përfshirë edhe anëtarë të familjes së viktimave ose rrjete të vogla lokale që përfitojnë financiarisht. Kërkim lëmosha, është duke u zhvilluar nëpër rrugët dhe sheshet kryesore të qyteteve, kafiteritë që gjenden afër këtyre rrugëve dhe shesheve.

Viktimat janë gra dhe fëmijë nga komuniteti rom, kryesisht shtetas të Shqipërisë, të cilët vijnë në Kosovë në mënyrë të organizuar nga trafikantët të cilët i shfrytëzojnë për kërkim lëmoshë. Trafikantët i përcjellin lëmoshë kërkuesit dhe kohë pas kohe ua marrin paratë që ua japin qytetarët. Kjo dukuri është shumë më e theksuar gjatë sezonit të verës dhe dimrit, kohë kjo kur shumë bashkatdhetarë nga bota perëndimore vijnë për pushime e të cilët njihen si më “dorë lirë” në dhënie të lëmoshës.

TRAFIKIMI PËR PUNË TË DETYRUAR

Është një fenomen jo i raportuar sa duhet në Kosovë. Në këtë lloj trafikimi viktimat shfrytëzohen për të punuar, shpesh në kushte të rënda, pa kontrata, pa pagesë dhe nën kërcënim.

Trafikimi për punë të detyruar në Kosovë, edhe pse nuk ka vëmendje të madhe si format tjera të trafikimit, është një problem serioz dhe në rritje. Kjo formë e shfrytëzimit rrallë shihet në mënyrë të qartë, por është e përhapur përmes punës së padeklaruar, varfërisë ekstreme dhe mashtrimeve me punësim.

Grupet kriminale ose individët i shfrytëzojnë këto rrethana të njerëzve në nevojë dhe pastaj me anë të premtimeve për paga të mira dhe

kushte të mira, zakonisht përmes rrjeteve sociale apo kontakteve personale, viktimës i ofrohet "ndihmë" për udhëtim, por më pas e detyrojnë të punojë për ta "shlyer" borxhin.

Viktimat janë burra dhe gra të papuna, që mashtrohen me premtime për punë në ndërtim, bujqësi, përkujdesje në shtëpi apo përkujdesje për të moshuar. Shfrytëzimi ndodh brenda dhe jashtë Kosovës (shpesh në vendet fqinje ose në BE).

Nëse e krahasojmë periudhën e fundit 2021-2024 kemi 36 raste më pak të trafikimit me qenie njerëzore sesa në periudhën e mëhershme 2017-2020.

Në vijim gjeni numrin e rasteve dhe llojin e veprës së trafikimit të qenieve njerëzore në dy periudha kohore.

Veprat e trafikimit	2017	2018	2019	2020	Totali	2021	2022	2023	2024	Totali
Shfrytëzim për prostitucion	18	10	18	7	53	19	17	6	4	46
Shfrytëzim për pornografi	0	1	1	0	2	0	0	0	0	0
Shfrytëzim për punë të detyrua	7	2	2	10	21	3	3	2	8	16
Shfrytëzim për lypësi/lëmoshë.	3	0	1	0	4	0	0	0	0	0
Shfrytëzim në skllavëri apo kushte të ngjashme	4	1	2	0	7	0	0	0	0	0
Martësë e detyruar	0	1	1	0	2	0	1	1	0	2
Shitje e fëmijës	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0
Totali	32	15	26	17	90	22	21	9	12	64

Sipas të dhënave në tabelën e lartcekur, në periudhën 2017–2020 kemi 90 raste me të gjitha format e trafikimit ku më shumë se gjysma e tyre (54 raste) janë trafikim për shfrytëzim prostitucioni e pasuar me veprën trafikim për punë të detyruar (21 raste).

Ndërsa sa i përket periudhës 2021-2024 kemi 64 raste me të gjitha format e trafikimit shumica e të cilave trafikim për shfrytëzim prostitucioni (46 raste) e pasuar me veprën shfrytëzim për punë të detyruar (16 raste).

Të dhënat zyrtare lidhur me origjinën e viktimave të trafikimit në Kosovë shihen në tabelën e poshtëshënuar.

Viktimat e identifikuar sipas origjinës	2021	2022	2023	2024
Kosovës	24	20	11	4
Shqipërisë	1	1	0	1
Serbisë	0	1	0	0
Panama	0	0	2	0
Kolumbi	0	0	0	6
Venezuela	0	0	0	1
Tajlanda	0	0	0	2
Totali	25	22	13	14

Tabela me viktimat e trafikimit sipas shteteve prej nga vijnë

Bazuar në statistika, shumica e viktimave janë me origjinë nga Kosova, kohëve të fundit disa viktimat janë nga disa shtete të Amerikës Latine, si dhe numër i vogël i viktimave nga Shqipëria, Tajlanda dhe Serbia.

Kur jemi te viktimat nën moshën 18 vjeçare, shqetësues është fakti se gjatë kësaj periudhe kemi 42 viktimat, prej të cilave 8 viktimat i përkasin grupmoshës 12-14 vjeçare.

Mosha	12 - 14 vjet		15 - 18		Totali
	F	M	F	M	
Gjinia					
Viti 2021	3	1	15	2	21
Viti 2022	3	0	11	0	14
Viti 2023	1	0	3	1	5
Viti 2024	0	0	2	0	2

Tabela me viktimat e trafikimit sipas grup moshës dhe sipas gjinisë

Sa i përket kategorisë së viktimave të trafikimit nën moshën 18 vjeçare, të dhënat janë se shumica dërmuese e tyre shfrytëzohen për shërbime seksuale me pagesë. Ndërsa një numër më i vogël i tyre shfrytëzohen për kërkim lëmshë dhe martesë të detyruara (kryesisht të theksuara te pjesëtarët e komunitetit rom).

Përpos faktorëve që u cekën më lart, viktimizimi i fëmijëve për trafikim bëhet edhe për shkak se rekrutohen më lehtë, mashtrohen, joshen, manipulohen etj. Ata nuk janë të aftë të kuptojnë sjelljet dhe veprimet e dëmshme ndaj vetes së tyre dhe ndikimin negativ që kanë veprimet e tilla ndaj shëndetit të tyre fizik dhe mendor.

Një faktor tjetër që i bën individët më të cenueshëm ndaj këtij fenomeni është niveli i ulët i arsimit, prandaj shumica e viktimave të trafikimit vijnë nga shtresa të marginalizuara të shoqërisë, ku niveli i arsimit dhe emancipimit janë të ulta. Mungesa e njohurive, informacionit dhe aftësive të nevojshme për të përballuar sfidat e jetës i bën këta individë më të prekshëm ndaj premtimeve të rreme për punësim, shkollim apo një jetë më të mirë.

Statistikat zyrtare lidhur me shfrytëzimet seksuale të të miturve nuk e paraqesin gjendjen reale në këtë fushë, pasi që dyshohet se ka raste që nuk raportohen në organe të sigurisë, as nga vetë fëmijët e abuzuar, por as nga shokët e tyre dhe shpesh prindërit e tyre nuk janë të gatshëm të raportojnë, duke u frikësuar se pas raportimit, fëmija dhe familja e tij do të bëhen objekt i fjalëve të komunitetit dhe mediave. Prandaj, shumë viktima mbeten të pidentifikuara dhe abuzuesit e tyre të pazbuluar për shkak të vështirësisë në identifikim.

Fëmijët, të cilët në një moshë të re kanë qenë viktima të shfrytëzimit seksual, nëse nuk trajtohen me kohë nga ky dëm psikologjik dhe fizik në institucionet përkatëse, mund të përjetojnë probleme serioze në shëndetin mendor dhe në zhvillimin normal të jetës së tyre.

Të dhënat e paraqitura më poshtë tregojnë se asnjë viktima e trafikimit gjatë viteve 2021–2024 nuk ka qenë me nivel të lartë të arsimit, gjë që e konfirmon drejtpërdrejt lidhjen midis mungesës së arsimit dhe rrezikut për t'u trafikuar. Por numri më i lartë i viktimave janë pa shkollim, me arsim fillor dhe të mesëm, prandaj kjo nuk e ndryshon faktin se vetëm arsimimi i pamjaftueshëm mbetet faktori kryesor i trafikimit.

Niveli i arsimit të viktimave	2021	2022	2023	2024
I lartë	0	0	0	0
I mesëm	0	8	7	10
Fillor	17	11	2	3
I/E pashkolluar	8	3	13	14

Tabela me paraqitjen e nivelit të arsimit të viktimave të trafikimit

Grupet e trafikimit me njerëz në Kosovë nuk janë grupe tipike sikurse që paraqiten tek format tjera të krimit të organizuar, por janë kryesisht grupe të vogla me organizim të lirë në përbërje nga dy, tre, e më së shumti deri në 6 anëtarë, të bazuara kryesisht në lidhje shoqërore ose familjare në mes të anëtarëve të grupit.

Por prapëseprapë këto grupe veprojnë përmes një strukture deri diku të organizuar, ku përfshihen rekrutues, transportues, kontrollues dhe përfitues të drejtpërdrejtë nga viktimat. Bashkëpunojnë me grupet e rajonit dhe deri në vendet e BE-së, përdorin rrjetet sociale dhe aplikacionet për të joshur viktimat (me punësime të rreme, martesë, udhëtime), përdorin dhunë fizike dhe psikologjike, justifikime për borxhe, izolim, marrje të dokumenteve, shantazh seksual.

Trafikantët e qenieve njerëzore zakonisht përdorin mënyra të mirë organizuara dhe të fshehta për të zhvilluar aktivitetin e tyre kriminal, duke u përpjekur të shmangin kontrollin dhe ndjekjen nga organet e drejtësisë. Një nga praktikat më të zakonshme është shfrytëzimi i bizneseve të ligjshme për të fshehur qëllimet e vërteta të veprimtarisë së tyre. Ata hapin apo marrin në pronësi biznese, si: klube nate, qendra masazhi, agjenci punësimi etj. të cilat nga jashtë duken të rregullta, por në përgjithësi përdoren për qëllime të paligjshme si shfrytëzimi seksual apo puna e detyruar

Disa nga këto grupe bashkëpunojnë edhe me grupet nga rajoni sidomos me ato të Shqipërisë, ku në vitin 2024 është identifikuar një grup me shtrirje më të gjerë ndërkombëtare (Kosovë - Shqipëri - Peru).

Në këtë periudhë Policia e Kosovës ka goditur 9 grupe të vogla të trafikimit dhe ka arrestuar 32 pjesëtarë të grupeve kriminale të trafikimit me qenie njerëzore.

Shumica e këtyre grupeve kriminale viktimat i kanë shfrytëzuar për ofrim të shërbimeve seksuale me pagesë, martesë të detyruara, kërkim lëmshë etj.

Policia e Kosovës gjatë kësaj periudhe ka bashkëpunim të mirë me partnerët e sigurisë dhe organizatat ndërkombëtare dhe rajonale që luftojnë trafikimin me qenie njerëzore, si në shkëmbimin dhe verifikimin e informatave, ashtu edhe në realizimin e operacioneve dhe arritjen e sukseseve të përbashkëta policore në kuadër të planifikimeve dhe aktiviteteve të platformës "EMPACT, JAD SEE" ditët e veprimit të përbashkëta.

Trafikimi me qenie njerëzore mbetet një sfidë serioze dhe shumëdimensionale në Kosovë, i ndikuar nga faktorë të brendshëm dhe rajonalë si: papunësia, varfëria, korrupsioni, mungesa e mekanizmave mbrojtës dhe shfrytëzimi i teknologjisë nga rrjetet kriminale. Edhe pse Kosova ka ndërmarrë hapa për të luftuar këtë fenomen, parashikimet për të ardhmen kërkojnë qasje më gjithëpërfshirëse dhe proaktive.

Në të ardhmen mund të përballemi me perfeksionim të formave të trafikimit, sidomos në internet dhe rrjetet sociale, si: martesë të rrejshme, rekrutime online, me rritje të trafikimit të brendshëm, veçanërisht të fëmijëve dhe grave për kërkim lëmshë, prostitucion ose punë të detyruar, vështirësi në identifikimin e viktimave për shkak të paragjyqimeve dhe frikës nga raportimi dhe përfshirje të të rinjve në rrjete kriminale, sidomos të papunëve dhe atyre me mungesë arsimimi.

Nëse kapacitetet fokusohen më tepër në parandalim, ndëshkim dhe mbrojtje, ekziston potencial real për uljen graduale të rasteve të trafikimit. Por në mungesë të veprimeve sistematike dhe mbështetjeve të qëndrueshme, në të ardhmen trafikimi rrezikon të bëhet më i padukshëm, më digjital dhe më i vështirë për t'u luftuar. Mundësitë për arritje të rezultateve më të mira janë me angazhim më të madh në rritjen e ndërgjegjësimit publik përmes fushatave ndërgjegjësuëse, veçanërisht tek të rinjtë dhe gratë, zhvillimin e kapaciteteve të Policisë së Kosovës dhe institucioneve gjyqësore për identifikim dhe hetim të rasteve të trafikimit, zbatim më të mirë të ligjeve në ndjekjen penale të trafikantëve, trajtim më human të viktimave dhe forcim të bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar.

KEQPËRDORIMI I FËMIJËVE NË PORNOGRAFI

Keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi është një krim i padukshëm por i përhapur, që kërkon përpjekje të koordinuar nga shteti, shoqëria civile dhe teknologjia dhe se mbrojtja e fëmijëve duhet të jetë detyrë e të gjithëve dhe prioritet absolut, sepse ata janë e ardhmja jonë.

Keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi është një krim i rëndë, me pasoja psikologjike për jetën e tyre dhe shfaqen me depresion, ankth, ndjenjë turpi, stigmatizimin nga shoqëria që është edhe viktimizimi i dyfishtë i tyre, por ata mund të jenë viktimat të përhershme pasi që materialet mund të qarkullojnë në internet për vite.

Shkalla dhe format e keqpërdorimit të fëmijëve në pornografi sipas raporteve ndërkombëtare kanë një rritje shqetësuese nga viti në vit, veçanërisht (përmes dark web, platformash të fshehura, etj.), si dhe formave më të reja (live streaming, sekspluatim nëpërmjet rrjeteve sociale.

Në lidhje me keqpërdorimin e fëmijëve për pornografi në Kosovë, nuk ka të dhëna që identifikojnë grupe të strukturuar dhe funksionale dhe se rastet e tilla zakonisht janë veprime individuale të dyshuarve.

Edhe në Kosovë, sipas të dhënave nga Policia, kemi rritje të ndjeshme nga viti në vit të rasteve nga kjo vepër.

Po ashtu ka edhe rritje të raportimeve, sidomos pas pandemisë COVID-19, kur fëmijët kaluan më shumë kohë online, u rritën rastet e shfrytëzimit përmes internetit (grooming, sextortion - shpërndarja e imazheve intime), dhe po ashtu kemi më shumë raste të identifikuar nga hetimet kibernetike.

Nëse i krahasojmë rastet e keqpërdorimit për pornografi të fëmijëve vërejmë se në periudhën e trajtuar në këtë dokument 2021-2024 (45 raste) kemi rritje të ndjeshme të rasteve krahasuar me periudhën e njëjtë kohore 2017-2020 (8 raste).

Shfrytëzimi i fëmijëve në pornografi	2017	2018	2019	2020	Totali
Rastet	0	0	2	6	8
Shfrytëzimi i fëmijëve në pornografi	2021	2022	2023	2024	Totali
Rastet	8	14	21	2	45

Edhe pse statistikat zyrtare lidhur me shfrytëzimin e fëmijëve në pornografi tregojnë për rritje të vazhdueshme të rasteve, ato prapëseprapë nuk e paraqesin gjendjen reale, për faktin se krimi seksual është një fenomen më i përhapur sesa raportohet.

Parashikimet për të ardhmen janë se do të ketë rritje të rasteve të raportuara por edhe përkundër kësaj numri i këtyre rasteve do të mbetet i ulët për shkak të mosraportimit në tërësi.



KONTRABANDIMI ME MIGRANT

Kontrabandimi me migrantë në Kosovë është një fenomen kriminal që lidhet drejtpërdrejt me pozicionin gjeografik të vendit si korridor tranzit midis Lindjes së Mesme/ Afrikës dhe vendeve të Bashkimit Evropian. Ky aktivitet kryhet nga individë të izoluar dhe rrjete kriminale të organizuara, shpesh në bashkëpunim ndërkufitar. Motivet janë kryesisht përfitimi financiar, ndërsa metodat përfshijnë transport të fshehtë, përdorim të dokumenteve të falsifikuara dhe kalime ilegale përmes kufijve tokësorë.

Faktorët kryesorë që ndikojnë që ky krim të jetë i leverdishëm për grupet kriminale janë për faktin se Kosova ndodhet në një nga rrugët kryesore të migracionit të paligjshëm në Ballkan, duke lidhur Turqinë, Greqinë, Maqedoninë e Veriut dhe vendet e BE-së, pastaj ka kërkesa të larta për kalim të migrantëve nga Siria, Afganistani, Iraku, Maroku dhe vende të tjera, të cilët paguajnë shuma të konsiderueshme të parave për të kaluar në mënyrë të paligjshme,

dobësitë në kontrollin kufitar për shkak të zonave malore kufitare dhe rrugëve alternative që përdoren për shmangien e kontrolleve zyrtare.

Migrantët në përcjellje të kontrabandistëve nga vendi fillestar e deri në cakun përfundimtar e përshkojnë këtë rrugëtim: Turqi → Greqi → Shqipëri/Maqedoni e Veriut → Kosovë → Mal i Zi / Serbi → BE.

Kontrabandimi i migrantëve, hyjnë në Kosovë nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut kryesisht përmes shtigjeve malore duke kaluar ilegalisht kufirin dhe pas hyrjes në Kosovë, në mënyrë të organizuar, transportohen nga kontrabandistët deri afër Qendrës së Azilit në Magure ose në Qendrën e pritjes në Vranidoll si dhe në Drejtorinë për Migrim dhe të Huaj.

Migrantët të cilët hyjnë në Kosovë ose kërkojnë azil dhe pajisen me vërtetim për akomodim/strehim në Qendrën e pritjes në Vranidoll, ose e shfrytëzojnë Kosovën si vend transit për të kaluar në shtetet e BE-së.

Migrantët që hyjnë në Kosovë janë kryesisht nga vendet e Lindjes së Mesme, siç janë, Siria, Iraku, Maroku, Afganistani, Pakistani, Palestina, Jemeni, Bangladeshi, Egjipti, Algjeria, Libia, Turqia, si dhe nga disa vende tjera.

Për të përfituar nga ky migrim i madh i njerëzve nga shtetet e lartpërmendura janë organizuar grupe kriminale të kontrabandimit nga Kosova dhe rajoni të cilat merren me kontrabandimin e migrantëve deri në vendet e destinacionit që janë vendet e BE-së.

Grupet kriminale të një vendi në të shumtën e rasteve nuk mund t'ju ofrojnë shërbime të plota migrantëve nëpër vendet tjera, prandaj bashkëpunojnë edhe me grupet e vendeve nëpër të cilat kalojnë migrantët.

Sipas informacioneve, shumica e parave që përfitojnë kontrabandistët nga

migrantët është 200 deri 300 euro për kalimin e një shteti, ndërsa rreth 1.800 deri 4.000 euro deri në shtetin evropian ku është destinacioni i tyre.

Një formë tjetër e kontrabandimit me migrantët e huaj, është edhe përmes pajisjes me viza apo leje qëndrimi të përkohshëm të Kosovës, kinse për arsye biznesi apo aktivitete tjera sportive.

Po ashtu kemi kontrabandim të migrantëve edhe përmes vizave të punës në Kosovë, ku disa biznese sjellin në Kosovë kinse punëtorë nga Bangladeshi, të cilët qëndrojnë për një kohë të shkurtë në Kosovë, dhe më pas ikin për në shtetet perëndimore.

Në luftën kundër kontrabandimit të migrantëve Kosova ka bërë përpjekje të vazhdueshme dhe ka arritur rezultate si në ndëshkimin e keqbërësve ashtu edhe në trajtimin dhe strehimin e migrantëve.

Viti	2021	2022	2023	2024	Totali	
					2017-2020	2021-2024
Numri i rasteve	27	37	11	11	91	86
Persona të arrestuar	54	61	16	13	101	144
Kallëzime penale	27	37	11	11	95	86

Në periudhën 2021-2024 kemi raste më pak (86 raste) krahasuar me periudhën e mëhershme 2017-2020 (91 raste).


Në periudhën 2021-2024 për kontrabandim të migrantëve kemi më shumë persona të dyshuar të arrestuar (144) krahasuar me periudhën e mëhershme 2017-2020 ku kemi më pak (101) persona të arrestuar.

Në periudhën 2021-2024 kemi më pak kallëzime penale (86) krahasuar me periudhën e mëhershme kur kishim më shumë 2017-2020 (95) kallëzime penale.

Viti	2021	2022	2023	2024	Totali	
					2017-2020	2021-2024
Migrant të parregullt	1422	939	634	1027	5408	4022
Azilkërkues	578	547	179	190	4207	1494

Bazuar në statistika zyrtare, të cilat i gjeni në tabelën më lart, kuptojmë se në periudhën e fundit 2021-2024 kemi më pak migrantë të parregullt dhe po ashtu më pak azilkërkues sesa në periudhën e mëhershme 2017-2020.

Parashikimet për të ardhmen, për rënie të ndjeshme të numrit të migrantëve dhe rënie të kontrabandimit nuk janë edhe aq premtuese. Kjo për faktin se në vendet prej nga vijnë migrantët, ka kriza dhe konflikte të vazhdueshme, por edhe periudha e paskonflikteve konsiderohet periudhë e vështirë për jetesë dhe siguri, si dhe fakti tjetër se në këto vende ka pasur shkatërrime të mëdha nga luftërat dhe kushtet për jetesë do të jenë të vështira për një periudhë të gjatë.



KORRUPSIONI

Luftimi efektiv i korrupsionit është thelbësor për ruajtjen e sundimit të ligjit. Prezenca e korrupsionit dhe shtrirja e gjerë e tij në institucionet publike është duke e dëmtuar zhvillimin ekonomik dhe zhvillimin demokratik.

Po ashtu niveli i korrupsionit përfshin çdo fushë të jetës publike, përfshirë administratën shtetërore, sektorin privat, shëndetësinë, arsimin, prokurimin publik dhe sistemin e drejtësisë.

Korrupsioni ka pasoja të shumta negative për vendin tonë si në aspektin ekonomik ashtu edhe në atë shoqëror e politik.

Korrupsioni dëmtton besimin e qytetarëve në institucionet publike, ka zhvillim ekonomik të ngadalësuar, ndikon në rritjen e varfërisë dhe pabarazisë, po ashtu pengon reformën dhe zhvillimin demokratik (pasi që një sistem i korruptuar krijon hapësirë për krimin dhe dukuritë e paligjshme të lulëzojnë).

Në vitin 2024 Komisioni Evropian ka përgatitur raportin për Kosovën ku thotë që Kosova është ndërmjet një faze të hershme dhe njëfarë niveli të përgatitjes

në luftën kundër korrupsionit dhe në përgjithësi ka bërë progres të kufizuar. Edhe më tepër institucione kanë miratuar plane integriteti. Kuvendi ka miratuar Ligjin për Prokurorinë Speciale (PSRK), me qëllim të forcimit të trajtimit nga drejtësia penale të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë. Ka pasur disa përparime në gjykimin e rasteve të korrupsionit, gjë që ka rezultuar në një numër më të madh vendimesh dhe dënimesh të formës së prerë nga gjykatat. Megjithatë, rezultatet ndikohen nga pamjaftueshmëria e burimeve e kapaciteteve dhe nga mungesa e paanshmërisë e llogaridhënies në shërbimin prokurorial dhe gjyqësor. Angazhimi më i fortë për të arritur rezultate solide në luftën kundër korrupsionit të nivelit të lartë mbetet i domosdoshëm, përfshirë forcimin e përdorimit të instrumenteve kundër korrupsionit, si deklarimi i pasurisë dhe planet e integritetit të institucioneve publike.

KORNIZA INSTITUCIONALE

Korniza institucionale për luftën kundër korrupsionit ekziston dhe është pjesërisht e kënaqshme. Zbatimi dhe monitorimi i kornizës duhet të përmirësohet tutje. APK ka zbatuar një projekt të rëndësishëm për të identifikuar fushat më të cenueshme ndaj korrupsionit. Është thelbësore të forcohet buxheti, personeli dhe kapacitetet e ekspertiza e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit - APK-së, për të reflektuar rritjen e numrit të subjekteve që janë të obliguar të deklarojnë pasurinë. Institucionet e specializuara të Kosovës për luftimin e korrupsionit janë funksionale. Njësia e Veçantë Hetimore e Policisë së Kosovës më herët ka funksionuar pa mandat të qartë ligjor. Ligji i ri për Prokurorinë Speciale (PSRK) e plotëson këtë mangësi. Megjithatë, nevojitet një akt nënligjor për të përcaktuar aspektet organizative dhe bashkëpunim me PSRK-në. Si PSRK ashtu edhe Njësia e Veçantë Hetimore duhet të sigurojnë bashkëpunim efektiv dhe të mbajnë kapacitete të mjaftueshme hetimore për të përmbushur funksionet e tyre në mënyrë efektive.

DOKUMENTET STRATEGJIKE

Korniza e nevojshme strategjike nuk ekziston. Strategjia kombëtare dhe plani i veprimit kundër korrupsionit për periudhën 2024-2027 janë në pritje. Është thelbësore që ato të përmbushin praktikat dhe standardet më të mira të BE-së. Këshilli Prokurorial i Kosovës - KPK, Këshilli Gjyqësor i Kosovës - KGJK dhe Prokuroria Speciale duhet të vazhdojnë të kenë prioritet trajtimin e rasteve të korrupsionit dhe krimin të organizuar në planet e tyre vjetore.

KORNIZA LIGJORE

Korniza ligjore për luftën kundër korrupsionit ekziston dhe është e kënaqshme, megjithatë duhet të përmirësohet zbatimi i saj. Kosova nuk është palë e konventave ndërkombëtare kundër korrupsionit. Megjithatë, legjislacioni i Kosovës në përgjithësi është i harmonizuar me këto instrumente dhe në përputhje me standardet relevante evropiane. Kodi Penal penalizon në mënyrë të përshtatshme veprat e lidhura me korrupsionin.

Nga analiza e rasteve të raportuara gjatë periudhës 2021-2024 rezulton se format më të shpeshta të korrupsionit në Kosovë janë:

- keqpërdorimi i pozitës zyrtare,
- marrja dhe dhënia e ryshfetit,
- kontrabanda
- falsifikimi i dokumenteve
- nepotizmi


Edhe për këtë periudhë kohore 2021-2024, bazuar në analizat, hetimet, vlerësimet vendore dhe ndërkombëtare, sondazheve të ndryshme, më së shumti korrupsioni është i paraqitur në institucionet publike, si: administrata publike, prokurimi publik, sistemi i drejtësisë, shëndetësia, arsimit, institucione lokale dhe agjencitë dhe autoritetet rregulluese. Rastet më të shpeshta të paraqitjes së korrupsionit në Kosovë janë në:

- keqpërdorimin e pozitës publike,
- marrja dhe dhënia e ryshfetit,
- keqpërdorimin e fondeve publike
- manipulimin e tenderëve publik
- të drejtat e pronës dhe shpërblime të pabarabarta
- arsimim dhe shëndetësi
- prokurim dhe Kontrata të paligjshme
- të dhënat e pasurisë dhe mungesa e deklarimit të pasurisë

Të drejtat e punëtorëve dhe punësimi pa kritere.

Në përgjithësi, këto forma të korrupsionit kanë ndikim të madh në zhvillimin e Kosovës dhe e pengojnë përparimin e vendit në shumë fusha. Lufta kundër korrupsionit kërkon përpjekje të vazhdueshme nga institucionet ligjzbatuese, qytetarët dhe shoqëria civile, për të adresuar këto probleme dhe për të krijuar një ambient të sigurt. Në një konstatim lidhur me përparimin e lehtë të Kosovës në fushën kundër korrupsionit gjatë vitit 2024 nga ana e Transparency International⁶ thuhet se Kosova ka shënuar përparim të lehtë në luftën kundër korrupsionit, duke u vlerësuar me 44 pikë (3 më shumë se vitet 2023 dhe 2022 dhe 5 më shumë sesa në vitin 2021) në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit. Në këtë raport thuhet se Kosova në mesin e shteteve të Ballkanit Perëndimor, është renditur e dyta pas Malit të Zi dhe ka lënë pas Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, Serbinë dhe Bosnjë e Hercegovinën.

Duke iu referuar raporteve të Transparency International mbi shtetet e Evropës Lindore, sipas këtij vlerësimi të gjitha këto vende karakterizohen me një mesatare rajonale që mbetet një nga më të ulëtat në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit (CPI). Karakteristikat e përbashkëta të korrupsionit në këto vende janë institucionet e dobëta demokratike dhe sundimi i ligjit që përkeqësohen nga paqëndrueshmëria e vazhdueshme dhe presionet e jashtme. Kjo lejon që korrupsioni të lulëzojë, ndërkohë që dëmton besimin publik, zhvillimin e qëndrueshëm dhe veprimet parandaluese në vazhdim⁷.



⁶ Vlerësimi i organizatës ndërkombëtare "Transparency International": <https://www.transparency.org/en/cpi/2024/index/ksv>

⁷ <https://www.transparency.org/en/news/cpi-2024-eastern-europe-central-asia--vicious-cycle-weak-democracy-flourishing-corruption>

Policia e Kosovës ka trajtuar dhe ka proceduar në prokurorinë kompetente këto raste të korrupsionit siç pasqyrohen në tabelë:

Statistikat për veprat penale të Korrupsionit	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Raste të hapura	170	87	162	175	167	126
Kallëzime penale me kryes të njohur	148	65	209	161	154	122
Numri i personave të arrestuar	70	29	162	36	72	66
Numri i personave të përfshirë në kallëzime penale	350	173	570	356	416	311

Statistikat për veprat penale të korrupsionit gjatë 4 viteve të fundit nga PK

Nga analizimi i statistikave të rezultateve të PK-së me ato të periudhës paraprahe, kemi një trend në rritje në dy vitet e para (2021, 2022) ndërsa tani dy vitet e fundit kemi rënie tek rastet e hapura, tek kallëzime penale, po ashtu edhe rënie të numrit të personave të arrestuar.

Reformat institucionale të Kosovës në fushën e parandalimit të korrupsionit janë vlerësuar ndërkombëtarisht gjatë një punëtorie të nivelit të lartë të organizuar nga Këshilli i Evropës në Strasburgs, ku Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) prezantoi qasjen dhe përvojën e saj në hartëzimin e rreziqeve të korrupsionit.

“Korrupsioni nuk është vetëm çështje ligjore – është sfidë e kulturës institucionale. Ndryshimi fillon me diagnostikim të saktë dhe vullnet për të vepruar aty ku rreziku është real”.

Ekziston rëndësia e vullnetit politik në të gjitha nivelet, formalizimit të përgjegjësive, përfshirjes së hershme të institucioneve të targetuara dhe ruajtjes së komunikimit të vazhdueshëm gjatë procesit të vlerësimit. Gjithashtu shqetësime për sfidat aktuale si mungesa e një baze të dhënash të konsoliduar që i bëjnë vlerësimet kundër korrupsionit më të vështira, rëndësinë që teknologjia – përmes analizës së të dhënave, inteligjencës artificiale dhe mjeteve digjitale – në të ardhmen të vihet në shërbim të detektimit dhe parandalimit të korrupsionit në mënyrë më efektive.

Pjesëmarrja e Kosovës në këtë format jo vetëm që e rikonfirmon angazhimin e saj për reforma të thella në fushën e integritetit dhe sundimit të ligjit, por gjithashtu e paraqet vendin si një shembull pozitiv në nivel evropian dhe më gjerë.



SHPËLARJA E PARASË

Shpëlarja e parasë paraqet procesin përmes të cilit të ardhurat e fituara nga veprimtaritë kriminale maskohen për të krijuar përshtypjen se ato janë fituar në mënyrë të ligjshme. Ky është një fenomen serioz në Kosovë dhe paraqet sfidë për sistemin financiar, sundimin e ligjit dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Shpëlarja e parasë është një proces përmes të cilit të ardhurat e përfituara nga veprimtari të paligjshme transformohen në para apo pasuri që duken sikur kanë burim të ligjshëm. Ky fenomen përbën një sfidë serioze për ekonominë dhe sistemin ligjor të çdo shteti. Edhe në Kosovë, ashtu si në shumë vende të tjera të botës, shpëlarja e parave është një problem i pranishëm dhe i ndërlikuar ngushtë me aktivitete të ndryshme kriminale. Në shumicën e rasteve, paratë e shpëlarura vijnë nga burime të jashtëligjshme si: trafikimi me

drogë, kontrabanda me mallra dhe armë, prostitucioni etj. Qëllimi i grupeve

kriminale është që këto para t'i fusin në qarkullimin formal ekonomik, në mënyrë që të mos dallohen nga të ardhurat e ligjshme. Kjo bëhet nëpërmjet investimeve në biznese, blerjes së pasurive të paluajtshme apo përdorimit të institucioneve financiare, për të fshehur origjinën e vërtetë të parave.

Efektet e shpëlarjes së parave janë të shumta dhe të dëmshme. Ajo dëmton konkurrencën e ndershme në treg, minon besimin në institucionet publike dhe financon veprimtari të mëtejshme kriminale.

Shpëlarja e parave në Kosovë ndodh përmes disa metodave të zakonshme të cilat përdoren për të fshehur burimin e paligjshëm të fondeve dhe për t'i futur ato në ekonominë formale.

Disa nga metodat më të përdorura përfshijnë:

- bizneset e rreme hapja apo vazhdimi i bizneseve aktuale (vetura, hoteleri) dhe transaksionet fiktive,
- investime në sektorin e ndërtimit dhe pasurive të paluajtshme.
- kazinotë dhe lojërat e fatit,
- përdorimi i bankave dhe institucioneve financiare,
- korrupsioni dhe keqpërdorimi i fondeve publike,
- kriptovalutat dhe transaksionet digjitale,
- shpenzime jetësore të luksit etj.

Në vijim i paraqesim, statistikat e rasteve të pastrimit të parave të cilat janë hetuar nga Policia e Kosovës.

Statistikat për rastet e Pastrimit te parave	2021	2022	2023	2024
Raste të hapura	5	8	6	2
Kallëzime penale me kryes të njohur	5	1	6	1
Numri i personave të arrestuar	11	7	2	3
Numri i personave të përfshirë në kallëzime penale	21	7	22	4

Statistikat për veprën penale të shpëlarjes së parasë gjatë 4 viteve të fundit

Në bazë të raportit të fundit të publikuar gjatë vitit 2020 mbi Tipologjitë e pastrimit të parave në Kosovë, i mbështetur nga Swiss Cooperation Office Kosovo dhe UNDP⁹, i bazuar në të dhënat e Institucioneve të Republikës së Kosovës, i hartuar sipas qasjes së bazuar në risk, kanë identifikuar gjithsejtë pesë (5) nivele të cënueshmërisë ndaj të cilave është e ekspozuar Republika e Kosovës.

Këto shkallë të rrezikut janë:

- cënueshmëri shumë e lartë,
- cënueshmëri e lartë,
- cënueshmëri mesatare,
- cënueshmëri e ulët,
- cënueshmëri shumë e ulët.

⁹ <https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/ks/GeneralTypologies-Alb.pdf>

Modeli i përcaktimit të shkallës së rrezikut përfshin veprat penale bazë, në përputhje me të cilat ishin të lidhura aktivitetet e pastrimit të parave, sipas së cilit model, sa më e lartë është sasia e aktiviteteve të shpëlarjes së parasë të lidhura me një vepër penale të veçantë bazë, aq më e lartë është cenueshmëria e Kosovës nga kjo vepër.

Sipas kësaj metodologjie, është arritur që të bëhet edhe klasifikimi i veprave penale bazë, ndaj të cilave Kosova është e ekspozuar, e shkallëzuar sipas nivelit të cenueshmërisë:

- niveli i kërcënimit jashtëzakonisht i lartë – përfshihen veprat penale bazë, siç janë evazioni tatimor, kontrabanda, korrupsioni dhe ryshfeti;
- niveli i kërcënimit i lartë – përfshihen veprat penale bazë siç janë: trafikimi me lëndë narkotike, falsifikimi i mallrave dhe piratëria, trafikimi i qenieve njerëzore, duke përfshirë edhe kontrabandën me migrant dhe prostitucioni.
- niveli i kërcënimit mesatar - përfshihen veprat penale bazë siç janë: nashtrimi, zhvatja dhe fajdet, grabitjet dhe vjedhjet.
- niveli i kërcënimit i ulët - përfshihen veprat penale bazë siç janë: krimet mjedisore dhe trafiku i paligjshëm i armëve.

Niveli i kërcënimit shumë i ulët - përfshihen veprat penale bazë siç janë: falsifikimi, falsifikimi i parasë dhe trafikimi i paligjshëm i mallrave të vjedhura.

Përveç identifikimi të niveli të kërcënimit nga vepra penale bazë, raporti ka identifikuar edhe nivelet e kërcënimit dhe cenueshmërisë me të cilat përballen subjektet raportuese, të cilat përdoren si instrumente përmes së cilave fshihen dhe futen në sistem fitimet nga krimi.

Më poshtë janë të pasqyruara nivelet e kërcënimit sipas subjekteve raportuese:

- ✓ Niveli i kërcënimit jashtëzakonisht i lartë – ku përfshihen
 - ✓ bankat;
 - ✓ patundshmëritë dhe
 - ✓ sektori i ndërtimit
- Niveli i kërcënimit i lartë – ku përfshihen:
 - ✓ noteritë
 - ✓ lojërat e fatit
 - ✓ personat dhe marrëveshjet juridike
 - ✓ agjencionet e transferit të parave

- Niveli i kërcënimit mesatar – përfshihen:
 - OJQ-të
 - shërbimet e këmbimeve të valutave të huaja
 - tregtarët e mëdhenj
- Niveli i kërcënimit i ulët – përfshihen:
 - kontabilistët, auditorët dhe avokatët
 - kompanitë e sigurimeve
 - mikrofinancat
 - kazinot online
- Niveli i kërcënimit shumë i ulët – përfshihen:
 - fondet pensionale



TRAFIKIMI ME ARMË

Policia e Kosovës në vazhdimësi për çdo vit konfiskon mesatarisht rreth 1400 armë por prapë konsiderohet se ende është numër i madh i armëve në duart e qytetarëve dhe mund të thuhet se paraqet kërcënim për sigurinë e qytetarëve dhe sfidë të vazhdueshme për Policinë e Kosovës, për të krijuar një ambient të sigurt për të gjithë qytetarët e republikës.

Nga raportet policore për armët e sekuestruara në këtë periudhë shihet qartë se shumë nga këto armë janë të mbetura nga lufta e fundit në Kosovë, por përveç këtyre në vitet e fundit janë sekuestruar edhe armë të tjera të reja të prodhuara në shtetet e BE-së, por kryesisht shumica e tyre janë armë me gaz, që në mënyrë ilegale kanë arritur në Kosovë.

Armët ilegale janë përdorur në raste të ndryshme si në: vrasje, vrasje në tentativë, grabitje, kanosje, dhunë në familje, gjatë rrahjeve mes personave të ndryshëm, në gjuajtje të kundërligjshme për gjah, në kremtimin e festave e ahengjeve etj.

Si pasojë e përdorimit të armëve, ka pasur jetë të humbura, të plagosur, janë shkaktuar dëme materiale, frikë etj.

Në pjesën veriore të vendit armët ilegale nga grupet kriminale janë përdorur edhe ndaj Policisë së Kosovës dhe duke rrezikuar sigurinë e përgjithshme publike.

Ligji për armë Nr. 05/L-022 i rregullon kushtet për blerjen, posedimin, armëmbajtjen, ruajtjen, prodhimin, çaktivizimin, riparimin, tregtimin, importimin, transitin, shitjen, transportimin dhe shënjimin e armëve dhe municionit për personat fizikë dhe juridikë, brenda territorit të Republikës së Kosovës, si dhe eksportimin nga Republika e Kosovës të destinuara vetëm për përdorim civil.

Ky ligj është hartuar në përputhje me standardet e OKB-së, OSBE-së dhe të BE-së dhe praktikat më të mira evropiane, duke u përshtatur e adaptuar edhe me ndryshimet e mëvonshme të direktivave të BE-së¹⁰.

Trafikimi i armëve në Kosovë

Dukuria e trafikimit të armëve në Kosovë, sikurse edhe në gjithë rajonin, është mjaft e përhapur dhe ekziston bashkëpunimi i individëve apo grupeve kriminale në këtë drejtim, ndonëse grupet e tilla të identifikuar deri më tani janë kryesisht grupe të vogla, që bazën e kanë në lidhjet familjare të drejtuesve të këtyre grupeve kriminale për t'u zgjeruar me pas edhe më shumë.

Mënyrat se si bëhet trafikimi i armëve dhe municionit është i ndryshëm, si p.sh. duke i fshehur në trup, valixhe, në mallra të ndryshme, në vetura, në automjete transportuese, autobusë etj.

Nga rastet e identifikuar është tentuar të shfrytëzohen edhe pikëkalimet kufitare, por edhe përmes vijës së gjelbër kufitare, si dhe në disa raste të caktuara përmes postës doganore etj.

Nga të dhënat policore nuk ka ndonjë

indikacion që armët të cilat trafikohen në Kosovë të kenë për qëllim përdorimin e tyre në akte terrorizmi por ato përdoren në vepra të ndryshme penale dhe kryesisht përdoren nga individë të veçantë dhe nga grupe të caktuara, për qëllime mburrje dhe krenarie, por edhe për përfitime materiale, mandej si traditë është për të shtëna me armë zjarri në ahengje apo ceremoni festive, po ashtu dhe në përdorim kriminal, siç janë: vrasjet, grabitjet, kanosjet, plagosjet etj.

Trafikimit të armëve i paraprijnë edhe vjedhjet e armëve me leje, ku janë raportuar raste të vjedhjes së armëve nga dyqanet e shitjes së armëve legale, apo personave juridikë, po ashtu janë raportuar edhe raste të vjedhjeve të armëve të zjarrit nga shtëpitë e personave fizikë.

Kosova është vendi i fundit i dalë nga luftërat ballkanike dhe është vendi i vetëm në Ballkan që nuk ka pasur dhe as nuk ka fabrika për prodhimin e armëve dhe municioneve.

Ka pasur disa raste që janë gjetur armë të vjedhura në shtete fqinje, si: Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut, po ashtu ka raste që sekuestrohen edhe te ne nga Policia dhe pas verifikimit rezultojnë që janë vjedhur apo kanë humbur në shtetet fqinje dhe më larg.

Kjo nënkupton se mund të ketë ndonjë grup të organizuar që organizojnë vjedhjen e armëve të zjarrit dhe pastaj bëjnë shitjen e tyre në shtetet fqinje dhe në shtetet e BE-së.

Armët e vërteta të zjarrit - në bazë të origjinës së armëve që janë konfiskuar, besohet se vijnë nga Serbia, Shqipëria, Sllovakia, Zvicra, Çekia, etj.

Vlerësohet se kjo vepër nuk kryhet nga grupe të organizuara kriminale, por kryesisht nga individë të caktuar që jetojnë nëpër këto vende dhe pastaj i sjellin armët në Kosovë për përfitime materiale apo edhe për posedim personal.

Përpos trafikimit të armëve, në Kosovë trafikohet edhe municioni, për armë zjarri të gjata dhe për armë të shkurta (pistoleta), kryesisht është me prejardhje nga Shqipëria, ndërsa nga Serbia e vende tjera të Evropës Perëndimore kryesisht trafikohet municion për armë gjahu.

Rrugët e trafikimit janë zakonisht përmes vijës të gjelbër, zonave malore por në disa raste edhe me automjete, autobusë duke tentuar të trafikojnë armë dhe municione edhe përmes pikëkalimeve kufitare.

Dukuri e re në Kosovë është trafikimi përmes postës ose blerjet online, ku vitin e fundit janë zbuluar disa raste të blerjeve online, ku individ të caktuar kanë tentuar të përdorin postën për të sjellë në Kosovë armë ose pjesë të armëve të blera online, në vende të ndryshme kryesisht në Kinë.

Armët me gas të konvertuara - janë mjaft të kërkuara në tregun e zi të armëve, kanë një çmim mjaft të lartë të shitjes në shtetet e Evropës, gjë që i stimulon më shumë trafikantët e armëve të zjarrit që të merren me këtë trafikim.

Njëra prej arsyeve pse këto armë janë në trend është se nuk mund të gjurmohen, lehtë mund të gjenden në treg, madje në Turqi ku prodhohen është lehtë të blihen dhe kanë çmim mjaft të lirë (rreth 80 euro e pakonvertuar).



Rrugët e trafikimit të armëve në Kosovë

Armët me gaz janë lehtë të konvertueshme, dyshohet se konvertohen edhe në Kosovë, por jo gjithmonë, pastaj besohet se konvertohen në Maqedoninë e Veriut, Serbi, Turqi etj.

Mënyrat e trafikimit janë të ndryshme dhe jo gjithmonë nga grupet kriminale por edhe nga individë.



Foto të armëve modeli Zoraki 906 të konvertuara dhe ridizajnuara me mbishkrim SIG Sauer 7.65 mm, Zoraki 918, Zoraki M 906-B.

Armët me gas për sinjalizim me dritë dhe akustikë - këto armë në Kosovë besohet që trafikohen kryesisht nga Turqia dhe Bullgaria, përmes Maqedonisë duke shfrytëzuar kryesisht rrugët tokësore dhe besohet se Kosova në shumë raste përdoret vetëm si vend transit, pastaj armët transportohen më tutje në drejtim të Evropës Perëndimore përmes Serbisë, Shqipërisë, Malit të zi etj.

Se armët trafikohen përmes Kosovës në shtetet tjera të BE-së dëshmon fakti nga disa raste të kapura në Kosovë dhe Serbi, ku të dyshimtit ishin shtetas kosovarë, shtetas gjermanë dhe shtetas të disa vendeve nordike, ku sipas dyshimeve armët kanë pasur qëllim t'i dërgojnë në Gjermani, Belgjikë, Suedi apo edhe në shtete tjera të BE-së.



Foto e armës me gaz model Zoraki MOD 917-T dhe Model 918

Bazuar në të dhënat policore, në vijim po paraqesim rastet që kanë të bëjnë me trafikimin, mbajtjen në pronësi, përdorimin dhe prodhimin e armëve në Kosovë gjatë periudhës kohore 2021- 2024.

VITI	Importi, eksporti, furnizimi, transportimi	Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim	Përdorimi i armës	Prodhimi dhe sigurimi i armëve dhe mjeteve
2021	16	1440	250	1
2022	23	1520	289	0
2023	21	1467	294	1
2024	26	1724	317	0

Tabela me numrin e rasteve dhe llojin e veprës penale

Në vijim gjeni llojet e armëve dhe municionet ilegale të konfiskuara gjatë viteve 2021-2024

VITI	Numri total i konfiskimit të armëve	Pistoleta me Gas	Pistoleta dhe Revolver	Armë automatik /gjysmë automatik e AK47, M16.	Armë Gjuetie	Armë tjera, Pushkë ajrore dhe Pushke të gjata	Municionet/kalibra të ndryshëm	Raketa hedhës
2021	1280	369	418	134	153	51	42031	2
2022	1473	397	342	123	133	53	29903	1
2023	1392	414	369	264	126	45	37215	69
2024	1262	351	508	121	205	74	38020	1
Gjithsej	5407	1531	1637	642	617	223	147169	73

Tabela më lartë flet për numrin e konfiskimeve të armëve, llojin dhe municionin gjatë periudhës 2021-2024.

Në vijim po japim të dhëna lidhur me numrin e të dyshuarve sipas veprave gjatë periudhës 2021 - 2024 - të dhëna zyrtare nga policia.

VITI	Importi, eksporti, furnizimi, transportimi	Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim	Përdorimi i armës	Prodhimi dhe sigurimi i armëve dhe mjeteve
2021	43	1822	285	2
2022	43	1895	319	0
2023	86	1858	372	1
2024	40	2220	391	0
Total	212	7795	1367	3

Tabela tregon numrin e të dyshuarve të përfshirë në veprat e lartcekura ndër vitet 2021 - 2024

Gjurmimi i armëve

Gjurmimi i armëve përqendrohet në hetimin sistematik të armëve të zjarrit dhe kur është e mundur, pjesëve të tyre dhe municioneve prej prodhuesit deri tek blerësi i fundit.

Gjurmimi i armëve ndihmon organet kompetente hetuese vendore dhe ndërkombëtare, në hetimet e të gjitha rasteve të krimeve që ndërlidhen me armë, veçanërisht në rastet e lidhura me prodhimin dhe trafikimin e kundërligjshëm të armëve.

Gjithashtu gjurmimi i armëve ka për qëllim të identifikojë edhe kanalet e furnizimit të trafikimit të kundërligjshëm sikundër edhe të prodhimit të armëve të zjarrit, pjesëve të saj dhe municionit dhe autorët të cilët qëndrojnë prapa këtyre aktiviteteve të kundërligjshme.

Të arriturat/vlerësimet për vendin tonë të bëra nga institucione/mekanizmat e BE-së lidhur me trafikimin e armëve

Vitet e kaluara Raporti i Progresit i BE-së për Kosovën ka vlerësuar lart të arriturat e Kosovës, po ashtu Kosova është duke u vlerësuar shumë lart nga të gjitha institucionet dhe organizatat relevante të kësaj fushe për krijimin dhe funksionalizimin e Pikës Kombëtare të Armëve (FFP-së) si vendi i parë në rajon që ka arritur të përmbushë këtë kriter duke ngritur kapacitetet e inteligjencës policore dhe ndërlidhjen e saj në inteligjencën balistike për të

identifikuar analizuar dhe parandaluar të gjitha format e krimit që ndërlidhen me armë.

Kosova me institucionet ligjzbatuese në vitin 2024 ka marrë pjesë në operacionet me karakter ndërkombëtar në fushën e luftës kundër trafikimit të armëve "OP JAD SEE 2024", ditët e veprimit të përbashkët, operacion ky i koordinuar nga EMPACT dhe i mbështetur nga EUROPOL, ky operacion ndërkombëtar që udhëhiqet nga policia e Spanjës ka të bëjë me luftimin e trafikimit të armëve, ku marrin pjesë të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe shtetet e BE-së¹¹.

Bashkëpunimi ndërkombëtar në luftën kundër trafikimit të armëve të zjarrit dhe municioneve

Bashkëpunimi ndërkombëtar në luftën kundër trafikimit të armëve të zjarrit dhe municioneve, vlerësohet shumë i rëndësishëm, sidomos në fushën e shkëmbimit dhe grumbullimit të informatave dhe gjurmimit të armëve dhe municioneve ilegale.

Policia e Kosovës në këtë drejtim ka bashkëpunim të mirë sidomos me vendet fqinje duke përfshirë Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, Malin e zi dhe po ashtu edhe me shtetet e Bashkimit Evropian.

Në vitin 2023 Policia e Kosovës ka filluar shkëmbimin e të dhënave me EUROPOL-in përmes kanalit SIENA. Ky shkëmbim i të dhënave me shtete të ndryshme evropiane, ka rritur shkëmbimin e informacioneve sidomos me sektorin për armë dhe eksploziv në EUROPOL, me të cilët ka ngritje të dërgimit të informacioneve të gjurmimit ndërkombëtar dhe kërkesa për futje të të dhënave të armëve të humbura dhe të vjedhura në Kosovë ku vlen të theksohet se të gjitha armët e raportuara të vjedhura apo të humbura të cilat kanë qenë në posedim legal në vendin tonë janë dërguar për futjen e të dhënave në sistemin e INTERPOL-it dhe EUROPOL-it si armë të vjedhura apo të humbura.

Në vitin 2023 ka pasur ngritje të shkëmbimit të informacione me vendet ndërkombëtare për gjurmimin e armëve të sekuestruara, me qëllim që të identifikojmë rrugët e furnizimit të trafikimit të

kundërligjshëm sikundër edhe të prodhimit të paligjshëm të armëve të zjarrit.

ILECU - si pikë kryesore për armë (PKA) në Policinë e Kosovës, synon të rrisë edhe më shumë bashkëpunimin, qoftë me EUROPOL-in dhe INTERPOL-in po ashtu edhe me shtetet e rajonit, duke marrë pjesë në punëtori - workshope të organizuara nga EMPACT si "Joint Action Days".

Policia e Kosovës, po ashtu ka marrë pjesë në operacione me karakter ndërkombëtar në fushën e luftës kundër trafikimit të armëve.

Ajo merr pjesë edhe në OP "Conversus", operacion ndërkombëtar që udhëhiqet nga policia e Rumanisë, për luftimin e trafikimit të armëve me gaz dhe atyre të konvertuara, i cili si fenomen përpos Ballkanit Perëndimor, prek edhe shtetet e BE-së¹².

12 Vlerësim Strategjik – Informata të vitit 2024 trendi i krimeve me armë



KONTRABANDA ME MALLRA

Gjatë periudhës 2021–2024, Republika e Kosovës është përballur me sfida të vazhdueshme në luftën kundër kontrabandës me mallra, një dukuri që paraqet rrezik të shumanshëm për stabilitetin ekonomik, shëndetin dhe sigurinë kombëtare.

Kontrabanda, e cila manifestohet në forma të ndryshme përmes kanaleve të tregtisë dhe lëvizjes ilegale të mallrave, është nxitur nga faktorë të tillë, si rritja e kërkesës për produkte të caktuara dhe ndryshimet dinamike në tregjet ndërkombëtare. Kjo dukuri jo vetëm që dëmton të ardhurat buxhetore të shtetit, por gjithashtu pengon konkurrencën e ndershme në treg dhe favorizon strukturat kriminale që operojnë në vend dhe rajon.

Kontrabandimi i mallrave shkakton pasoja të mëdha në shumë aspekte të jetës në shoqërinë tonë, sidomos në

aspektin ekonomik, politik dhe në atë shëndetësor, ndërsa në anën tjetër, grupet e organizuara kriminale kanë përfitime të mëdha nga ky lloj krimi, pasi që përfitojnë mjete të konsiderueshme financiare duke iu shmangur tatimit, akcizës dhe tarifave doganore.

Në bazë të dhënave dhe informacioneve nga terreni, individ dhe grupe të organizuara të kontrabandës me mallra operojnë nëpër të gjithë territorin e Kosovës por më e theksuar është zona kufitare në **veri - lindje të vendit (kufiri me Serbi)**, por nuk përjashtohen as rrugët në zonën kufitare **në lindje të vendit (kufiri me Maqedoninë e Veriut)**, në **jug-perëndim të vendit (kufiri me Shqipërinë)** dhe në **veri-perëndim të vendit (kufiri me Malin e Zi)**.

Pra, zonat më të prekura me aktivitetin e kontrabandës së mallrave vazhdojnë të mbeten zonat në rajonin e Mitrovicës, Podujevës dhe Gjilanit, po pa përjashtuar rajonin e Prizrenit, përgjatë brezit kufitar me Shqipërinë dhe zona e Pejës me Malin e Zi.

Përfshirja e grupeve të organizuara kriminale: kontrabanda në Kosovë lidhet me grupe të vogla ose të mesme kriminale që veprojnë në nivel lokal ose rajonal, të përfshira në aktivitete kontrabande, ku menaxhojnë rrugë dhe kanale të ndryshme për transportin dhe shpërndarjen e mallrave të kontrabanduara **Kontrabanduesit e mallrave veprojnë në mënyra të ndryshme, disa grupe veprojnë si grupe homogjene, në raste tjera bashkëpunojnë me grupet kriminale jashtë kufijve të Kosovës, e në disa raste veprojnë si individ.**

Në periudhën 2021-2024, janë kontrabanduar mallra të llojllojshme, por më e theksuar është kontrabandimi i produkteve të cigareve/duhani, derivatet e naftës dhe vajrat, tekstili, produktet e ndryshme ushqimore, por janë evidente edhe mjetet e teknologjisë dhe elektronikës etj.

Si rezultat i zhvillimeve të reja teknologjike dhe ndryshimeve në tregun e konsumit, disa nga tendencat dhe zhvillimet më të fundit që po kontribuojnë në rritjen e këtyre veprave janë: zhvillimi i teknologjive të avancuara për falsifikimin, rritja e përdorimit të internetit, ndërjegjësimi i ulët dhe arsimimi i kufizuar për këtë fushë etj., që ka vënë në pah problematikën tjetër, mallrat e falsifikuara që shkaktojnë dëme të konsiderueshme për bizneset e

ligjshme në vend, e në veçanti, mallrat e falsifikuara mashtrojnë konsumatorin në lidhje me cilësinë e produktit dhe shpeshherë janë edhe të rrezikshme për shëndetin dhe sigurinë e tyre.

Në përgjithësi, periudha kohore 2021-2024, ka qenë e sfiduar në luftën kundër kontrabandës me mallra në vendin tonë, por ka pasur edhe tentime të vazhdueshme për të adresuar këtë problem, që kërkon angazhim të vazhdueshëm dhe bashkëpunim ndërkombëtar.

Krahasuar me vendet e Bashkimit Evropian, shkalla e përhapjes së këtij fenomeni është dukshëm më e lartë në territorin e Republikës së Kosovës. Kjo situatë është rezultat i një kombinimi faktorësh gjeopolitikë, institucionalë dhe socio-ekonomikë, të cilët krijojnë kushte të favorshme për zhvillimin e tregtisë ilegale dhe shmangien e detyrimeve fiskale.

Edhe pse ky fenomen vazhdon të paraqesë një sfidë të madhe për sigurinë dhe ekonominë e rajonit, autoritetet e Kosovës janë të angazhuara në luftimin e këtyre aktiviteteve, duke përmirësuar kontrollet kufitare dhe duke intensifikuar bashkëpunimin ndërkombëtar.

Për ndërtimin e një ekonomie të qëndrueshme dhe të ligjshme në Kosovë, zgjidhja e këtij fenomeni kërkon një qasje të koordinuar dhe afatgjatë, e cila përfshin forcimin e bashkëpunimit rajonal, rritjen e kapaciteteve të brendshme të zbatimit të ligjit, luftën e pa kompromis kundër korrupsionit dhe ndërtimin e besimit qytetar ndaj institucioneve publike.

Referuar të dhënave nga raportet vjetore të Doganës së Kosovës, kontrabanda me mallra vazhdon të jetë e pranishme në gjithë territorin e Kosovës dhe mbetet sfidë për vetë Doganën e Kosovës, por edhe për autoritetet tjera të zbatimit të ligjit në vend.


Si rrjedhojë e zbulimit të rasteve të shumta nga sektorët kompetentë brenda Doganës së Kosovës, nga Sektori i Hetimeve janë iniciuar raste për hetime dhe janë bërë kallëzime penale ndaj disa personave të cilët janë marrë me aktivitetin e kundërligjshëm të kontrabandimit me mallra. Bazuar në të dhënat statistikore në vitin 2024 kemi rritje në shumë mbi 19.3 € nga shmangiet. Ky është një tregues se individë dhe grupe kriminale janë duke vepruar në vazhdimësi me qëllim të dëmtimit të buxhetit të shtetit, e njëkohësisht janë duke vazhduar t'i dëmtojnë bizneset legale.

Vlera e mallrave kontrabandë (të konfiskuara/ sekuestruara)			
2021	2022	2023	2024
9 milion	11.3 milion	15.2 milion	19.3 milion

Sipas statistikave nga Dogana e Republikës së Kosovës, gjatë viteve 2021-2024, sasia e mallrave të falsifikuara dhe të konfiskuara nga Dogana është 1,144,390 copë, ndërsa të dhënat me përqindje sa i përket vendit të origjinës së mallrave të falsifikuara prin Turqia me 230.21%, pastaj mallra të kontrabanduara (pa origjinë) 94.01% dhe Kina me 34.74% (përqindja është kalkuluar për të gjitha vitet në total).

VITI	2021	2022	2023	2024
Numri i rasteve	299	284	478	330
Vlera Euro	1,244,663.00	1,854,026.00	3,653,464.00	3,582,367.00
Origjina	XS,TR,AL,MK, BE,CN	XS,TR,AL,MK, BE,CN	XS,TR,AL,MK, BE,CN	XS,TR,AL,MK, BE,CN

Paraqitur në diagram kontrabanda me mallra, gjatë periudhës kohore 2021 - 2024, që ka rezultuar me gjithsejtë me 1,391 raste



Numri total i rasteve të kontrabandës gjatë periudhës 2021 - 2024.

Numri total i kallëzimeve penale ndaj personave që kanë konsumuar veprën penale kontrabandë me mallra gjatë periudhës 2021-2024

Vitet	Numri i rasteve	Nr. Total i kallëzimeve penale	Nr. i personave ndaj të cilëve është ushtruar kallëzimi penal
2021	96 raste	84 Kallëzime Penale	92 persona te kallëzuar
2022	91 raste	69 Kallëzime Penale	94 persona te kallëzuar
2023	114 raste	92 Kallëzime Penale	101 persona te kallëzuar
2024	120 raste	112 Kallëzime Penale	126 persona te kallëzuar
Totali	421 raste	357 Kallëzime Penale	413 persona te kallëzuar

Numri total i kallëzimeve penale, numri i personave ndaj të cilëve është ushtruar kallëzimi penal gjatë periudhës 2021 – 2024.



Numri i personave të arrestuar të përfshirë në kontrabandim me mallra

Përmbledhje e përgjithshme e situatës lidhur me kontrabandimin e mallrave

Sipas të dhënave në dispozicion grupet e organizuara të kontrabandës me mallra operojnë nëpër Kosovë, me theks të veçantë aktivitetin e tyre e kanë të shtrirë më shumë në rajonin e Lindjes ku përshihen qytetet Viti, Kaçanik dhe Gjilan, në rajonin e Mitrovicës, në rajonin e Pejës dhe në rajonin e Prishtinës.

Zhvillime të aktiviteteve të kontrabandës ka pasur dhe vazhdon të ketë në: rajonet përgjatë brezit kufitar si në: Shqipëri, Maqedoni të Veriut, Mali të Zi dhe Serbi. Vlen të theksohet se kontrabanda gjatë vitit të fundit është rritur në aeroport në dalje.

Grupe të organizuara kontrabandojnë mallra të llojllojshme, por në veçanti janë të njohura për kontrabandimin e produkteve siç janë cigaret/duhani, tekstili, produktet e ndryshme ushqimore, ari etj.

Mallrat e kontrabanduara e të konfiskuara përgjatë viteve 2021-2024, duke përfshirë vlerën dhe origjinën e mallrave janë paraqitur në tabelën vijuese.

VITI	2021	2022	2023	2024
Numri i rasteve	299	284	478	330
Vlera Euro	1,244,663.00	1,854,026.00	3,653,464.00	3,582,367.00
Origjina	XS,TR,AL,M K,BE,CN	XS,TR, AL,MK, BE,CN	XS,TR,AL,M K,BE,CN	XS,TR,AL,M K,BE,CN

Numri i lëndëve (kallëzimet penale) të dërguara në prokurori për mallra të ndryshme gjatë periudhës 2021 - 2024 janë paraqitur në tabelën vijuese.

Vitet	Pije alkoolike dhe jo alkoolike	Cigare, duhane	Barna	Derivate	Kafshe, mish	Te tjera	Totali
2021	11	10	4	5	1	52	83
2022	7	12	5	3	1	37	65
2023	11	12	3	5	2	51	84
2024	13	10	5	3	3	74	108

KONTRABANDA E PRODUKTEVE USHQIMORE DHE MISHIT NË KOSOVË

Kontrabanda e produkteve ushqimore dhe e mishit në Kosovë është një problem i madh që ndikon negativisht në ekonominë e shëndetin publik dhe trendi i kontrabandës është në ngritje. Produktet e kontrabanduara hyjnë në treg pa kontroll cilësie, duke rrezikuar konsumatorët dhe duke dëmtuar tregun e ligjshëm.

Përkundër përpjekjeve të institucioneve përgjegjëse, si Dogana e Kosovës, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe Policia Kufitare, fenomeni i kontrabandës së këtyre produkteve mbetet shqetësues dhe kërkon masa më të rrepta dhe bashkëpunim ndërinstitutional.

Periudha 2021 - 2024	2021	2022	2023	2024	Shtetet
Produkte ushqimore	9	32	38	55	XC
Vlera e shprehur ne Euro	11223	42020	59652	87880	
Kafshe te gjalla	8	2	4	7	RMV,XS,AL
Vlera e shprehur ne Euro	10553	8551	14521	14643	

KONTRABANDIMI I PRODUKTEVE TË DUHANIT

Kontrabandimi i cigareve/Heets

Këto janë cigare për aparate elektronike të njohura me emrin Heets, kryesisht kontrabandohen nga Shqipëria e Maqedonia. Kontrabandimi bëhet përmes rrugëve të ndryshme ilegale përgjatë vijës së gjelbër që e kufizojnë Kosovën me këto dy shtete. Njëra ndër arsyet e kontrabandimit është edhe kur importuesit nuk kanë mundësi që në paketime t'i vendosen shenjat (fotot) të përcaktuara sipas ligjit për dëmtimin e shëndetit, prandaj në momentin që nuk mund t'iu përmbahen kushteve për import zgjedhin rrugën për kontrabandë.

Kontrabandimi i cigareve/duhanit

Cigaret kryesisht kontrabandohen nga Shqipëria dhe Maqedonia. Vlen të cekim se herë pas here ky produkt kontrabandohet edhe nga Greqia. Kontrabandimi i duhanit bëhet përmes rrugëve të ndryshme ilegale përgjatë vijës së gjelbër që e kufizojnë Kosovën me këto dy shtete. Brendet e cigareve: Trokadero, FM, Regina, Couture slims, Monus Slims, East, Fast etj.

Kontrabandimi i duhanit

Duke e pasur parasysh se importin e duhanit të papërpunuar/në fletë mund ta bëjnë vetëm kompanitë e licencuara për prodhim, është shfaqur interesimi nga kontrabandistët e ndryshëm për kontrabandimin edhe të këtij lloj produkti. Ky produkt vjen kryesisht nga Maqedonia, Serbia pasi që kultivohet në këtë vend më së shumti në regjion. Vlen të cekim se herë pas here ky produkt kontrabandohet edhe nga Shqipëria.

Kontrabandimi i duhanit bëhet përmes rrugëve të ndryshme ilegale përgjatë vijës së gjelbër që e kufizojnë Kosovën me këto tri shtete.

Kontrabandimi i duhanit për nargjile

Kohëve të fundit, me rastin e mbylljes së shumë lokaleve të quajtura "shisha-bare", është ulur edhe dukuria e kontrabandimit të duhanit për nargjile. Kontrabandimi i duhanit për nargjile bëhet zakonisht përmes personave fizikë të cilët e sjellin këtë produkt në Kosovë përmes autobusëve të linjave nga Turqia, vendet e BE-së dhe të rajonit.

Periudha 2021 - 2024	2021	2022	2023	2024	Shtetet
Cigare	20	20	52	25	RMV,AL,XS,MN E
Vlera e shprehur ne Euro	114522	46123	164223	28511	
Duhan	15	8	20	12	RMV,AL,XS
Vlera e shprehur ne Euro	85541	15239	101252	21910	
Shije per duhan Nargjile	26	8	9	0	XS
Vlera e shprehur ne Euro	23391	3940	4421	0	

Gjatë periudhës 2021-2024 janë ngritur 44 kallëzime penale për kontrabandë me duhan dhe cigare.




Foto të rasteve të kontrabandës me produkte të duhanit dhe cigare

KONTRABANDIMI I DERIVATEVE TË NAFTËS DHE VAJRAVE

Produkte të naftës që importohen dhe shiten në tregun e Republikës së Kosovës janë të gatshme dhe janë në përputhje me Udhëzimin Administrativ - UA 01/2017 për cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës si dhe me standarde ndërkombëtare (EN 590, EN 228 etj.).

Deri në vitin 2022 në Republikën e Kosovës kanë operuar 4 kompani të licencuara nga MINT dhe të autorizuara nga Dogana për import të gjysmë produkteve (që nuk ishin në përputhje me UA 01/2017) me qëllim të përzierjes së tyre dhe përfitimit të produktit final "Vaj për ngrohje" me përmbajtje të sulfurit më pak se 1% i cili produkt ishte në përputhje me UA 01/2017.

Gjatë periudhës 2021-2024 në laboratorin e Doganës janë testuar

rreth 4000 mostra të derivateve të naftës në import, prej të cilave 16 mostra rezultuan që nuk ishin në përputhje me kërkesat e UA 01/2017.

Këto mospërputhje apo jokonformitete kryesisht ishin tek dy parametra sezonalë: pikës së ngrirjes të nafta dhe shtypjes së avujve të benzina. Këta dy parametra sipas UA 01/2017 i kanë vlera të caktuara për periudha të caktuara kohore.

Në qershor të vitit 2024, me kërkesë të Sektorit të Hetuesisë, është bërë kontrollimi i disa autobote (cisterna) të ngarkuara dhe të deklaruara me derivate të naftës të cilat vinin nga Republika e Shqipërisë ku të dy autobote është konstatuar (mostrimi dhe analiza) se ishin të ngarkuara me ujë dhe vetëm një sasi e vogël rreth 3-4 mijë litra ishte me naftë.

Por ka kontrabandë të vajrave motorike kryesisht nga Maqedonia e Veriut dhe Serbia

Periudha 2021 - 2024	2021	2022	2023	2024	Shtetet
Derivatet	0	0	0	1	XS
Vlera e shprehur ne Euro				257	
Vajra	2	4	1	3	XS,AL
Vlera e shprehur ne Euro	1720	6985	4440	2932	

KONTRABANDIMI I BARNAT FARMACEUTIKE

Kontrabandimi i barnave paraqet rrezik të drejtpërdrejtë për shëndetin publik, pasi këto produkte hyjnë në treg pa asnjë kontroll cilësor.

Për transportimin e produkteve medicinale është e domosdoshme licenca për qarkullim farmaceutik që përcaktohet me ligj, Licenca L04, në rast se produkti medicinal nuk i plotëson kushtet dhe standardet e përcaktuara me ligj është i falsifikuar.

Llojet e medikamenteve të kontrabanduara futen ilegalisht në Republikën e Kosovës për shkak të ndryshme të çmimit.

Asgjësimi i barnave farmaceutike dhe produkteve tjera mjekësore bëhet në mënyrë rigoroze sipas urdhëresave të gjykatave apo prokurorive përgjegjëse.

Në një proces të tillë caktohet një komision i mbikëqyrjes së asgjësimit dhe asgjësimi bëhet nga një operator i kontraktuar dhe i licencuar për asgjësimin e barnave.

Varësisht nga lloji i barnave, bëhet asgjësimi. Disa asgjësohen në temperatura të larta, ndërsa disa të tjera komfor procedurave për të cilat operatori është i licencuar. Barnat farmaceutike të konfiskuara nuk futen prapë në treg.

Periudha 2021 - 2024	2021	2022	2023	2024	Shtetet
Barna	8	10	31	26	AL,RMV,XS
Vlera e shprehur ne Euro	132901	63866	79016	195944	

Gjatë periudhës 2021-2024 , janë ngritur 19 kallëzime penale për kontrabandë me barna.



Foto të rasteve të kontrabandës me barna

KONTRABANDIMI I TEKSTILIT

Tekstili kryesisht kontrabandohet nga Maqedonia. Dogana e Kosovës ka bërë përpjekjet maksimale që të bëjë vlerësime sa më reale të mallrave që importohen, e në veçanti edhe të tekstilit dhe po ashtu i ka kushtuar rëndësi mashtrimeve me mallrat e falsifikuara dhe si rezultat është shfaqur interesimi i kontrabandimit të tekstilit nga Maqedonia, ku kontrollet janë më sipërfaqësore. Arsyeja pse deri më tani ka ndodhur kontrabandimi i tekstilit nga

nga Maqedonia është çmimi apo vlerësimi më i ulët i tekstilit që bëhet nga Dogana e Maqedonisë. Kjo ka nxitur që kontrabandistët e ndryshëm nga Kosova të zhdoganojnë mallin në Maqedoni, e pastaj nga atje përmes rrugëve ilegale të fusin tekstilin në Kosovë.

Kontrabandimi i tekstilit bëhet edhe nga Shqipëria. Rrugëve ilegale përgjatë vijës së gjelbër, duke përdorur mjete të ndryshme të transportit, si: furgon, komioneta të vogla dhe traktorë.

Periudha 2021 - 2024	2021	2022	2023	2024	Shtetet
Tekstil i ndryshëm	7	16	23	26	AL,XS,RMV
Vlera e shprehur ne Euro	25142	68223	69610	161785	

KONTRABANDIMI I PJEVE ALKOOLIKE DHE JO-ALKOOLIKE

Kontrabanda e pijeve alkoolike dhe joalkoolike me intensitet të njëjtë sikurse edhe viteve të mëparshme, bëhet kryesisht nga Serbia.

Llojet e mallrave të kontrabanduara	2021	2022	2023	2024
Pije alkoolike dhe joalkoolike	22	19	24	24
Kallëzimet penale	11	7	11	13



Foto të rastit të kontrabandës me pije alkoolike dhe joalkoolike

FENOMENI I VEPRAVE PENALE KUNDËR AUTORËSISË DHE MALLRAVE TË FALSIFIKUARA

Veprat kundër autorësisë të pranishme në Kosovë, ndiqen sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, me Nenin 290 'cenimi i të drejtave të autorit'.

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) ndërmjet BE-së dhe Kosovës, ku për t'u arritur objektivat e marrëveshjes në fushën e pronësisë intelektuale, afati i paraparë sipas MSA-së është pesë (5) vjeçar, andaj duke iu referuar MSA-së, Kosova ka rregulluar infrastrukturën ligjore që mbron të drejtat e pronësisë intelektuale, ligje këto të harmonizuara me Acquis communautaire. Dogana e Kosovës që në vitin 2018 ka harmonizuar Ligjin për masat

doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale në harmoni me Rregulloren e BE-së nr. 608/2013.

Mallrat e falsifikuara shkaktojnë dëme të konsiderueshme për bizneset e ligjshme në vend. Përveç bizneseve mallrat e falsifikuara mashtrojnë konsumatorin në lidhje me cilësinë e produktit dhe shpeshherë janë edhe të rrezikshme për shëndetin dhe sigurinë e tyre.

Dogana e Kosovës që nga viti 2011 është kompletuar me infrastrukturën ligjore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe që nga ajo kohë e deri më tani numri më i madh i mallrave të falsifikuara të konfiskuara nga Dogana sipas kategorisë janë veshmbathjet, kozmetika, produktet e ushqimit, detergjentët etj.

Vitet	2021	2022	2023	2024	Totali në%
Sasia e mallrave të falsifikuara të konfiskuara nga Dogana	163,750	411,165	297,249	272,226	1,144,390 cp
Rastet e ndjekura penalisht	1 rast	4 raste	8 raste	4 raste	17 raste
Persona të arrestuar	13	16	14	12	55 persona

Statistika e mallrave të falsifikuara gjatë viteve 2021-2024

Vendi i origjinës së mallrave të falsifikuara	2021	2022	2023	2024	Totali në %
Turqia	49.21%	66%	60%	55%	230.21%
Kontrabanduara (pa origjine)	37.01%	16%	16%	25%	94.01%
Kina	10.24%	8%	8%	8.5%	34.74%

Vendi i origjinës së mallrave të falsifikuara

Kontrabandimi i mallrave sipas rajoneve kufitare dhe rrugët ilegale që shfrytëzohen për kontrabandim

Republika e Kosovës vazhdon të përballet me sfidën e kontrabandës së mallrave përgjatë gjithë vijës së saj kufitare, ku kjo veprimtari e kundërligjshme paraqitet në forma të ndryshme dhe mbetet një ndër problemet më të ndjeshme për sigurinë ekonomike në vend.



Harta e Kosovës

Me një vijë kufitare tokësore prej 743.5 kilometrash me shtetet fqinje, ekziston një potencial i lartë për shfrytëzimin e rrugëve joformale dhe kalimeve të paautorizuara. Një terren i tillë e bën më të lehtë zhvillimin e kontrabandës, duke e vënë përballë autoriteteve shtetërore një sfidë të vazhdueshme dhe serioze në përpjekje për të identifikuar, parandaluar dhe ndëshkuar këtë aktivitet të paligjshëm.

Edhe pse Policia e Kosovës ka vazhduar të kryejë detyrat me profesionalizëm në luftimin e kësaj problematike edhe gjatë periudhës 2021-2024, nuk ka lejuar të ketë vakum të sigurisë i cili është tentuar të krijohet dhe të shfrytëzohet nga grupet/personat me të kaluar kriminale, megjithatë bazuar nga terreni, janë identifikuar disa rrugë që në të kaluarën janë përdorur për kontrabandë nga grupet kriminale, e disa nga to ende janë aktive.

Rrugët e kontrabandës në veri- lindje të vendit kufiri Kosovë – Serbi

Kontrabandimi i mallrave nga Serbia në Kosovë, është një rrezik i heshtur për ekonominë e Kosovës, ku përgjatë zonës kufitare me Serbinë, janë hasur aktivitete të kundërligjshme të kontrabandës me mallra, duke u nisur nga druri teknik, materiali ndërtimor, kontrabanda e mallrave ushqimore (alkool, cigare, pemë, perime, mish, kafshë të gjalla dhe produkte tjera ushqimore) mallrave komerciale, mallra të falsifikuara (si veshje, aksesori, parfume), produkte teknologjike dhe pajisje elektrike dhe produkte mjekësore/farmaceutike, me theks të veçantë produkte që përdoren për estetikë.

Kjo veprimtari e paligjshme zhvillohet kryesisht përmes rrugëve ilegale malore, duke anashkaluar kontrollin doganor dhe detyrimet ligjore.

Nga Dogana e Kosovës në veri të vendit (kufiri me Serbinë), janë identifikuar 12 (dymbëdhjetë) rrugë ilegale që përdoren për kontrabandë të mallrave, në verilindje të vendit (kufiri me Serbinë) janë identifikuar 3 (tri) rrugë të cilat janë aktive dhe në lindje (kufiri me Serbinë) janë gjashtë (6) rrugë tjera cilat janë aktive.

Kjo zonë kufitare (veriu i Kosovës) ka qenë gjithmonë problematike në kuptimin e kontrabandës jo vetëm të mallrave si produkte ushqimore ose mjekësore, por edhe të trafikimit të armëve, narkotikëve dhe trafikimit me qenie njerëzore, janë një shqetësim, por është më e kufizuar.

KUFIRI KOSOVË - MAQEDONI E VERIUT

Nga Dogana e Kosovës në lindje të vendit (kufiri me Maqedoninë e Veriut), janë identifikuar 8 (tetë) rrugë ilegale që përdoren për kontrabandë të mallrave, të cilat janë aktive.

Kontrabanda e mallrave nga Maqedonia e Veriut për në Kosovë është një fenomen i organizuar dhe të shtrirë në disa forma dhe rrugë ilegale, ku janë të përfshirë individë, grupe dhe rrjete me përfshirje të gjerë.

Nga analiza e informatave të inteligjencës, shihet se kontrabanda nuk kufizohet vetëm në mallra të zakonshme, por përfshin një gamë të gjerë produktesh: automjete, pjesë këmbimi, vajra industriale, ushqime, mjaltë, barna, duhan, tekstil, telefona, ar, argjend, kafshë dhe madje edhe literaturë me përmbajtje fetare të diskutueshme. Këto mallra shpesh vijnë nga vendet e Bashkimit Evropian apo nga Britania e Madhe dhe përmes Maqedonisë së Veriut futen në mënyrë ilegale në Kosovë.

KUFIRI KOSOVË - SHQIPËRI

Edhe në jug-perëndim dhe perëndim të vendit (kufiri me Shqipërinë) janë identifikuar tri (3) lloje kontrabandash të cilat janë aktive:

Kontrabandimi është një nga fenomenet më të rrezikshme që godet shtetet me kufij të hapur ose të paqëndrueshëm. Në rastin e Shqipërisë dhe Kosovës, ky aktivitet ilegal është shqetësues dhe prek një gamë të gjerë mallrash – nga produktet elektronike dhe duhani, deri te kafshët, pijet alkoolike dhe barnat farmaceutike. Kjo veprimtari zhvillohet jo vetëm përmes pikave kufitare zyrtare, duke mos deklaruar mallrat, por edhe përmes rrugëve malore e të izoluara që shfrytëzohen në mënyrë sistematike nga kontrabanduesit.

Luftimi i kontrabandës përgjatë vijës kufitare me Republikën e Shqipërisë kërkon një përkushtim të bashkërenduar ndërmjet Policisë së Kosovës, Doganës, Ministrisë së Brendshme dhe agjencive të tjera përkatëse, si dhe bashkëpunim të ngushtë me autoritetet e Shqipërisë. Vetëm përmes rritjes së kapaciteteve mbikëqyrëse, hetimeve të strukturuar dhe vendosjes së ndëshkimeve efektive mund të frenohet kjo dukuri e kontrabandimit të mallrave.

KUFIRI KOSOVË - MALI I ZI

Edhe përgjatë zonës kufitare me Malin e Zi, zhvillohet kontrabandë me mallra në të dy drejtimet.

Nga Kosova në shtetin e Malit të Zi, bëhet kontrabandë e cigareve, kontrabanda bëhet në orët e mbrëmjes përmes rrugës Jabllanicë e madhe, Sejnovë me vetura malore (xhipa).

Rrugët e kontrabandës në veri-perëndim të vendit (kufiri me Malin e Zi) të cilat ishin aktive, me ndryshimin e qeverisë së Malit të Zi këto rrugë nuk janë aktive për kontrabandë.

SISTEMIMI I MALLRAVE TË KONFISKUARA

Mallrat e konfiskuara sistemohen në depo të Doganës të cilat evidentohen dhe menaxhohen nga stafi përkatës i tyre:

- ❑ mallrat e konfiskuara trajtohen sipas kodit doganor dhe udhëzimeve të brendshme.
- ❑ mallrat që kanë përfunduar procedurën e kundërvajtjeve administrative, mund të blihen nga pronari, pasi të kenë bërë kërkesë me shkrim dhe t'i kenë paguar gjrobat dhe taksat doganore për atë mall.
- ❑ në rastet kur kërkohet licencë, duhet të i marrin edhe ato dhe të ia paraqesin doganës origjinalin.
- ❑ me urdhëresë apo aktgjykim të formës së prerë, malli i kthehet pronarit, ashtu siç kërkohet me urdhëresë apo aktgjykim të formës së prerë.
- ❑ në rast të konfiskimit të mallit me urdhëresë nga gjykata apo në bazë të aktgjyimit të formës së presë, mallrat shiten përmes ankandit publik online që organizohet nga prokurimi në doganë.
- ❑ nëse mallrat duhet të asgjësohen, për këtë formohet një komision ad hoc që e mbikëqyrë procesin e asgjësimit. Për leje të asgjësimit vendos fillimisht AUV apo mund të vendoset edhe me urdhëresë të gjykatës, prokurorisë apo me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës kompetente për secilin rast.

Një formë tjetër e kërcënimeve kundër Kosovës janë edhe sabotimet apo bojkotimet e brendshme, në nivelin qendror apo lokal, që paraqesin kërcënime ndaj rendit kushtetues të Kosovës.

Ndikimi i vazhdueshëm tek pakicat kombëtare, duke i shfrytëzuar për organizimin dhe nxitjen e protestave, bojkotimi i zgjedhjeve dhe tendenca e vazhdueshme për t'i paraqitur si kategori e shtypur, është një formë tjetër e përpjekjes për bllokimin e proceseve demokratike në Kosovë.

Gjithashtu edhe sulmet kibernetike ndaj institucioneve shtetërore, paraqesin kërcënim të vazhdueshëm edhe për sigurinë kombëtare, marrë parasysh që lufta hibride ku përfshihen ndërhyrjet edhe në sistemet e sigurisë është duke u zhvilluar në nivel global.

Zhvillimi i hovshëm teknologjik edhe në vijim do të jetë fusha me rrezikun më të lartë, pasi që për të parandaluar kërcënimet nga sulmet kibernetike, kërkohen burime njerëzore të specializuara dhe pajisje të sofistikuar.

Lufta hibride në Kosovë, mbetet një sfidë komplekse që kërkon një qasje të koordinuar dhe të shumanshme për ta adresuar. Është e rëndësishme që qytetarët, institucionet dhe partnerët ndërkombëtarë të punojnë së bashku për të identifikuar dhe për të neutralizuar kërcënimet e mundshme,

duke ruajtur stabilitetin dhe integritetin e shtetit.

Kosova edhe në të ardhmen mund të ekspozohet nga shumë kërcënime hibride ku do të shfrytëzohet çdo cenueshmëri, përfshirë këtu edhe cenueshmërinë e sigurisë në pjesën veriore të vendit, pakënaqësitë sociale, aspektet ideologjike, krizat energjetike, krizat globale.

Bazuar në trendët aktualë dhe zhvillimin historik të luftës hibride ndaj Kosovës por edhe ndaj vendeve mike, mund të vlerësohet se në të ardhmen mund të kemi shtim të sulmeve hibride në formën e sulmeve kibernetike dhe ndërhyrjeve digjitale. Priten të intensifikohen sulmet kibernetike ndaj institucioneve qeveritare, sistemeve bankare dhe mediave.

Edhe më tutje do të krijohen narrativa që mohojnë shtetësinë e Kosovës, nxitje të tensioneve ndëretnike, përhapje të mosbesimit ndaj BE-së dhe ndaj SHBA-ve.

Synohet përdorimi i rrjeteve sociale për mobilizimin e protestave të fabrikuara, manipulim të opinionit publik, ndërhyrje në zgjedhje dhe dezinformim i orkestruar i opinionit publik do të jetë burimi kryesor i destabilitetit publik, duke nxitur ndarje sociale dhe tensione ndëretnike.



KRIMET MJEDISORE

Si objekt referues i sigurisë në këtë dokument strategjik është trajtuar edhe mjedisi me elementet e tij përbërëse, ku niveli i krimit ndaj mjedisit është i përhapur dhe mjaft shqetësues.

Edhe pse keqbërësit janë në numër të vogël, me krimet e tyre ndaj mjedisit janë duke shkaktuar pasoja të mëdha tek numër i madh i qytetarëve, veçanërisht tek ata që jetojnë në mjediset e atakuara.

Lidhur me këtë dukuri, në këtë periudhë vlerësuese sikurse edhe në periudhat e mëhershme, konstatimet janë se situata nuk është e mirë dhe vërehet se nuk janë ndërmarrë veprimet e mjaftueshme për parandalimin, luftimin dhe procedimin e shkelësve të këtyre operimeve ilegale, prandaj ka ardhur deri te një degradim në masë jo të vogël të ambientit në shumë pjesë të vendit.

Kosova ka zhvilluar një kornizë ligjore të gjerë për mbrojtjen e mjedisit, e cila përfshin ligje dhe udhëzime administrative që synojnë ruajtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, megjithatë, pavarësisht ekzistencës së këtyre ligjeve, zbatimi i tyre mbetet një sfidë e madhe. Një nga problemet kryesore është mungesa e kapaciteteve institucionale për të monitoruar dhe për të zbatuar në mënyrë efektive legjislacionin mjedisor. Kjo shpesh rezulton në mosrespektimin e standardeve mjedisore dhe në mungesën e ndëshkimeve adekuate për shkelësit. Pavarësisht këtyre përpjekjeve, sfidat mbeten dhe është e domosdoshme të vazhdohet me forcimin e zbatimit të ligjeve ekzistuese, në rritjen e kapaciteteve institucionale dhe në promovimin e një kulture të përgjegjësive mjedisore në të gjitha nivelet e shoqërisë.

Në Kosovë, monitorimi dhe ndjekja e krimeve mjedisore kryhet nga një bashkëpunim ndërmjet institucioneve qeveritare dhe agjencive të specializuara. Institucionet kryesore përfshijnë:

- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH): është përgjegjëse për hartimin e politikave mjedisore, mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe koordinimin e aktiviteteve për mbrojtjen e mjedisit.
- Policia e Kosovës: identifikon dhe heton rastet e krimeve mjedisore.
- Prokuroria: analizon provat dhe dosjet e hetimeve dhe ngritë akuza nëse gjenden elemente të mjaftueshme për vazhdimin e proceseve gjyqësore.
- Gjykatat: shqyrton çështjet e ngritura, duke siguruar zbatimin e drejtësisë në rastet e krimeve mjedisore.
- Organet e kontrollit ambiental vendor: në nivel lokal, inspektorate apo agjenci të specializuara mbikëqyrin zbatimin e normave mjedisore dhe raportojnë shkeljet që ndodhin në terren.

Gjatë vitit 2024 Ministria e Mjedisit ka formuar “Task Forcën e Gjelbër” në të cilën pjesëmarrës janë Policia, disa ministri dhe disa agjenci dhe ka filluar me realizimin e operacioneve të përbashkëta, me qëllim të parandalimit të krimeve mjedisore konkretisht në parandalimin e degradimit të lumenjve, prerjen ilegale të pyjeve me theks të veçantë në zonat e mbrojtura, parandalimin e ndërtimeve pa leje në zona të mbrojtura dhe në menaxhimin e mbeturinave.

Njësia policore për hetimin e krimeve mjedisore, përveç bashkëpunimit të ngushtë me institucionet përgjegjëse vendore për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit, bashkëpunon edhe me organizatën policore evropiane EUROPOL dhe është pjesëmarrëse në aktivitete të cilat lidhen drejtpërdrejt me mjedisin, si: trafikimi i florës dhe faunës, kontrabandimi i faunës si dhe hetimet financiare që lidhen me

krimet mjedisore. Policia e Kosovës ka një bashkëpunim të mirë me të gjithë akterët që merren me sigurinë e mjedisit në Kosovë.

Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve qeveritare dhe organizatave joqeveritare (OJQ) në Kosovë ka qenë një komponent kyç në adresimin e çështjeve mjedisore dhe trajtimin e krimeve të lidhura me mjedisin. Nga viti 2024 në të gjitha prokuroritë është emëruar nga një prokuror si koordinator për trajtimin e krimeve mjedisore. Gjatë viteve të fundit, Ministria e Mjedisit konkretisht Agjencia për mbrojtjen e mjedisit dhe OJQ të ndryshme kanë realizuar disa fushata sensibilizuese në Kosovë për rritjen e vetëdijes mbi krimet mjedisore dhe rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit. Këto fushata kanë përfshirë aktivitete të ndryshme, si: trajnime, konferenca, dhe aktivitete edukative.


Edhe organizatat ndërkombëtare kanë luajtur një rol të rëndësishëm në luftën kundër krimeve mjedisore në Kosovë, duke ofruar mbështetje në trajnime dhe asistencë teknike. Organizatat si ICITAP, GIZ, OSCE, HAPE kanë

ofruar trajnime për zyrtarët policorë për të kuptuar sa më mirë krimet mjedisore dhe për të gjetur mënyrën më të mirë të parandalimit dhe trajtimit të këtyre rasteve.

Krimet mjedisore në Kosovë përfshijnë një gamë të gjerë veprimesh kundërligjore të cilat ndikojnë në ndotjen dhe degradimin e mjedisit dhe

burimeve natyrore, ndërsa krimet më të shpeshta dhe më shqetësuese ndaj mjedisit janë: nxjerrja ilegale e rërës dhe zhavorrit nga lumenjtë, dëmtimi apo prerja ilegale e pyjeve, gurëthyesit ilegalë dhe ndotja e ambientit.

Bazuar në statistikat policore për veprat penale që hyjnë në kuadër të krimeve mjedisore, vërehet se periudha kohore e trajtuar në këtë analizë 2021-2024 paraqitet ndjeshëm më e mirë ose 465 raste më pak krahasuar me periudhën e mëhershme 2017-2020, të dhëna këto të cilat i gjeni në vijim.



Grafikoni paraqet numrin e përgjithshëm të veprave penale që lidhen me krimet kundër mjedisit, të ndara në dy periudha krahasuese 2017-2020 dhe 2021-2024.

Kur krahasohen dy periudhat kohore vërehet se ka rënie të rasteve të krimeve mjedisore në periudhën 2021-2024. Por edhe nëse merren këto 8 vjet nga këto dy periudha të analizuara vërehet se viti 2017 ka shënuar numrin më të madh të rasteve të krimeve mjedisore, ndërsa viti 2024 numrin më të vogël të këtyre rasteve dhe kjo tregon një përmirësim të dukshëm në drejtim të parandalimit të krimeve kundër mjedisit në vitet e fundit.

PRERJA ILEGALE E PYJEVE

Prerja ilegale e pyjeve është një krim tjetër kundër ambientit, mjaft i përhapur dhe shqetësues në Kosovë, që përbën kërcënim të drejtpërdrejtë për parqet dhe malet në pronësi shtetërore, që bart pasoja serioze ekologjike, ekonomike dhe shoqërore, duke e rrezikuar florën dhe faunën, si dhe duke krijuar rrethana për shpeshimin e katastrofave natyrore, zvogëlimin e reshjeve dhe rritjen e thatësisë.

Format kryesore me të cilat paraqitet dëmtimi i pyjeve janë: prerja ilegale e pyjeve për dru zjarri, prerja ilegale për tregti të paligjshme industriale dhe ndërtimet pa leje në toka pyjore.

OJQ vendore Sustainability Leadership Kosova - SLK në publikimin e tyre analitik në gusht 2023 ka identifikuar pikat kritike me nivele të larta të shpyllëzimit në Kosovë. Analiza thekson rajonin lindor të vendit një shqetësim madhor, veçanërisht zonat kufitare që përfshijnë malet e Karadakut në Viti, malet në Kamenicë, malet në Prishtinë dhe malet e Gjakovës dhe Junikut. Këto rajone kërkojnë vëmendje të menjëhershme dhe përpjekje të menjëhershme të ruajtjes për të frenuar shpyllëzimin e mëtejshëm.

Sipas analizës në fjalë të OJQ Sustainability Leadership Kosova - SLK dalin përfundime se në mes të viteve 2000 dhe 2022, Kosova humbi gati 16 mijë hektarë tokë pyje apo nga 2 deri në 3.5

hektarë në ditë. Shkaqet kryesore të këtij shpyllëzimi sipas kësaj OJQ SLK janë prerja ilegale e pyjeve si dhe shkaku i zjarreve¹³. Sipas një analize të bërë nga organizata Sustainability Leadership Kosova (SLK).


Prerja ilegale e pyjeve për dru zjarri si dukuri është duke shkaktuar problem serioz për ekosistemin, sigurinë mjedisore dhe zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve. Ky krim është gjithnjë e më pak i theksuar për faktin se me kalimin e kohës janë duke u gjetur burime alternative për ngrohje që nuk kanë dallime të mëdha në kosto nga ngrohja me dru.

Faktorët që janë duke ndikuar në prerjen ilegale të pyjeve janë kryesisht për shkak të zbatimit të dobët të ligjit nga ana e organeve të ndjekjes, për shkak se në zonat rurale ende ekziston dëshira për ngrohje me dru, për shkak se jo të gjithë janë të përfshirë në projektet qeveritare të subvencionimit të pajisjeve elektrike për ngrohje, por edhe për shkak të tregtisë së paligjshme me dru zjarri e cila në disa raste kryhet në mënyrë të organizuar.

Sa i përket prerjes së pyjeve për qëllime industriale, edhe kjo dukuri është një ndër problemet më serioze mjedisore dhe ekonomike që po përballon vendi. Edhe pse nuk është e theksuar sikurse në të kaluarën, kjo është duke ndodhur për nevoja të tregut të mobileve si dhe në përmbushjen e kërkesave në ndërtimtari.

¹³ OJQ Kosovare "Sustainability Leadership Kosova" (SLK) merret me zbulimin e potencialit të individëve, bizneseve dhe organizatave, duke siguruar kapacitetet udhëheqëse për një të ardhme të shëndetshme.

VJEDHJA E PYLLIT



Grafikoni paraqet numrin e veprave penale vjedhje pylli 2021-2024. Të dhënat tregojnë një ndryshim të ndjeshëm të rënies së numrit të rasteve nga viti në vit.

Ndotja, degradimi, shkatërrimi i mjedisit

Nxjerrja e rërës dhe zhavorrit nëpër lumenj është një nga format më të rënda të krimeve mjedisore e cila është duke ndikuar drejtpërdrejt në ekosistemet ujore, tokën bujqësore dhe infrastrukturën publike. Kosova vlerësohet se ka resurse të kufizuara të ujit, por edhe ato resurse që ka, nuk janë duke u shfrytëzuar dhe ruajtur si duhet dhe për pasojë kemi situatën ku shumica e lumenjve janë dëmtuar deri në atë masë, sa që riparimi i dëmeve është shumë i vështirë dhe se shfrytëzimi i inerteve të lumenjve i ka kaluar të gjitha limitet e mundësisë natyrore që të kthehen në gjendjen e mëparshme¹⁴.

Në kryerjen e këtij krimi, keqbërësit kanë shfrytëzuar neglizhencën e inspektorëve mjedisorë si dhe numrin e vogël të tyre dhe janë fokusuar në përzgjedhjen e intervaleve kohore të

përshtatshme për nxjerrjen ilegale të zhavorrit nga lumenjtë siç janë fundjavat dhe orët e natës.

Fillimisht krimi është kryer me devijimin e rrjedhës së ujit të cilin e kanë dërguar në parcela toke përreth lumenjve dhe nga këto parcela pastaj me anë të makinerisë së rëndë e kanë nxjerrë rërën dhe zhavorrin e grumbulluar për ta futur në procesin e pastrimit, ndarjes dhe përpunimit sipas madhësisë dhe përbërjes, në makineritë e ndërtuara për këtë qëllim afër këtyre lokacioneve.

Me nxjerrjen ilegale të rërës dhe zhavorrit, operatorët ilegalë kanë krijuar pasoja të mëdha në ujin dhe shtratin e lumenjve dhe për pasojë kemi rrëshqitje të tokës përreth, shkatërrim të habitateve natyrore, rrezikim të infrastrukturës dhe zonave përreth nga vërshimet, ndotje dhe turbullim të ujit etj.

¹⁴ Agjencia për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës (AMMK), në raportin "Ndikimi i shfrytëzuesve të rërës dhe zhavorrit në gjendjen mjedisore të lumenjve" Gusht 2022.

Edhe pse nuk ka një hulumtim që tregon se cili është lumi më i dëmtuar nga nxjerrja e zhavorrit, supozohet se lumi “Drini i Bardhë” është lumi më i dëmtuar në Kosovë, por dëmtime të ngjashme janë bërë edhe në lumenjtë tjerë si: Sitnica, Morava e Binçës, Lepenci, Ibri etj.



Pamja e makinerive dhe pamja e dëmeve nga keqbërësit në lumin “Drini i Bardhë”



Fotot e realizuara gjatë operacionit policor ku shihet degradimi që i është bërë lumit “Drini i Bardhë” nga nxjerrja e zhavorrit.



Pamje nga Google Earth tregojnë shkatërrimin e shtratit të lumit “Drini i Bardhë”



*Rrathët e kuq – Seperacionet e zhavorrit afër lumit “Drini i Bardhë” në Krushë e Vogël-Prizren
Rrathët e kaltër – pellgjet/basenet e krijuara nga devijimi i shtratit të lumit”*

Problematikë tjetër në krimet mjedisore janë edhe gurëthyesit ilegalë të cilët janë duke e dëmtuar rëndë mjedisin, infrastrukturën dhe sigurinë publike, ku nga punimet e kryera siç janë gërmimet në bjeshkët/kodrat e caktuara, janë duke e dëmtuar florën dhe faunën si dhe ambientin përreth duke shkaktuar pluhura, zhurmë nga makineritë që rëndojnë jetën e banorëve përreth.

Sipas informacioneve, edhe kompanitë e gurëthyesve që operojnë me licenca në të shumtën e rasteve nuk janë duke i respektuar kriteret e përcaktuara ligjore dhe janë duke tejkalluar lejet dhe licencat e punës, të cilët kryesisht kujdesen për arritjen e përfitimeve materiale por jo sa duhet edhe për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit përreth.

Edhe pse janë duke u intensifikuar gjithnjë e më shumë reagimet institucionale dhe janë duke u rritur rezultatet në luftimin e kësaj dukurie, ky fenomen kërkon një strategji të integruar dhe të përhershme për të vlerësuar

ndryshim/plotësim ligjor, për të siguruar mjetet inspektuese në terren, dënime reale për kryesit dhe rimëkëmbje mjedisore.

Ndotja e ambientit po ashtu është dukuri e theksuar në krimet mjedisore, format kryesore të së cilës janë: ndotja e ajrit, ndotja e ujit, ndotja e tokës, ndotja nga mbeturinat, ndotja nga zjarret dhe djegia e hapur e mbeturinave të cilat lidhen ngushtë me burimet e energjisë, aktivitetet industriale dhe menaxhimin e mbeturinave.

Ndotja e ajrit - edhe pse janë bërë përmirësime të vazhdueshme për zvogëlimin e ndotjes së ajrit në Kosovë, termocentralet me qymyr dhe fabrika për prodhimin e çimentos janë ndër ndotësit kryesorë të ajrit. Ndotës tjerë janë edhe fabrikat për prodhimin e stiroporit dhe ngjyrave e që në Kosovë ka disa prej tyre, pastaj barnatoret dhe kompanitë farmaceutike, ndotja nga djegia e druve dhe qymyrit për ngrohje, ndotja nga makinat e vjetruara.

Kosova ka numër të madh të barnatoreve ndërsa edhe më tutje problematike mbetet shkatërrimi i barnave të cilave ju skadon afati i përdorimit, pasi që ende nuk ka kapacitete të mjaftueshme për shkatërrimin e të gjitha produkteve medicinale.

Disa nga pronarët e barnatoreve, barërat me afat të skaduar i përziejnë me mbeturina ditore të cilat pastaj mblidhen nga kompanitë e pastrimit të qytetit dhe hidhen në deponitë e mbeturinave të qytetit, të cilat për shkak të përmbajtjes së tyre kimike mund të dëmtojnë rëndë natyrën por edhe shëndetin e njeriut.

Problematikë tjetër e theksuar është edhe gjendja me deponitë e mbeturinave pasi që deponitë e mbeturinave aktuale dhe sanitare nuk i plotësojnë mjaftueshëm kushtet për funksionimin e tyre dhe se ende nuk janë ndërtuar kapacitete të mjaftueshme për shkatërrim të

mbeturinave sipas standardeve të kërkuara.


Ndotje tjetër kemi ndotjen e lumenjve nga derdhja e ujërave të zeza dhe hedhja e mbeturinave, hedhja e mbetjeve kemikate nga fabrika të ndryshme. Si pasojë e degradimit të shtratit të lumenjve dhe hedhjes së mbeturinave disa nga lumenjtë në Kosovë e kanë humbur fuqinë vetëpastruese.

Djegia e pyjeve një fenomen më i theksuar gjatë stinës së verës në kohën kur ka temperatura të larta është duke ndikuar përveç në ndotjen e ajrit edhe në shkatërrimin e florës dhe faunës, duke krijuar rrethana për shpeshtimin e katastrofave natyrore, zvogëlimin e reshjeve dhe rritjen e thatësisë. Djegia e pyjeve më tepër është e theksuar gjatë muajve të nxehtë të vitit kur temperaturat janë të larta, por në disa raste djegia e pyjeve ka ndodhur nga pakujdesia e faktorit njeri.



Edhe djegia e mbeturinave në ambiente të hapura, gjithashtu është një fenomen i theksuar në Kosovë. Situata nga viti në vit sa i përket kësaj dukurie paraqitet gjithnjë e më e mirë dhe tani kemi të bëjmë me raste sporadike të cilat janë të lokalizuara kryesisht në zonat rurale dhe në zonat periferike të qyteteve.

NDOTJA, DEGRADIMI, SHKATËRRIMI I MJEDISIT



Grafikoni paraqet rastet e ndotjes, degradimit dhe shkatërrimit të mjedisit gjatë viteve 2021–2024. Kjo tregon se rastet e ndotjes kanë shënuar një rënie të lehtë ndonëse niveli mbetet ende i lartë.

Statistikat përgjatë viteve 2021-2024, për veprat penale në kuadër të kapitulli XXVII të Kodit Penal të Republikës së Kosovës - KPRK-së “Veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore”.


Vepra penale:	2021	2022	2023	2024
Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit	13	79	73	58
Shkretërimi i pyjeve	7	6	3	5
Vjedhja e pyllit	286	353	246	204
Gjuetia e kundërligjshme	21	12	12	13
Peshkimi i kundërligjshëm	5	7	4	5
Keqtrajtimi i kafshëve dhe ndotja e ushqimit dhe e ujit të shtazëve	15	23	18	14

Sa iu përket krimeve kundër mjedisit, bazuar në analizën e trendëve aktualë, mund të konkludojmë se për periudhën e ardhshme mbeten shumë sfida në disa nga fushat më të rëndësishme, përmirësimi i të cilave kërkon angazhim permanent të shumë institucioneve dhe agjencive.

Për shkak të kërkesave edhe më tej për dru zjarri, sidomos në zonat rurale, do të vazhdojmë të kemi një situatë pak më të lehtë për të mos thënë të ngjashme lidhur me prerjen ilegale të pyjeve. Kjo bazohet në faktin se gjatë periudhës së dimrit kur temperaturat janë të ulëta, për shkak të rritjes së konsumit herë pas here ka mungesë të energjisë elektrike, sidomos në zonat rurale. Një shkak tjetër që tregon se do të kemi një situatë të njëjtë është edhe fakti i çmimit të lartë të energjisë elektrike, një kategori të caktuar të qytetarëve do të fokusohen të gjejnë alternativa tjera për ngrohje e që mund të jetë ngrohja me dru zjarri. Lidhur me djegien ilegale të mbeturinave, bazuar në projektet e pakta të cilat aktualisht janë të realizuara, por bazuar edhe në mosfinalizimin edhe të disa projekteve të mëhershme për menaxhimin dhe riciklimin e mbeturinave pritet që në të ardhmen të kemi situatë përafërsisht të ngjashme ose me një rënie të lehtë të këtij krimi ambiental. Ka tendenca të vazhdueshme për realizimin e projekteve për riciklimin e mbeturinave dhe për shfrytëzimin e këtyre mbeturinave për të prodhuar energji elektrike të cilat nëse realizohen do ta përmirësojnë ndjeshëm situatën sa i përket këtij fenomeni.

Sa i përket ndotjes së lumenjve, mund të kemi gjendje më të mirë por jo të ndjeshme. Kosova ka mungesë të impianteve për trajtimin e ujërave të zeza kur dihet se vetëm 2 impiante të tilla janë funksionale në shkallë vendi dhe nevoja për këto impiante është imediate për të rritur shkallën e pastërtisë së lumenjve.

Edhe sa i përket shkatërrimit të shtretërve të lumenjve situata do të jetë pa ndryshime të mëdha. Këtu bazohemi në faktin se edhe nëse ndalohen së operuari të gjithë operatorët ilegalë për nxjerrjen e zhavorrit, dëmet që janë krijuar për vite me radhë nëpër lumenj nga këta operatorë ilegalë janë aq të mëdha, sa që vlerësohet se këto dëme është e pamundur të sanohen edhe për një periudhë të gjatë, e disa dëme ndoshta nuk do të mund të riparohen asnjëherë.



KRIMINALITETI I PËRGJITHSHËM

FAJDETË

Fajdeja si dukuri, për shumë vite me radhë është prezente në të gjitha rajonet e Republikës së Kosovës. Kjo dukuri kriminale është mjaft komplekse dhe sfiduese për institucionet e sigurisë, e cila shkakton pasoja ekonomike për fajdemarrësit dhe familjet e tyre, por edhe shkakton e shumë veprave tjera që në disa raste kanë përfunduar me vrasje dhe vetëvrasje.

Fajdeja, si fenomen, zakonisht është e pranishme në vendet ku nuk ka stabilitet apo qëndrueshmëri ekonomike, ku ka probleme me varfërinë, papunësinë, nivel të ulët të shkollimit, mungesë e sigurimit të kredive nga institucionet financiare me kriteret më të lehta dhe kamata të volitshme etj.

Fajdeja nënkupton dhënien e parave në mënyrë ilegale me përqindje të kamatës që varion nga 10% deri 20%, në muaj dhe jo vetëm, e cila procedurë zhvillohet jashtë sistemit bankar.

Fajdeja ndërlidhet me krimin e organizuar, ku paratë e fituara nga fajdeja investohen në aktivitete kriminale si: trafikimi me narkotikë, trafikimi me qenie njerëzore, kontrabandë etj.

Fajdeja ka disa karakteristika, ku shfaqet në mënyrë të fshehtë dhe jashtë sistemit legal financiar, zgjerohet shpejt në kushte të krizave sociale/ekonomike, përfshin persona me ndikim dhe fuqi, përfitimet janë marramendëse etj.

Kjo dukuri kriminale për nga aspekti i hetimit dhe zbulimit nga ana e organeve të drejtësisë, është mjaft komplekse dhe e ndërlikuar, për shkak të perfeksionimit të metodave të dhënies së parave me fajde nga fajdexhinjtë, përdorimit të personave të tretë duke iu shmangur lidhjeve direkte me viktimat, mosbashkëpunimi i viktimave me organet e drejtësisë, si dhe kyçja e avokatëve, noterëve, përmbaruesve, me qëllim të finalizimit të marrëveshjeve.

Një numër i personave në Kosovë hyjnë në fajde për shkak të: krizave financiare të bizneseve, me qëllim të rikuperimit të tyre apo hapjes së bizneseve të reja, përfshirja në lojëra të fatit (bastore, kazino), si pasojë e konsumimit të substancave narkotike, për arsye shëndetësore për vete apo për familjarët e tyre, investime në para digjitale (kripto valuta) etj.

Fajdemarrësit ka raste kur nuk arrijnë t'i kthejnë kamatat në kohën e caktuar atëherë fajdedhënësi iu vendos tarifa edhe më të larta dhe kështu muaj pas muaji kamata e vënë nga fajdegjiu bëhet aq e lartë dhe e papërballueshme për ta paguar.

Kjo pastaj sjell pasoja në buxhetin familjar të fajdemarrësit, i cili detyrohet të shesë pjesë të pasurisë së tij dhe familjes për ta shlyer borxhin.

Ka raste kur nuk përfundojnë vetëm me kaq por shkojnë edhe më larg, siç është marrja e pasurisë së paluajtshme, si: shtëpi, prona etj., për një çmim disa herë më të vogël sesa që e ka vlerën normale pasuria ose më drejt shpeshherë shtëpia merret për vlerën e borxhit.

Pasojat që shkaktohen nga marrja e fajdesë të viktimat rezultojnë me dëme të formave të ndryshme siç janë: falimentimi i bizneseve, varfërimi dhe shkatërimi i familjeve, emigrimi i fajdemarrësve, dëmtimi i shëndetit mendor dhe fizik, rritje e dhunës dhe kërcënimeve në shoqëri, vetëvrasje, vrasje, ndikimi negativ në zhvillimin ekonomik të vendit, dëmtimi i imazhit të vendit në aspektin ndërkombëtar.

Me qëllim të luftimit dhe reduktimit të kësaj dukurie kriminale, në muajin maj të vitit 2024, Policia e Kosovës ka formuar ekip të veçantë hetimor (Task-forcë), e cila i ka trajtuar të gjitha informacionet dhe rastet e mundshme për personat dhe grupet e dyshuara kriminale që merren me veprën penale të fajdesë.


Mënyra e kryerjes së kësaj vepre së fajdes

Fajdedhënësit, para se t'i japin paratë, kërkojnë garanci në forma të ndryshme nga fajdemarrësi duke i detyruar të lënë peng pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, ku në rast të moskthimit të borxhit, rritet kamata në baza ditore, e cila vështirëson kthimin e fajdesë, ku në këto raste merret pasuria e lënë peng e cila shumicën e rasteve e tejkalon shumën totale të parave të marra që nga fillimi.

Mënyra e kryerjes së këtij aktiviteti kriminal, pothuajse është e ngjashme në të gjitha rajonet e Kosovës, ku fajdedhënësit për t'i kthyer paratë dhe fitimet e tyre, ndaj fajdemarrësve (viktimave) përdorin forma të ndryshme si: detyrimin, shantazhin, kërcënimin, rrëmbimin, sulmin fizik, dëmtime, presionin psikik etj.


Në katër vitet e fundit, bazuar në të dhënat zyrtare, nga Policia e Kosovës janë raportuar gjithsejtë 94 vepra penale të fajdesë, (shih grafikonin në vijim).

RASTET E HETUARA



Rastet e raportuara në periudhën 2021-2024

Sipas shtrirjes së veprës penale të fajdesë në rajone, më e theksuar është në rajonin e Prishtinës, e pasuar nga rajoni i Prizrenit dhe nga rajonet tjera siç janë prezantuar në grafikonin në vijim.



Rastet e raportuara të fajdes sipas rajoneve 2021 – 2024

Fajdeja është një krim i nën/raportuar nga qytetarët e Kosovës, për arsye të ndryshme si: të frikësimit, kërcënimit, shantazhit dhe mosbesimit në institucione etj. Bazuar në informatat inteligjente numri i rasteve të fajdeve në Kosovë është më i lartë, krahasuar me rastet që janë raportuar apo janë hetuar deri më tani nga Policia e Kosovës.

Shumica e rasteve iniciohen në bazë të informatave inteligjente, disa raste raportohen nga familjarët e viktimave, ndërsa nga vetë viktimat rasti raportohet, vetëm kur vijnë në pozitë që nuk janë në gjendje ta paguajnë shumën e cila rritet në mënyrë rapide (shpejtë) nga fajdedhënësi, kur rreziku është shumë i lartë dhe nuk kanë ndonjë zgjidhje tjetër. Në vitet e fundit është vërejtur një rritje në raportimin e rasteve të fajdeve në media, gjë që ka ndihmuar në vetëdijesimin e qytetarëve për pasojat ligjore dhe sociale të kësaj praktike.

Përfshirja e individëve në fajde

Personat e përfshirë në veprën e fajdesë, janë individë me të kaluar kriminale, që njihen si persona të rrezikshëm dhe të dhunshëm në komunitet. Në realizimin e qëllimeve të tyre, këta individë nuk hezitojnë që të bashkëpunojnë edhe me grupe të ndryshme kriminale.

Fajdedhënësit zakonisht përzgjedhin caqet e tyre (fajdemarrësit) me mjaft kujdes, fillimisht duke i joshur ata kinse me kushte mjaft të favorshme, pastaj përmes formave të ndryshme të presionit dhe detyrimit i detyrojnë fajdemarrësit, përkatësisht viktimat, që të veprojnë në dëm të pasurisë së tyre.

Zakonisht sipas vlerësimeve nga zbatuesit e ligjit, fajdedhënësit njihen si persona mjaft të fuqishëm, të cilët karakterizohen me epitet kriminal, duke shkaktuar frikë tek viktimat e tyre.


Në të shumtën e rasteve këta individë i kanë kyçur edhe anëtarët e tjerë të familjes, ku fajdeja është bërë biznes kryesor i familjes së tyre. Por është karakteristikë se të gjithë fajdedhënësit, posedojnë pasuri që nuk përputhen me të ardhurat e tyre legale dhe kanë jetë luksoze, të cilën e shfaqin në publik dhe në rrjetet sociale.

Në veprimtarinë e fajdesë, ka të përfshirë edhe persona zyrtarë nga institucione të ndryshme, përfshirë edhe zyrtarë policorë.

Grupet kriminale të përfshira në fajde

Bazuar në të dhënat zyrtare dhe nga zhvillimi i hetimeve gjatë katër viteve të fundit 2021 – 2024, janë hetuar gjithsej 13 grupe kriminale që janë marrë me fajde, ku si pjesëtarë të grupeve janë arrestuar 93 persona të dyshuar.

GRUPE KRIMINALE



Grupet e hetuara gjatë viteve 2021 - 2024

Grupet kriminale që merren me aktivitetin kriminal të fajdeve, në Kosovë njihen si grupe të fuqishme dhe me ndikim, të cilat kanë qëndrueshmëri ekonomike, posedojnë kapital të mjaftueshëm apo mjete monetare (kesh) të cilat i vënë në qarkullim të personat në nevojë, me qëllim të përfitimit nga kamata e tyre.

Këto grupe kriminale janë të rrezikshme dhe të dhunshme, të cilët në raste të caktuara kur kanë probleme në kthimin e kamatës nga fajdemarrësit, nuk hezitojnë të përdorin dhunën dhe forcën ndaj fajdemarrësve dhe ndaj familjarëve të tyre.

Anëtarët e grupit kriminal që merren me fajde në Kosovë, kanë lidhje të ngushta familjare dhe shoqërore mes vete. Këta persona kanë të kaluar kriminale në dosjet e Policisë dhe gjithmonë janë të armatosur dhe flexibel pavarësisht në cilën zonë operojnë.

Madhësia e këtyre grupeve është mesatare nga 3 deri 10 anëtarë, të cilët kanë detyra apo role të ndryshme brenda grupit përkatës dhe veprojnë si rrjete të lira, ku grupet e vogla më shumë veprojnë në nivel lokal ose në rajonin prej nga vijnë, ndërsa grupet më të mëdha veprojnë në të gjithë territorin e vendit dhe jo vetëm.


Aktivitetin e tyre kriminal e fshehin prapa bizneseve legale, si auto sallone, rent a car, kompani taksie, kompani ndërtimi, motele etj., ku përmes këtyre bizneseve bëjnë edhe pastrimin e parave të fituara në mënyrë të kundërligjshme.

Disa nga grupet kriminale, në përftimin e fajdeve, shfrytëzojnë tregtinë me automjete përmes auto salloneve, ku viktimave ju shiten automjetet në vlerë më të madhe se që kanë çmimin real në treg, pastaj i njëjti automjet brenda një periudhe të shkurtër kohore, i blihet prapë viktimës nga fajdexhinjtë për çmim shumë më të ulët, me ç'rast viktimja pëson dëm mjaft të madh pasuror.

VRASJET

Sipas të dhënave statistikore për periudhën 2021-2024 në Kosovë kanë ndodhur 94 raste të vrasjeve, vrasje e rëndë, vrasje nga pakujdesia dhe vrasje e foshnjës gjatë lindjes, ndërsa në periudhën e mëhershme 2017-2020 kanë ndodhur 110 raste të vrasjes, që do të thotë se kemi rënie të numrit për 17 raste apo për - 4.54% raste më pak.


Shkaqet për këtë ulje të numrit të vrasjeve mund të jenë të ndryshme, por një ndër faktorët që ka ndikuar në këtë ulje është edhe ashpërsimi i legjislacionit penal, përkatësisht hyrja në fuqi e Kodit Penal të Republikës së Kosovës në vitin 2019 i cili e ka sanksionimin më të rëndë të veprës.



Në grafikun janë të paraqitura dy periudhat kohore me numrin total të vrasjeve.

Gjatë periudhës 2017-2020 nga vepra penale vrasje kemi 116 viktima ndërsa gjatë periudhës 2021-2024 nga vepra penale vrasje kemi 93 viktima. Që do të thotë kemi 23 viktima më pak ose -19.8%.


Vitkimat në total dhe sipas gjinisë gjatë viteve 2017-2020 krahasim me vitet 2021-2024



Në grafikun është paraqitur numri i viktimave të vrasjes në dy periudhat kohore 2017-2020 dhe 2021-2024.

Në periudhën 2021-2024 kemi rënie prej 32.3 % në numrin e viktimave të vrasjeve për grupmoshën 51-70 vjeç dhe po ashtu kemi rënie për 100% të numrit të viktimave në grupmoshën 0-14 vjeç.

Grup moshat e viktimave




Grafikoni paraqet viktimat e vrasjes sipas grup moshave në dy periudhat kohore.

Sa i përket numrit dhe moshës së të dyshuarve, gjatë periudhës 2017-2020 janë gjithsej 109 të dyshuar dhe 11 raste me të dyshuar ende të panjohur NN, ndërsa në periudhën 2021- 2024, janë 81 të dyshuar dhe 3 raste me të dyshuar ende të panjohur NN, që do të thotë se kemi 72.7% ulje të pazbulueshmërisë.

Lidhur me kryesit e vrasjeve në periudhën 2021-2024 krahasuar me periudhën e mëhershme kemi ulje të numrit të vrasësve nga grupmosha 14-18 vjeç për -78.6%.


Grup moshat e të dyshuarve për vrasje



Grafikoni paraqet të dyshuarit e vrasjeve sipas grup moshave në dy periudhat kohore.

Në katërvjeçarin e fundit vitet 2021-2024, numri i të dyshuarve për veprën penale të vrasjeve nga gjinia femërore është 3 të dyshuara përderisa në periudhën 2017-2020 kemi pasur 6 të dyshuara të gjinisë femërore ose rënie prej -50 %.

Të dyshuarit sipas gjinisë gjatë viteve 2017-2020 krahasim me vitet 2021-2024



Grafikoni me të dyshuarit për vrasje sipas gjinisë

MOTIVET E VRASJEVE

Vrasjet në Kosovë në përgjithësi nuk kanë të bëjnë me qëllime apo motive etnike, religjioze, politike.


Motivet kryesore të këtyre vrasjeve janë të ndryshme, për motive të ulëta, konflikte personale, hakmarrje të çastit, mosmarrëveshje, fajde, grupe rivale dhe konflikte pronësore.

Gjatë kësaj periudhe katër vjeçare 2021-2024, 16 raste janë klasifikuar si vrasje që kanë ndodhur në kontest të dhunës në familje, prej tyre 12 viktime janë femra dhe 6 meshkuj.

Krahasuar me periudhën 2017-2020 vrasjet si shkak i dhunës në familje kanë pësuar rënie për 33%.

Disa nga vrasjet e kryera në Kosovë janë kryer në mënyrë të kujdesshme nga kryerësit duke mos lënë gjurmë në vendin e krimit.

Motivet e vrasjeve




Grafikoni më lartë paraqet motivin e vrasjeve për periudhën 2021-2024 dhe periudhën 2017-2024.

Përdorimi i armëve të zjarrit dhe mjeteve të tjera në vrasje 2021-2024

Gjatë kësaj periudhe armët e zjarrit/pistoletat vazhdojnë të mbesin mjeti më i përdorur për vrasje, nga 88 raste të vrasjeve prej tyre 43 raste janë kryer me armë të shkurtër-pistoleta, 14 vrasje janë kryer me armë zjarri të gjata, duke përfshirë armën automatike AK-4 dhe pushkë gjahu, 15 raste të vrasjeve janë kryer me thika ndërsa 16 vrasje janë kryer me mjete të forta gjatë rrahjes.

Përdorimi i armëve të zjarrit dhe mjeteve në rastet e vrasjeve



Grafikoni paraqet përqindjen e armëve/mjeteve të përdorura në vrasje gjatë periudhës 2021-2024.

Në 3 rastet e hetuara nga Policia e Kosovës ku të dyshuarit për vrasje janë të mitur, ka ardhur si pasojë e mosmarrëveshjeve të krijuara në rrjetet sociale në platformën Snapchat. Këto konflikte kanë eskaluar jashtë platformës digjitale dhe kanë përfunduar me përballje fizike duke përfunduar me vrasje.

GRABITJET

Grabitjet dhe në veçanti grabitjet e armatosura vazhdojnë të paraqesin shqetësim për sigurinë, e në veçanti për sigurinë e qytetarëve dhe pronës së tyre. Ndër rajonet më të atakuara nga rastet e grabitjeve, rezulton që të jetë rajoni i Prishtinës, ndërsa rajonet më pak të prekura janë rajoni Mitrovicë Veri dhe rajoni i Gjakovës.




Tabela tregon grabitjet sipas rajoneve në periudhën 2021-2024

Në bazë të të dhënave nga tabela të rasteve të ndara sipas viteve dhe rajoneve, vërehet se viti 2021 ka pasur numrin më të madh të rasteve të grabitjeve të raportuara, ndërsa në vitet pasuese vërehet rënie e vazhdueshme e rasteve të raportuara të grabitjeve, rënie e cila në vitin 2024 është pothuajse 50% më e ulët se sa rastet e raportuara në vitin 2021. Rënia e numrit të rasteve të grabitjeve është evidentuar në të gjitha rajonet, por me theks të veçantë në rajonin e Ferizajt, ku nuk është shënuar asnjë rast dhe po ashtu kemi rënie të grabitjeve edhe në Mitrovicë Jug.

Grupet kriminale të grabitësve në Kosovë operojnë në qytete të ndryshme dhe kanë realizuar në vazhdimësi grabitje nga një rajon në rajonin tjetër brenda ditës, ku ekzistojnë struktura të grupit që kanë lidhje gjaku, vëllezër dhe përdorin numra të telefonit të huaj.

Zakonisht në kryerjen e grabitjeve kanë marrë pjesë një deri në shtatë persona të cilët kanë pasur role të ndara si: vozitjen, vrojtimin e hapësirës publike, pritjen për rezistencë ndaj Policisë, njohës të mirë të kasafortave dhe eksplozivit ndaj bankomatave.

Target i grabitjes ishin kryesisht pompat e derivateve të naftës, banka, këmbimore të valutave, barnatore, restorante, shoferë të taksive dhe të veturave, shtëpi, kalimtarë të rrugëve publike, institucionet mikrofinanciare Western Union, shtëpi apo banesa, markete, pika të postave telefonike, dyqane të shitjes së armëve, markete, institucione private me operatorët telefonikë Ipko dhe Vala, hotele, ndaj klientëve, kompani që kanë pasur qëllim shpërndarjen e ushqimeve, argjendari, motele, individë, apartamente, hotele, parkun e qytetit, lokale të videolojrave, shtëpi në lagjet luksoze, transport publik, shpërndarës të postës, hapësirat e stacionet e trenit, gjatë tërheqjes së parave nga bankomatët.




Tabela më lartë tregon cakun e grabitësve gjatë periudhës 2021-2024

Shumicën e herëve grabitësit kanë arritur ta kryejnë grabitjen e planifikuar ndërsa ka pasur edhe raste kur grabitësit kanë hasur në rezistencë nga viktimat dhe janë detyruar të largohen pa e arritur qëllimin.

Po i veçojmë disa nga grabitjet më karakteristike të cilat kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe kohore.

Në vitin 2022 në një grabitje të një automjeti për transportin e parave në Leposaviq të dyshuarit kanë përdorur një autoambulancë të vjedhur në Prishtinë.

Një rast tjetër i ndodhur në autostradën “Ibrahim Rugova” grabitësit duke u

prezantuar rrejshëm kanë kryer kontroll në një veturë dhe nën kërcënimin e armës kanë marrë nga viktimat para dhe telefon.

Po ashtu një grup tjetër i grabitësve të armatosur me revole dhe maska të zeza kanë vendosur pengesa gome në rrugë dhe kur vozitësi i një veture ka tentuar për t’i hequr pengesat nga rruga, grabitësit kanë shfrytëzuar momentin dhe kanë kryer grabitje nga viktimat.

Një dukuri tjetër e kemi kur grabitësit kanë shkuar nëpër disa shtëpi dhe duke u prezantuar si polic kanë kryer bastisje dhe grabitje.

Grabitja në argjendarinë në Suharekë nga katër persona të dyshuar të pajisur me armë të gjata AK-47 dhe revole, arritën të vjedhin para, me ç’rast ka pasur edhe shkëmbim të armëve të zjarrit në mes të grabitësve dhe Policisë, ku disa zyrtarë policorë mbetën të lënduar.

Mjetet e përdorura gjatë grabitjes




Tabela statistikore lidhur me arrestimet, lëndimet, plagosjet, vrasjen dhe përdorim të armëve.

Gjatë kësaj periudhe kohore Policia ka shënuar rezultate në zbulimin e rasteve të grabitjes dhe ka arrestuar në disa raste disa të dyshuar.

Viti	2021	2022	2023	2024	Totali
Arrestuar	9	20	7	5	41
Lëndime viktima	3	15	17	22	57
Plagosje	2	1	0	0	3
Vrasje	1 (grabitës)	0	0	0	1
Përdorim i armës	5	6	1	0	12

Grafikoni më lartë tregon armët/mjetet e përdorura në grabitje nga të dyshuarit.